



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Inxhinieri Mekatronike”**

i

**Institucionit të Arsimit të Lartë
“Universiteti Politeknik i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As., Dr. Agron DHIMA

2. Dr. Eli VYSHKA

Tetor / 2022

Për Programin e studimit Bsc në "Inxhinieri Mekatronike"

Nr.		
1	IAL aplikues:	UPT
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Automatikës (Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	MASh Nr. 1583/1 Prot, datë 12.05.2006 (për miratimin e diplomave)
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 205, datë 29.04.2021
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 tre vite akademike (6 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	13 PAE/4 PAK
18	Numri i studentëve:	70 të regjistruar në vit të parë në 2021-2022, tre vitet në total 220
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Ky vlerësim bazohet në dokumentacionin e sjellë nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike (FIE), i Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT), për programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike" ku përfshihet dhe një Raport i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe vizita dy ditore të zhvilluara në këtë institucion nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm me datë 13-14.07.2022.

Të gjitha takimet u zhvilluan sipas axhendës së hartuar nga Agjensia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL).

Inxhinieria Elektrike është një nga degët themeluese të Institutit të Lartë Politeknik në vitin 1951, ndërsa Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike (FIE) është një nga 4 fakultetet themelues të Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT) në vitin 1991. Pra, Inxhinieria Elektrike në UPT ka një histori mbi 70 vjeçare.

Departamenti i Automatikës që ofron programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike ka marrë këtë emërtim nga riorganizimi i FIE me VKM nr. 824, datë 05.12.2007 "Për krijimin e disa njësive kryesore, fakultete në Universitetin Politeknik të Tiranës". FIE riorganizohet në 3 departamente: i Automatikës, i Elektroteknikës dhe Sistemeve Elektrike të Fuqisë.

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike" është miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës përmes shkresës me nr. Prot. 1589/1, date 12.05.2006.

Në versionin aktual të tij, ky program studimi është në përputhje të plotë me VKM nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", e ndryshuar. Plani mësimor është i organizuar në lëndë semestrale, të cilat vlerësohen me kredite sipas sistemit ECTS.

Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike ka për qëllim formimin e plotë dhe bashkëkohor të studentëve në fushën specifike të mekatronikës, duke qenë njëkohësisht ndërlidhës i fushave të veprimtarisë së Inxhinierisë Elektrike, Elektronike e Mekanike. Programi i studimit Inxhinieri Mekatronike është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimet teknike-ekonomike kombëtare. Në shoqërinë e sotme, rritja e automatizimit të proceseve të ndryshme industriale, si një nga treguesit e zhvillimit të një vendi, ka sjellë si domosdoshmëri formimin e një inxhinieri mekatronik. Në këtë aspekt, inxhinieria mekatronike ka një rol dhe përgjegjësi shumë të madhe në zhvillimin ekonomik-shoqëror të vendit tonë, si një vend me industri të lehtë dhe ushqimore, ku vendin kryesor e zenë bizneset e vogla dhe të mesme.

Përgatitja e ofruar i lejon studentit të diplomuar në këtë program vazhdimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e dytë Master në Inxhinieri Mekatronike. Ky program ka gjithashtu si qëllim të jetë në përmirësim të vazhdueshëm dhe të përafrohet me programet e studimit të ngjashme në BE dhe që i përshtaten më mirë tregut dhe kërkesave të industrisë në Shqipëri.

Niveli i lartë i kualifikimit të stafit akademik që angazhohet në këtë program studimi është një garanci më shumë për vijueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e tij. Konkretisht stafi akademik mësimdhënës efektiv (PAE) në këtë program përbëhet nga 13 pedagogë, nga të cilët: 2 Prof. Dr., 2 Prof. Asoc., 6 Dr., dhe 3 MSc., si dhe 6 janë staf akademik me kontratë (PAK) 2 Prof. Dr. dhe 4 MSc.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga Prof. As., Dr. Agron DHIMA dhe Dr. Ing. Eli Vyshka, të përzgjedhur nga ASCAL.

Eksperte teknike e ASCAL është Msc. Arjana Alija.

Vlerësimi i Cilësisë u karakterizua nga profesionalizmi, vërtetësia, objektiviteti, paanshmëria, transparenca e plotë në të gjitha fazat e vlerësimit.

Kryerja e vlerësimit të jashtëm u bë sipas Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me Vendim nr. 531, datë 11.9.2018 të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me Vendim nr. 824, datë 24.12.2021 të Këshillit të Ministrave (sipas shtojcës nr. 3 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij për standardet shtetërore për sigurimin e cilësisë për programet e studimit të ciklit të parë Bachelor). Gjatë kësaj faze GVJ qëndron në kontakt të vazhdueshëm me ASCAL dhe asistohet nga kjo e fundit në rast kërkesë.

Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) u krye sipas formatit të hartuar nga ASCAL, duke mos bërë asnjë lloj ndryshimi (psh. bashkim kriteresh, heqje kriteresh, etj.), në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë.


Dorëzimi zyrtarisht në ASCAL brenda afatit të përcaktuar (në versionin e printuar dhe elektronik CD, firmosur nga GVJ në çdo faqe.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm në kuadër të vlerësimit dhe akreditimit të programit të studimit përbëhet nga 6 fusha për programet e ciklit të parë Bachelor:

1. Ofrimi, organizimi dhe drejtimi i programeve të studimit Bachelor
2. Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programeve të studimit të ciklit të parë Bachelor
3. Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat
4. Burimet njerëzore, financiare, infrastruktura, logjistika për realizimin e programit të studimit
5. Studentët dhe mbështetja e tyre
6. Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit Bachelor

GVJ për çdo fushë ka analizuar kërkesat e standardit / kriterëve, bazuar në evidencat e dosjes së vetvlerësimit. Bazuar në këtë analizë GVJ përcaktoi vlerësimin përfundimtar të përmbushjes së standardeve të çdo fushe dhe fushës në tërësi;

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm përmban edhe analizën përfundimtare duke vënë në dukje pikat e forta dhe të dobëta të tij.



“Universiteti Politeknik i Tiranës” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 19/09/2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 186/29 Prot, datë 19/09/2022. “Universiteti Politeknik i Tiranës” përcjell në ASCAL komentet, me anë të shkresës me Nr. 2088/3 Prot., datë 26/09/2022, “Kthim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm”.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft- Raportin, sqaron si vijon:

GVJ në FUSHA I – Standardi I.3 - Kriteri 2 - Fq.7: Sidoqoftë, situata e punësimit të specialistëve mekatronikë, të diplomuar në nivelin Bachelor, paraqet probleme. Ka një tendencë të përgjithshme, që studentët e diplomuar në nivelin Bachelor, të vazhdojnë studimet në nivelin Master. Ndofta është e nevojshme që të bëhen promovime më efikase nga FIE për trajtimin më objektiv të specialistëve me diplomë “Bachelor” si dhe të gjykohet në se shkollimi deri në këtë nivel siguron apo jo masivisht vende pune dhe në se nevojitet një kualifikim plotësues teorik e praktik i nivelit Master për të qënë i suksesshëm në tregun e punës. Gjithashtu, ndofta duhen rishikuar gjithë programet e degës “Inxhinieri Mekatronike” për të pasur vetëm një diplomë të integruar “Inxhinier Mekatronik” mbas studimeve të plota 5-vjeçare. Sigurisht që zgjidhjet më të mira duhet ti japin specialistët me përvojë të FIE dhe të Industrisë, ndërsa grupi ynë i vlerësimit të jashtëm mund të japë vetëm rekomandim për ta diskutuar këtë problem.

Komente nga GVB: Vlerësojmë nga kontaktet dhe kërkesat e vazhdueshme nga kompani të ndryshme vendase dhe të huaja, që profili për inxhinierin mekatronik, me diplomë Bachelor apo Master është i kërkuar në tregun vendas dhe të huaj. Kjo zgjedhje e studentëve për të vazhduar studimet Master është e kushtëzuar nga legjislacioni shqiptar në punësim, ku më i vlerësuar është inxhinieri mekatronik, që zotëron diplomë Master.

Eksperienca e universiteteve europiane tregon që organizimi në dy nivele të shkollimit Bachelor dhe Master të kësaj dege inxhinierike mundëson punësimin e shpejtë të studenteve. Gjithashtu, organizimi i njejtë i këtij programi studimi sipas universiteteve europiane, që UPT bashkëpunon, lehtëson mobilitetin e studentëve dhe u krijon mundësi atyre të vazhdojnë studimet në nivelin Master dhe në universitetet të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Komente nga GVJ: Për sa më sipër, u informuam dhe nga ana e IAL se punësimi i specialistëve mekatronikë, të diplomuar në nivelin Bachelor nuk paraqet probleme, por legjislacioni shqiptar favorizon të diplomuar në nivelin Master. Gjithashtu u informuam se organizimi në dy nivele të shkollimit, duke qenë i njehsuar me universitetet europiane lehtëson mobilitetet dhe punësimin. Megjithatë, mendimi i GVJ është se për tregun shqiptar do të ishte më e vlefshme një Diplomë e integruar e të 2 niveleve.

GVJ në FUSHA I – Standardi I.5 - Kriteri 4 - Fq.11: Gjithashtu, mendojmë që volumni i praktikës prej vetëm 4 kredite ECTS ose 80 orë faktike në fund të vitit të tretë, nga gjithsejt 180 kredite, është i pamjaftueshëm, sidomos për një program inxhinierik. Aktualisht, lëndët plotësuese ku bën pjesë dhe praktika profesionale, përbëjnë minimumin e krediteve (10.56 %), ndërkohë që VKM 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar me VKM 879, datë 18.12.2019 dhe VKM 185, datë 25.3.2021 kërkon një volum kreditesh prej 10 – 15 %. Pra ka vend që edhe ligjërisht të rritet ky nivel i krediteve të praktikës. Rekomandimi ynë është të rriten ndjeshëm kreditet e praktikës profesionale, duke shkurtuar kredite në lëndët e formimit të përgjithshëm si dhe të studiohet mundësia e shtrirjes së praktikës edhe në vitin e dytë.

FUSHA II – Standardi II.1 - Kriteri 4 - Fq.12: Përsërisim mendimin tonë, të shprehur në Standartin 1.5, Kriteri 4 që volumi i praktikës prej vetëm 4 ECTS ose 80 orë faktike në fund të vitit të tretë është i pamjaftueshëm dhe rekomandojmë shtimin e krediteve të praktikës.

Komente nga GVB: Falenderojmë GVJ për rekomandimin, të cilin do ta reflektojmë në rishikimin e planit mësimor.

GVJ në FUSHA III – Standardi III.1 - Kriteri 2 - Fq.21: Rekomandojmë që problemet e cilësisë në mësimdhënie për pedagogët përkatës, të evidentuara nga vlerësimet e studentëve, të analizohen në mënyrë transparente, të paktën brenda departamentit. Gjithashtu, për të siguruar një sistem vlerësimi më domethënës, rekomandojmë që përveç vlerësimit të pedagogëve nga studentët, të shtohet edhe vetëvlerësimi nga vetë pedagogët si dhe vlerësimi i pedagogëve nga eprorët e tyre të drejtpërdrejtë.

Komente nga GVB: Në lidhje me rekomandimin për analizimin transparent të cilësisë në mësimdhënie, të evidentuara nga vlerësimet e studentëve, ju informojmë se ato analizohen në mënyrë transparente në Departament, me procedurë të qartë, e cila është e përcaktuar në Rregulloren e programit të studimit dhe Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT.

Falenderojmë GVJ për rekomandimin e vetvlerësimit të pedagogëve, të cilën do ta reflektojmë në vijim gjatë analizës së procesit mësimor të programit të studimit.

Komente nga GVJ: Për sa më sipër, u informuam dhe nga ana e IAL për ekzistencën e procedurës dhe analizimin transparent të cilësisë në mësimdhënie.

GVJ në FUSHA III – Standardi III.2 - Kriteri 3 - Fq.24: Baza laboratorike e FIE është e një niveli të mirë. Por sidoqoftë ka vend gjithmonë për përmirësime, me heqjen nga përdorimi të pajisjeve laboratorike të vjetra dhe shtimin e pajisjeve laboratorike të reja, duke shmangur burokracitë eventuale nga procedurat e prokurimit publik. Sigurisht që pasurimi i bazës laboratorike kërkon investime të rëndësishme, ndërkohë që financat e FIE mund të jenë të pamjaftueshme. Rrugët kryesore mbeten përfitimet nga projektet e zhvillimit, nga bashkëpunimet me universitetet e huaja dhe nga kontributet financiare të bizneseve private për studime dhe zgjidhje problemesh teknike, të realizuara nga FIE dhe UPT.

Komente nga GVB: Nga ana e personelit akademik bëhen përpjekje maksimale për ndjekjen e procedurave të përcaktuara nga aktet ligjore në fuqi për blerjen e pajisjeve laboratorike për rinovimin dhe ngritjen e bazës laboratorike.

Komente nga GVJ: Për sa më sipër, nga ana e IAL na u vu në dukje se bëhen përpjekje maksimale për përmirësimin e bazës laboratorike.

GVJ në FUSHA III – Standardi III.3 - Kriteri 10 - Fq.27: Kemi konstatuar që faqja e web www.upt.al përmban informacione të sakta e të përditësuara për çdo fakultet e departament të Univeristetit Politeknik të Tiranës. Ndërsa faqja www.fie.upt.al përmban informacione të pasakta e të vjetëruara për Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike.

Komente nga GVB: Falenderojmë GVJ për rekomandimin, të cilin do ta reflektojmë sa më shpejt.

GVJ në FUSHA III – Standardi III.8 - Kriteri 6 - Fq.35: Rekomandojmë, që pavarësisht numrit të kufizuar të personelit akademik efektiv ndaj numrit të lartë të studentëve të programit Bachelor Inxhinieri Mekatronike, të studjohet mundësia që në të ardhmen, duke përdorur një

kriter përzgjedhës, si përshembull nota mesatare, një grup i vogël studentësh të realizojnë mbrojtjen e Diplomës me tema të caktuara.



Komente nga GVB: Falenderojmë GVJ për rekomandimin. Zbatimi i tij është i kushtëzuar nga ngarkesa mësimore e lejuar e stafit akademik efektiv të departamentit dhe cilësia e studentëve.

Komente nga GVJ: Për sa më sipër, u informuam dhe nga ana e IAL se realizimi i mbrojtjes së Diplomës me tema të caktuara kushtëzohet nga faktorë objektivë.

GVJ në FUSHA IV – Standardi IV.5 - Kriteri 1 - Fq.43: Konstatojmë se nuk ka evidencë të veçantë për Regulloren e Sekretarisë.

Komente nga GVB: Në lidhje me konstatimin e mungesës së evidencës së veçantë për sekretarinë mësimore ju informojmë se ajo është pjesë përbërëse e Rregullores së njësisë kryesore, FIE ku janë të përcaktuara detyrat e sekretarisë mësimore.

Komente nga GVJ: Për sa më sipër, u informuam dhe nga ana e IAL se Regullorja e Sekretarisë është pjesë përbërëse e Rregullores së FIE, dhe detyrat e sekretarisë mësimore janë të përcaktuara në të.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Mekatronike”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Në plotësim të kërkesave të përcaktuara në disa dokumenta kryesore si në nenin 3 të Statutit të Universitetit Politeknik të Tiranës - UPT [Evidenca 1 UPT Statuti], në Kreun I të Planit Strategjik 2019-2024 të UPT [Evidenca 2 UPT Plani Strategjik 2019- 2024] si dhe në Nenin 1 të Rregullores së Programit të Studimeve Bachelor në Inxhinieri Mekatronike [Evidenca 9 Departamenti i Automatikës DA Rregullore mësimore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike], Universiteti Politeknik i Tiranës, në këtë kuadër edhe Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike - FIE, ofrojnë programe në 3 ciklet e studimeve universitare, ku bën pjesë edhe programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike”, programe të cilët janë konform prioriteteve strategjike, interesave të zhvillimit të vendit dhe interesave kombëtare.			
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Sipas nenit 3, pika 3 e Statutit [Evidenca 1 UPT Statuti], UPT ka qëllim kryesor përparimin e shkencës, teknologjisë dhe arsimit të lartë nëpërmjet integritit të tyre, duke ruajtur e konsoliduar vlerat akademike, kulturore, kombëtare, demokratike e qytetare, duke forcuar qytetarinë e studentëve, të cilët do të integrohen në një shoqëri gjithëpërfshirëse. Programi i Studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike, synon t’u përgjigjet nevojave të industrisë shqiptare dhe zhvillimit ekonomik të vendit [Neni 4, Evidenca 9 DA Rregullore mësimore e PS Bachelor në Inxhinieri Mekatronike].			
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Në përputhje me qëllimet dhe misionin e tij [Evidenca 1 UPT Statuti], UPT zhvillon programe studimi për përgatitjen e inxhinierëve të ardhshëm në fushat e gjeologjisë, burimeve minerare, naftës dhe gazit, mekanike, materiale, tekstil dhe konfeksione, energjitike, automatizim industrie, mekatronikë, elektronike, telekomunikacion, inxhinieri informatike, inxhinieri matematike, inxhinieri fizike, ndërtim, mjedis, hidroteknikë, gjeodezi dhe në ato të arkitekturës dhe urbanistikës. Ndërsa Programi i Studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike organizohet dhe zhvillohet nga Departamenti i Automatikës në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike FIE, në bashkëpunim me fakultetet e tjera të UPT, në përputhje me qëllimet, misionin dhe objektivat e tij [Neni 3 dhe 4 Evidenca 9 DA Rregullore mësimore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike].			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Vlerësohet që programet e studimeve në UPT hartohen të tilla që të ndihmojnë në zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar [Neni 3 Evidenca 1 UPT Statuti]. Konkretisht, programi i studimit Bachelor në Inxhinierinë Mekatronike u jep studentëve njohuri të kombinuara të inxhinierisë elektrike, elektronike dhe mekanike, në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe për të nxitur zhvillimin e ekonomisë kombëtare [Neni 4 Evidenca 9 DA Rregullore mësimore e PS Bachelor në Inxhinieri Mekatronike] dhe [Neni 3 Evidenca 8 DA Rregullore e organizimit dhe funksionimit].			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve						
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programet e studimit të UPT dhe në FIE janë konform objektivave strategjike të zhvillimit të institucionit dhe statutit të Universitetit Politeknik të Tiranës [Evidenca 1 UPT Statuti], [Evidenca 2 UPT Plani Strategjik 2019-2024] dhe [Evidenca 5 FIE Strategjia 2018-2023]. Këto programe kanë pësuar vazhdimisht ndryshime përmirësuese duke u afruar me programet e studimit analoge europiane. Përputhshmëria me objektivat strategjike të institucionit është reflektuar edhe në strategjinë e zhvillimit të Departamentit të Automatikës, që ofron Programin e Studimit Bachelor në Inxhinierinë Mekatronike [Evidenca 8 DA Rregullore e organizimit dhe funksionimit].						
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	UPT përcakton qartë në Statut dhe në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular drejtimit prioritar akademike dhe karakteristikat e programeve të studimeve [Evidenca 1 UPT Statuti] [Evidenca 4 UPT Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies]. Programi i Studimit Bachelor në Inxhinierinë Mekatronike është një nga drejtimit akademike prioritar, i ofruar nga Departamenti i Automatikës DA në zbatim të dokumentave bazë të UPT të lartpërmendura dhe të FIE e DA [Neni 3 Evidenca 6 FIE Rregullore e brendshme], [Nenet 32,33 Evidenca 8 DA Rregullore e organizimit dhe funksionimit] dhe [Neni 1 Evidenca 9 DA Rregullore mësimore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike].						
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Programi i Studimit Bachelor ka marrë emërtimin “Inxhinieri Mekatronike” për shkak të njohurive të kombinuara të inxhinierisë elektrike, elektronike dhe mekanike. UPT ofron programe studimi në përputhje të plotë me misionin e UPT, në fusha të ndryshme inxhinierike, ku bën pjesë dhe inxhinieria mekatronike [Neni 3, Evidenca 1 UPT Statuti]. Këto fusha inxhinierike dhe programet përkatëse profilizojnë institucionin si një Universitet Politeknik. Organizimi, struktura dhe përmbajtja e studimeve universitare, në këtë kuadër edhe Programi i Studimit Bachelor në Inxhinierinë Mekatronike, janë në përputhje me fushat e drejtimit akademike të përcaktuara në statut dhe në Strategjinë e Zhvillimit të UPT dhe FIE [Evidenca 2 UPT Plani Strategjik 2019- 2024], [Evidenca 5 FIE Strategjia 2018 - 2023], [Kreu I Evidenca 4 UPT Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies] dhe [Evidenca 9 DA Rregullore mësimore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike].						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi I.3

Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në	Evidentohet që në Rregulloren e PS Bachelor në Inxhinieri Mekatronike përcaktohen objektivat e këtij programi në lidhje me dhënien studentëve të njohurive të kombinuara të inxhinierisë elektrike, elektronike dhe mekanike, për të përvetësuar kompetenca profesionale, nëpërmjet metodave inovative dhe për të mundësuar integrimin sa më të shpejtë në tregun e punës [Evidenca 9 DA Rregullore mësimore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Mekatronike]. Informacioni i plotë përsa u përket dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale, që duhet të fitojnë studentët gjatë ndjekjes së Programit të Studimit shprehet dhe në syllabuset e lëndëve përbërëse të programit [Evidenca 12 Silabuset e programit të studimit].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në Industrinë Mekatronike është relativisht i ri, ka filluar në vitin akademik 2006 – 2007, pa pasur një studim të mirëfilltë për nevojat e tregut të punës për specialistë të mekatronikës. Por duke pasur parasysh që hartimi dhe riorganizimi i programeve të studimit në UPT merr në konsideratë nevojat e tregut të punës lokal e ndërkombëtar [Neni 8, Evidenca 4 UPT Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies], në vitet pasardhëse filloi kryerja e studimeve të tilla, për të përmirësuar programin e studimit me qëllim integrimin e të diplomuarve në tregun e punës [Evidenca 13 Studimi i tregut të punës].</p> <p>Sipas këtij studimi të kryer nga Departamenti i Automatikës të FIE rezultojnë se në Shqipëri tregu i punës kërkon specialistë mekatronikë në automatizimin e prodhimit në ndërmarrjet industriale të vogla, veçanërisht në ato “fason”, në industrinë ushqimore, në automatizimin e disa shërbimeve në hoteleri, në shërbimet dhe produktet e reja të teknologjisë së informacionit dhe në automatizimin e mjeteve të transportit, pra në një fushë të gjerë veprimi.</p> <p>Përsa i përket punësimit të të diplomuarve në Bachelor Inxhinieri Mekatronike, sipas të dhënave të paraqitura në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, për 3 vitet e fundit akademike 90 deri 96 % e të diplomuarve vazhdojnë studimet në 4 programet e Masterit të ofruara nga Departamenti i Automatikës, ndërsa vetëm 4 deri 10 % e të diplomuarve punësohen, bile edhe ata përgjithësisht rikthehen pas një kohe të shkurtër në FIE për të vazhduar Masterin.</p> <p>Më konkretisht për studentët e Nivelit Bachelor Mekatronikë, nga disa plotësime të dërguara Rektorit të UPT nga FIE më datë 15.07.2022, del që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për vitin 2019 – 2020, nga 52 studentë të diplomuar, 19 vazhduan studimet në Master Profesional, 31 vazhduan studimet në Master Shkencor dhe vetëm 2 u punësuan në sektor shtetëror apo privat (pa specifikuar punëdhënësin dhe sektorin e punës). • Për vitin 2020 – 2021, nga 31 studentë të diplomuar, 24 vazhduan studimet në Master Profesional, 5 vazhduan studimet në Master Shkencor dhe vetëm 2 u punësuan në sektor shtetëror apo privat (pa specifikuar punëdhënësin dhe sektorin e punës). • Për vitin 2021 – 2022, 8 të diplomuar nga studentët e prapambetur vazhdojnë që të gjithë studimet në Master Profesional. <p>Problemi i punësimit të mekatronistëve mbas diplomimit në nivelin Bachelor u diskutua gjerësisht me studentët dhe pedagogët në takimet e dt. 13 dhe 14 korrik 2022. Ka argumentime të ndryshme, që lidhen me mundësinë e punësimit part-time paradite, kur ndërkohë vazhdojnë studimet në Master mbasdite, apo që studentët e sapodiplomuar me nivelin Bachelor demotivohen për punësim, pasi Administrata Shtetërore rekruton specialistë të lartë që kanë të paktën diplomën “Master Profesional” (mendojmë që sektori privat nuk mund të ketë një tendencë të tillë).</p> <p><u>Sidoqoftë, situata e punësimit të specialistëve mekatronikë, të diplomuar në nivelin Bachelor, paraqet probleme. Ka një tendencë të përgjithshme, që studentët e diplomuar në nivelin Bachelor, të vazhdojnë studimet në nivelin Master. Ndofta është e nevojshme që të bëhen promovime më efikase nga FIE për trajtimin më objektiv të specialistëve me diplomë “Bachelor” si dhe të gjykohet në se shkollimi deri në këtë nivel siguron apo jo masivisht vende pune dhe në se nevojitet një kualifikim plotësues teorik e praktik i nivelit Master për të qënë i suksesshëm në tregun e punës. Gjithashtu, ndofta duhen rishikuar gjithë programet e degës “Inxhinieri Mekatronike” për të pasur vetëm një</u></p>

	<p>diplomë të integruar “Inxhinier Mekatronik” mbas studimeve të plota 5-vjeçare. Sigurisht që zgjidhjet më të mira duhet ti japin specialistët me përvojë të FIE dhe të Industrisë, ndërsa grupi ynë i vlerësimit të jashtëm mund të japë vetëm rekomandim për ta diskutuar këtë problem.</p> <p>Pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së FIE, si fakulteti i UPT, është pjesëmarrja në Panairët e Punës që organizohen në ambjentet e UPT ose/dhe në panairët e organizuara në bashkëpunim me institucione dhe organizma të ndryshëm (Bashkia e Tiranës, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Ministria e Arsimit dhe Sporteve). Panairët kanë shërbyer për njohjen e studentëve me kompanitë, për mundësitë për intership-e e trajnime dhe aplikime për punësime [Evidenca 21 Panairi “Work Study”]. Në kuadrin e Projektit GRADUA studentët e Programit të Studimit janë trajnuar dhe kanë kontaktuar kompani të ndryshme të profesionit, si FOSHNER, ALBAELECTRICA, etj. [Evidenca 22 Sondazhe mbi tregun e punës dhe kompanitë – Projekti GRADUA].</p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Në nivelin Bachelor studenti fiton njohuri bazë në fushën përkatëse inxhinierike, që e ndihmojnë studentin në karrierën e tij të zgjidhë probleme teknike, të projektojë, të prodhojë pajisje të thjeshta, të menaxhojë projekte, të komunikojë dhe punojë në grup, etj. Këto koncepte janë sintetizuar në planin mësimor [Evidenca 24 Plani mësimor i programit të studimit BCH MEK] dhe në syllabuset e lëndëve [Evidenca 12 Syllabuset e programit të studimit].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Në dokumentat e paraqitura nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm për Programin Bachelor Inxhinieri Mekatronike jepen mjaft të dhëna për 7 fakultete dhe Institutin e Gjeoshkencave të UPT, ndër të cilët dhe Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike – FIE, i ngritur që në vitin 1953 pa shpërbërje nga puna. Në ato dokumenta bëjnë pjesë informacione të ndryshme për studentët [Evidenca 55 Broshura informuese, Guida për studentët], Statuti i UPT [Evidenca 1 UPT Statuti], Organigrama e FIE [Evidenca 96 FIE Organigrama], tabela për personelin akademik dhe programet e ndryshme të studimit në FIE, etj. FIE është njësi përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Mekatronike. Fakulteti organizohet në 3 departamente (i Automatikës, i Elektroteknikës dhe i Sistemeve Elektrike të Fuqisë) [Neni 7 Evidenca 6 FIE Rregullore e Brendshme], ndër të cilët Departamenti i Automatikës ofron Programin e Studimit. Personeli akademik efektiv i Departamentit përbëhet nga 2 personel akademik “Profesor”, 2 personel akademik “Profesor i Asociuar”, 6 personel akademik “Doktor”, 3 personel akademik “Master i Shkencave”, dhe 3 personel ndihmës akademik “Master i Shkencave”. Gjithashtu, Departamenti i Automatikës ka, si personel akademik me kontratë, 2 Profesorë dhe 4 pedagogë “Master i Shkencave” [Evidenca 116 Tabelat e Referencës BCH MEK]. Në funksion të Programit të Studimit janë edhe labororet e ndryshëm [Evidenca 74 Labororet FIE]. Në përfundim mund të thuhet që Institucioni demonstroi përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e programeve e në këtë kuadër edhe të programit BSc Inxhinieri Mekatronike.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit /kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Inxhinieria Mekatronike është një ndër fushat didaktike dhe shkencore të FIE, misioni i të cilit është të krijojë, transmetojë, zhvillojë e të mbrojë dijet nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve të ndryshme; të formojë specialist të lartë në fushën e Inxhinierisë Elektrike, Elektronike dhe Mekatronike [Neni 3 Evidenca 6 FIE Rregullore e Brendshme]. Veprimtaria akademike e FIE zhvillohet konform parimeve dhe standardeve të Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL), parimeve dhe objektivave të Procesit të Bolonjës, si dhe kornizën ligjore në fuqi [Neni 4 Evidenca 6 FIE Rregullore e Brendshme]. Hartimi dhe zbatimi i programit të studimit është në përputhje me kodifikimin e programit të studimit sipas klasifikimeve kombëtare mbështetur në Ligjin për Arsimin e Lartë nr. 80/2015 dhe direktivave e udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>		
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Kemi konstatuar që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike është në përputhje me fushën akademike të Departamentit të Automatikës, si njësi bazë për këtë program studimi, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane [Kreu V Evidenca 8 DA Rregullore e organizimit dhe funksionimit].</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi L5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Verifikohet që ekziston një bashkëpunim i frytshëm ndërmjet FIE dhe UPT për mbarëvajtja e programeve të studimit, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë kryesore dhe njësisë bazë, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike drejtohet nga Departamenti i Automatikës në FIE, por si program multidisiplinor ai ofrohet në bashkëpunim me disa departamente të tjera nga Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike [Evidenca 24 Plani mësimor i programit të studimit BCH MEK], [Neni 6 Evidenca 9 DA Rregullore mësimore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike]. Evidentohet që për çdo program studimi ka një bashkëpunim të mirë, brenda dhe jashtë DA, me personelin akademik efektiv e të ftuar (me kontratë) dhe personelin ndihmës akademik, të angazhuar në procesin e mësimdhënies, me sekretarinë mësimore dhe me personelin administrativ të FIE [Nenet 34 deri 41 Evidenca 6 FIE Rregullore e Brendshme] si dhe me Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UPT.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>UPT ka marrëveshje bashkëpunimi me 34 universitete të huaja, 34 institucione të huaja në kuadër të ERASMUS+, 14 universitete shqiptare, 15 institucione shtetërore shqiptare, në funksion të realizimit të objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, shkëmbimit të personelit akademik për mësimdhënie, trajnimit të personelit akademik dhe të studentëve si dhe të realizimit të qëllimit strategjik për rritjen e njohjes ndërkombëtare të diplomave të UPT [Evidenca 34 Lista e marrëveshjeve aktive bashkëpunuese me universitete brenda dhe jashtë vendit]. Gjatë viteve të fundit janë shtuar bashkëpunimet veçanërisht në kuadër të projekteve ERASMUS+, KA1 dhe KA2.</p> <p>Për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike, UPT dhe FIE kanë marrëveshje bashkëpunimi me biznesmenë vendës si dhe me sipërmarrje të ndryshme industriale, për të cilat janë informuar studentët, veçanërisht ata të vitit të tretë, në mënyrë që të zgjedhin kompaninë për kryerjen e praktikës profesionale dhe për të parë mundësinë e punësimit mbas diplomimit, si për shembull kompanitë EVEREST, KRAKO, Fabrika e çimentos Fushë Krujë, etj. [Evidenca 40 FIE Marrëveshjet e bashkëpunimit me kompanitë private dhe shtetërore].</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>FIE dhe DA si njësi përgjegjëse për zbatimin e programit të studimit kanë analizuar rezultatet e punës bashkëpunuese dhe përfitimet që vijnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit, veçanërisht për praktikën e studentëve si dhe për kërkesat specifike që kanë kompanitë për cilësinë e përgatitjes profesionale të studentëve si specialistë të ardhshëm në profilin e Mekatronikës.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Siç u përmend në Kriterin 2 paraardhës, UPT dhe FIE kanë marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi me kompani të sektorit privat, [Evidenca 40 FIE Marrëveshjet e bashkëpunimit me kompanitë private dhe shtetërore], nëpërmjet të cilave hartohen kontratat për praktikën profesionale të studentëve, me të drejtat dhe detyrimet e palëve [Evidenca 45 Kontratë tip për praktikën në BCH MEK]. Në përfundim të praktikës kompania dhe pedagogu përgjegjës hartojnë raportet përkatëse [Evidenca 41 Template për relacionin e kompanisë për praktikën] dhe [Evidenca 42 Template për pedagogun përgjegjës për praktikën], studentët përdorin pyetësorin për praktikën [Evidenca 44 Template e pyetësorit për praktikën] dhe e mbrojnë relacionin përkatës para Komisionit të Mbrojtjes së Praktikës [Evidenca 47 Relacioni studentit BCH MEK për praktikën] [Evidenca 53 DA Komisionet e provimeve dhe komisionet e praktikës].</p> <p><u>Pra nga shqyrtimi i këtyre dokumentave del që situata për praktikën është e mirë. Megjithatë mendojmë që ka vend për përmirësime në menaxhimin e praktikantëve në bizneset private, në angazhimin e studentëve në punë konkrete, për të shmangur formalizmin dhe fiktivitetin në bërjen e praktikës si dhe indiferencën e bizneseve në kushtet e mungesës së stimulave materiale apo financiare/fiskale. Një ndihmë të mirë në këtë drejtim mund të japin edhe marrëveshjet treshë, që UPT mund të propozojë, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave apo asaj të Energjisë dhe Infrastrukturës (që mbulon fushën e biznesit përkatës) si dhe UPT.</u></p> <p><u>Gjithashtu, mendojmë që volumi i praktikës prej vetëm 4 kredite ECTS ose 80 orë faktike në fund të vitit të tretë, nga gjithsej 180 kredite, është i pamjaftueshëm, sidomos për një program inxhinierik. Aktualisht, lëndët plotësuese ku bën pjesë dhe praktika profesionale, përbëjnë minimumin e krediteve (10.56 %), ndërkohë që VKM 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar me VKM 879, dt. 18.12.2019 dhe VKM 185, dt. 25.3.2021 kërkon një volum kreditesh prej 10 – 15 %. Pra ka vend që edhe ligjërisht të rritet ky nivel i</u></p>

	krediteve të praktikës. Rekomandimi ynë është të rriten ndjeshëm kreditet e praktikës profesionale, duke shkurtuar kredite në lëndët e formimit të përgjithshëm si dhe të studjohet mundësia e shtrirjes së praktikës edhe në vitin e dytë.			
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Sipas kërkesave të punëdhënësve përkatës, UPT, FIE dhe konkretisht DA shprehin gatishmërinë për të kryer trajnime profesionale të mëtjshme në formën e kurseve të formimit të vazhduar për të diplomuarit me Programin e Studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Organizimi i PS Bachelor në Inxhinieri Mekatronike është në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë 80/2015, VKM 41, datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" ndryshuar me VKM 879, datë 18.12.2019 dhe VKM 185, datë 25.03.2021, Statutin e UPT, Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies të UPT dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi mësimor është i organizuar në bazë lënde, pesha e të cilave është vlerësuar në kredite ECTS, ku përcaktohen elementët bazë të krediteve dhe korrespondencës së kreditit me orët totale të punës së studentit (ngarkesë në auditor + ngarkesë jashtë auditorit), numrin total të krediteve në një vit akademik, ngarkesën javore, etj. Edhe vetë brenda lëndës tipologjitë didaktike të saj (leksione, ushtrime, laboratore, etj.) vlerësohen me kreditet përkatëse të dhëna në planin mësimor të programit ashtu edhe në syllabuset e çdo lënde, të hartuara në mënyrë korrekte. Në rregulloren e programit të studimit [Evidencë 9 - DA - Rregullore mësimore e programit të studimit Bachelor në Inxhinien Mekatronike, neni 6] jepet struktura e programit të studimit dhe karakterizohet nga veprimtaritë formuese të grupuara në: a) Lëndë bazë, b) Lëndë karakterizuese, c) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese, d) Lëndë plotësuese, e) Detyrime përmbyllëse. <u>Përsërisim mendimin tonë, të shprehur në Standartin 1.5. Kriteri 4 që volumni i praktikës prej vetëm 4 ECTS ose 80 orë faktike në fund të vitit të tretë është i pamjaftueshëm dhe rekomandojmë shtimin e krediteve të praktikës.</u>
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një	Vlerësojmë që programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike", si program studimi 3-vjeçar i ciklit të parë, synon formimin e studentëve me njohuri bazë dhe shprehje në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Ilojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Inxhinieria Mekatronike trajton aspektet aplikative të njohurive të kombinuara të inxhinierisë elektrike, elektronike dhe mekanike, nëpërmjet automatizimit të proceseve të ndryshme industriale. Si e tillë, ajo mund të ndikojë ndjeshëm në zhvillimin ekonomik të vendit tonë, me industri në shkallë të vogël deri të mesme. Në planin mësimor të këtij program studimi zhvillohen lëndë të inxhinierisë elektrike si: Elektroteknika 1 dhe 2, Matjet elektronike, Makina elektrike, Transmisione elektrike, etj.; lëndë të inxhinierisë mekanike si: Ndërtim makinash, Vizatim teknik, Teknologjia mekanike, Teoria e sistemeve mekanike, etj.; lëndë të inxhinierisë elektronike si: Elektronika e fuqisë, Teoria e sinjaleve, Elemente dhe teknologjitë elektronike, Sistemet elektronike, etj. [Evidencë 9 - DA - Rregullore mësimore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike]; [Evidencë 24 - DA - Plani mësimor i programit të studimit BCH MEK].</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparura në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Në përputhje me syllabuset e lëndëve [Evidenca 12 Syllabuset e programit të studimit] evidentohet që programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike” i pajis studentët me njohuri të përparura teorike e praktike në fushën e studimit, nëpërmjet zhvillimit të leksioneve, ushtrimeve, laboratorëve, detyrave/projekteve dhe praktikës profesionale. Sipas interesave, studentët mund të zgjedhin ndër lëndët me zgjedhje të planit mësimor si dhe të zgjedhin kompaninë apo institucionin, ku ata dëshirojnë të bëjnë praktikën profesionale [Evidenca 9 - DA - Rregullore mësimore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike, neni 4]; [Evidenca 24 - Plani mësimor i programit të studimit BCH MEK]; [Evidenca 12 - Syllabuset e programit të studimit]; [Evidenca 18 - Lista e Institucioneve bashkëpunuese për praktikën profesionale].</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike” synon të japë njohuri sipas nivelit 6 të “Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve”, për krijimin e aftësive të përparura në fushën akademike ose profesionale të punës ose studimit. Rregulloret dhe syllabuset e programit përmbledhin në mënyrë të plotë e të saktë llojet dhe masën e njohurive, aftësive dhe kompetencave të avancuara për zgjidhjen e problemeve në fushën e inxhinierisë mekatronike. [Evidenca 9 - DA - Rregullore mësimore e PS Bachelor në Inxhinieri Mekatronike]; [Evidenca 24 - Plani mësimor i programit të studimit BCH MEK]; [Evidenca 12 - Syllabuset e programit të studimit].</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike” dhe elementet përbërës të tij janë në përputhje me VKM 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar, si lëndët me kreditet përkatëse, sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve ECTS (gjithsejt 180 kredite); kontrolli i dijeve dhe instrumenteve të vlerësimit; objektivat formuese dhe kompetencat profesionale; veprimtaritë formuese, kategorizimi i tyre dhe plani mësimor; kriteret e pranimit; diploma në përfundim të studimeve sipas formatit të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe Suplementi përkatës, etj. [Evidenca 4 - UPT - Rregullore e Zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies]; [Evidenca 9 - DA - Rregullore mësimore e PS Bachelor në Inxhinieri Mekatronike]; [Evidenca 24 - Plani mësimor i programit të studimit BCH MEK]; [Evidenca 12 - Syllabuset e programit të studimit].</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Veprimtaritë formuese paraqiten në programin e studimit të grupuara sipas kategorive, të përcaktuara dhe të shoqëruara me kreditet përkatëse në VKM 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar me VKM 879, dt. 18.12.2019 dhe VKM 185, dt. 25.3.2021) si më poshtë: - lëndë bazë të programit të studimit për formimin e përgjithshëm me 35 kredite ose 19.44 % nga 15 – 20 % që kërkon VKM 41;</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>- lëndë karakterizuese, për një formim specifik me 95 kredite ose 52.78 % nga 50 – 55 % që kërkon VKM 41;</p> <p>- lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, profile të programit dhe grup- lëndë me zgjedhje me 25 kredite ose 13.89 % nga 12 – 15 % që kërkon VKM 41;</p> <p>- lëndë plotësuese, për përfitim e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara me 19 kredite ose 10.56 % nga 10 – 15 % që kërkon VKM 41;</p> <p>- detyrime përmbyllëse, për përgatitjen e provimit përfundimtar me 6 kredite ose 3.33 % nga 3 – 5 % që kërkon VKM 41.</p> <p>Komponentët mësimorë, ndahen në mësim në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë), forma të kontrollit të vazhdueshëm, studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash, prezantime dhe projekte), përgatitje për provime, veprimtari të tjera, si praktika profesionale pranë subjekteve publike ose private.</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Sipas strukturës, përbërjes, rregulloreve të brendshme, funksionimit dhe drejtimit, FIE, si njësi kryesore, përbush detyrimet ligjore të legjislacionit në fuqi, në këtë kuadër edhe për vlerësimin dhe akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike”. Në përputhje me VKM 824, datë 05.12.2007, FIE u riorganizua në 3 njësi bazë: Departamenti i Automatikës, Departamenti i Elektroteknikës, Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë [Evidenca 15 – FIE – VKM 824 VKM 05_12_2007].</p> <p>FIE përbush të gjitha detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin në përputhje me Ligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH” nr. 80/2015, neni 23 dhe 25, në lidhje me numrin e departamenteve, numrin e personelit me tituj dhe grada, kualifikimin e drejtuesve të departamenteve e dekanatit të kontrolluar nga ASCAL, i cili më pas dërgoi axhendën për akreditimin e programit të studimit [Evidenca 19 Axhenda e ASCAL].</p> <p>Ligji nr. 80/2015 në nenin 23, pika 2 përcakton se Fakulteti organizohet në së paku tri njësi bazë, ku dy prej të cilave janë departamente. Në përputhje me këtë ligj, neni 57, pika 1:</p> <p>Aktualisht, FIE, si njësi kryesore, ka gjithsej 43 pedagogë (30 PAE dhe 13 PAK). Ndërsa Departamenti i Automatikës si njësi bazë për programin e studimit, ka gjithsej 19 pedagogë (13 PAE dhe 6 PAK).</p> <p>DA ofron 7 (shtatë) programe studimi në të tre ciklet e studimit (Bachelor në Inxhinieri Mekatronike; Bachelor në Inxhinieri Elektrike, profili Automatizimi i Industrisë; Master Profesional në Inxhinieri Mekatronike; Master Profesional në Inxhinieri Elektrike, profili Automatizimi i Industrisë; Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike; Master i Shkencave në Inxhinieri Elektrike, profili Automatizimi i Industrisë; Studime të doktoratës në Inxhinieri Elektrike, nënfusha “Automatizimi i Industrisë”.</p>

	Përsa më lart, DA përmbush detyrimet ligjore e nënligjore për vlerësimin dhe akreditimin e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike".			
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	Programi menaxhohet nga Këshilli i Programit të Studimit (KPS), i cili përbëhet nga anëtarë pedagogë me përvojë mbi 10-vjeçare, të miratuar nga Dekanati i FIE [Evidenca 4 – UPT – Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies], Neni 4. Drejtuesi i KPS është koordinatori i programit të studimit. Funksonet e KPS dhe detyrat e Koordinatorit të programit të studimit përcaktohen në nenet 5 e 6 të asaj rregulloreje. Koordinatori monitoron punën për miradministrimin e programit dhe mbështet iniciativat për përmirësimin e mësimdhënies dhe praktikave profesionale, punon për organizimin e kontakteve dhe marrëveshjet me institucionet shtetërore dhe kompanitë private, angazhohet për mbështetjen e stafit më të ri akademik të FIM, stafit ndihmës akademik si dhe ish studentëve të diplomuar [Evidenca 9 – DA – Rregullore mësimore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike], nenet 9, 10, 11.			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Përveç 3 departamenteve të lartpërmendur si njësi bazë, FIE ka 4 njësi ndihmëse (Sekretaria mësimore, Dega e Financës, Dega e këshillimit të karrierës dhe Alumni dhe Qendra multimediale). Struktura akademike e FIE përbëhet nga Asambleja e personelit akademik, Dekanati, Dekani, Zv. Dekanët. Departamenti i Automatikës po organizohet në grupe mësimore shkencore në përputhje me Udhëzimin nr. 27, datë 29.12.2017 «Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në Institucionet publike të arsimit të lartë», pika 6 e 7, me rregulloret e brendshme të FIE dhe DA. Kemi konstatuar që organizimi dhe struktura akademike e FIE, si njësi kryesore dhe e DA, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit, janë në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.			
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	FIE, si njësi kryesore që ofron PS në Inxhinieri Mekatronike, plotëson bile tejkalon kërkesat ligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Aktualisht, ndër 30 pedagogët PAE të fakultetit, ka 4 profesorë, 3 profesorë të asociuar, 13 doktorë shkencash dhe 10 me diplomën Master Shkencor. Ndërsa ndër 13 pedagogët PAK të fakultetit ka 2 profesorë, 1 profesor të asociuar, 3 doktorë shkencash dhe 7 me diplomën Master Shkencor. Ndërsa Departamenti i Automatikës DA, si njësi bazë e FIE, përgjegjëse për këtë program studimi, plotëson të gjitha kriteret ligjore (Ligji 80/2015), duke patur një personel akademik të kualifikuar me tituj e grada shkencore. Aktualisht, ndër 13 pedagogët PAE të departamentit ka 2 profesorë, 2 profesorë të asociuar, 6 doktorë shkencash dhe 3 me diplomë Master shkencor. Gjithashtu, departamenti angazhon edhe 3 personel ndihmës akademik me diplomë Master Shkencor. Ndërsa ndër 6 pedagogët PAK të departamentit ka 2 profesorë dhe 4 PAK me diplomë Master Shkencor [Evidenca 116 - Tabelat e Referencës BCH MEK].			
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Organizimi dhe struktura akademike e FIE dhe departamenteve përbërës është në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Ky vlerësim bazohet në të dhënat e paraqitura në Kriterin 3 të këtij Standarti.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standarti II.3

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Vlerësojmë që FIE si njësi kryesore dhe Departamenti i Automatikës si njësi bazë përgjegjëse për PS Bachelor në Inxhinieri Mekatronike disponojnë gjithë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi. Konkretisht, organizimi i programit të studimit bazohet në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT [Evidenca 4 – UPT - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies]; në Rregulloren e brendshme të Fakultetit [Evidenca 6 – FIE - Rregullore e brendshme] dhe në Rregulloren e Departamentit të Automatikës [Evidenca 9 – DA – Rregullore mësimore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike].</p> <p>Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit bazohet në Programin Mësimor, ku jepet informacion i plotë mbi shpërndarjen e krediteve dhe orëve në çdo vit akademik, pranimin e studentëve, kontrollin e dijeve, diplomimin dhe sigurimin e cilësisë, etj.; në Planin Mësimor, i miratuar në të gjitha nivelet e drejtimit, deri tek Rektori i UPT, ku paraqiten disiplinat e ndryshme dhe shpërndarja e tyre në gjithë procesin mësimor; në syllabuset e lëndëve; në aplikimet për praktikat profesionale; në mënyrën e zhvillimit të provimit përfundimtar; në formatin e diplomës dhe suplementit të saj. Këto informacione paraqiten në dokumentat e ndryshme [Evidenca 9 - DA - Rregullore mësimore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike]; [Evidenca 24 - Plani mësimor i programit të studimit BCH MEK]; [Evidenca 12 - Syllabuset e programit të studimit]; [Evidenca 49 - Suplementi i diplomës BCH.MEK]; [Evidenca 50 - Modeli i diplomës BCH MEK (Urdhëri i aprovimit)]; [Evidenca 51 - FIE - Orari i Mësimit dhe Orari i Provimeve BCH]; [Evidenca 52 - DA - Procedure e komisionit <i>Ad-Hoc</i> për pranimin e studenteve në BCH MEK dhe AUT]; [Evidenca 53 - DA - Komisionet e provimeve dhe Komisionet e praktikës]; [Evidenca 54 - DA - Rregullore e provimit dhe Matërialet orientuese për provimin e formimit BCH MEK].</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike organizohet në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018 i ndryshuar. Komentet dhe informacioni i plotë për aktivitetet formuese janë paraqitur në Standartin II.1, Kriteri 6. Dokumentat referuese janë [Evidenca 4 – UPT - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies], [Evidenca 9 - DA - Rregullore mësimore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike], [Evidenca 24 - Plani mësimor i programit të studimit BCH MEK].</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Bazuar në Ligjin për arsimin e lartë, VKM 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar me VKM 879, dt. 18.12.2019 dhe VKM 185, dt. 25.3.2021) si dhe në dokumentat e FIE [Evidenca 9 - DA - Rregullore mësimore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike] dhe [Evidenca 24 - Plani mësimor i programit të studimit BCH MEK] vlerësojmë që kohëzgjatja e programit të studimit (3 vite akademike), me nga 2 semestra dhe 60 ECTS për çdo, shpërndarja e krediteve për komponentët e ndryshëm të procesit mësimor, kanë përputhje me sistemin shqiptar dhe evropian të studimeve universitare të ciklit të parë.</p> <p>Sidoqoftë, duke marrë shkas nga situata aktuale e punësimit të specialistëve mekatronikë, të diplomuar në nivelin Bachelor, përsërisim rekomandimin tonë që specialistët me përvojë të FIE dhe Industrisë të diskutojnë mbi mundësinë e zbatimit të sistemit 5-vjeçar me diplomë të integruar.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e</p>	<p>Pjesë përbërse të programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike” janë plani mësimor dhe syllabuset e lëndëve, me informacionet e nevojshme dhe të mjaftueshme për fushën, kohëzgjatjen, strukturën e studimit, kreditet për</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>lëndët dhe shpërndarjen e tyre për leksione, ushtrime, seminare, laboratorë, detyra, projekte, praktika, etj., ngarkesat për auditor dhe jashtë tij, kontrollin e njohurive, mënyrat e vlerësimit, literaturën bazë dhe ndihmëse dhe elementë të tjerë [Evidenca 24 - Plani mësimor i programit të studimit BCH MEK], [Evidenca 12 - Syllabuset e programit të studimit].</p>		
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në dokumentacionin e FIE jepet informacion i plotë për kriteret e përgjithshme dhe ato specifike të programit të studimit mbi pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve.</p> <p>Kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit jepen në Rregulloren e zhvillimit kurrikular në UPT, neni 19 [Evidenca 4 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies]. Kandidatët fitues përzgjidhen nga Komisioni <i>Ad-Hoc</i>, i propozuar nga DA dhe i miratuar nga Dekanati i FIE [Evidenca 52 - DA - Procedurë e komisionit <i>Ad-Hoc</i> për pranimin e studentëve në BCH MEK dhe AUT]. Transferimi i studentëve në programe studimi të njëjta ose të afërta, vendase ose të huaja, dhe ekuivalentimi i studimeve rregullohen me dokumentat [Evidenca 4 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies], kreu VI, transferime, njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i lëndëve; [Evidenca 9 - DA - Rregullore mësimore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike], nenet 12 dhe 15; [Evidenca 57 - Procedurë transferim studimi në programin e studimit BCH MEK]; [Evidenca 58 - Njohje kredite në programin e studimit në BCH MEK transferime brenda vendit] dhe [Evidenca 59 - Njohje kredite për studentë në Erasmus].</p>		
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Plani Mësimor [Evidenca 24 - Plani mësimor i programit të studimit BCH MEK] dhe syllabuset [Evidenca 12 - Syllabuset e programit të studimit] japin informacione të plota mbi strukturën e lëndëve, veprimtarinë mësimore brenda auditorit apo jashtë tij, njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti, rezultatet e të nxënit, forma e kontrollit që do të përdoret, mënyra e vlerësimit përfundimtar, literatura bazë dhe ajo ndihmëse, etj. Mënyra e hartimit dhe miratimit të planit mësimor dhe të syllabuseve është konform [Evidenca 4 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies], neni 13.</p>		
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Me qëllim reflektimin e kërkesave të tregut të punës, përvojave më të mira nga universitetet homologe europiane, ndryshimet e objektivave dhe strategjive kombëtare, mendimet e pedagogëve dhe opinionet e studentëve programet e studimit duhen përmirësuar e përditësuar vazhdimisht, nevojë kjo që shprehet në dokumentat [Evidenca 4 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies]; [Evidenca 9 - DA - Rregullore mësimore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike], neni 21; [Evidenca 31 - DA - Raporti i procesit mësimor] dhe [Evidenca 33 - Sondazhi me studentët 2019 - 2020, Sem. I, Sem. II]. Në tre vitet e fundit akademike plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike nuk ka ndryshuar, ndërsa përmbajtja e programet e lëndëve janë përmirësuar me synim njohuritë për zhvillimet e reja teknologjike.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësohet se ngarkesa mësimore, struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë 80/2015, nenet 70 e 73, VKM 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit”, i ndryshuar me VKM 879, datë 18.12.2019 dhe VKM 185, datë 25.03.2021, me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe European të Kualifikimeve: Niveli 6; Programe studimi Bachelor (Diplomë Universitare). Në përfundim të programit të studimit studentët duhet të plotësojnë 180 kredite (nga 60 kredite për çdo vite akademik), me nga 2 semestra në vit me të paktën 14 javë secili, me raporte të përcaktuara orë mësimore në auditor : orë pune e pavarur, bazuar në dokumentat e UPT, FIE dhe DA [Evidenca 4 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies]; [Evidenca 8 - DA - Rregullore e organizimit dhe funksionimit]; [Evidenca 24 – Plani mësimor i programit të studimit BCH MEK]. Ngarkesat mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratore janë sipas [Evidenca 116 – Tabelat e referencës BCH MEK].</p> <p>Organizimi i mësimdhënies dhe sezonit të provimeve, shpallet në strukturën mësimore, e cila miratohet dhe shpallet nga Rektori i UPT në fillim të çdo viti akademik [Evidencë.60 - UPT - Struktura mësimore 2021-2022].</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit për Inxhinieri Mekatronike faktikisht ka gati 20 vite që zhvillohet në FIE, në fillim në sistemin 5 vjeçar dhe tani sipas procesit të Bolonjës [Evidencë. 16 - VKM për emërtim të programit të studimit BCH MEK]. Emërtimi i programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike”, përmbajtja e veprimtarive mësimore, shpërndarja e lëndëve, etj., të organizuara sipas objektivave të formimit, mundësojnë marrjen e njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme si dhe për punësimin në ndërmarrje vendase të prodhimit, shërbimeve dhe në sektorë të ndryshëm industrialë.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësisimit profesional.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar në mënyrë të tillë që lëndët dhe njohuritë e fituara të jenë në vijimësi të njera-tjetrës. Kështu lëndët e formimit bazë zhvillohen në vitin e parë, së bashku me disa lëndë plotësuese. Lëndët karakterizuese, që shërbejnë për formimin inxhinierik, zhvillohen kryesisht në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve. Lëndët e tjera (ndërdisciplinore/integruese, plotësuese dhe përmblylëse) i shërbejnë formimit në një fushë më të gjerë inxhinierike, aftësive komunikuese e prezantuese si dhe aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës. Në këto kushte mund të pohohet se lëndët e këtij programi studimi mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësisimit profesional.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Bsc. Inxhinieri Mekatronike, në strukturën e tij është në përputhje të mirë me VKM Nr 41. Datë 24.01.2018, “Për elementët e programit të studimit”, i ndryshuar me VKM 879, datë 18.12.2019 dhe VKM 185, datë 25.03.2021. Shumica e lëndëve në këtë program studimi janë me 5 kredite dhe shpërndarja e tyre përcaktohet në funksion të natyrës së lëndës dhe shprehet në planin mësimor dhe në programin e lëndës. Mbështetur në planin mësimor 2021-2022, për orët e zhvilluara në auditor [Evidenca 116 - Tabelat e Referencës BCH MEK], raporti teori-praktikë, për lëndët e vitit të parë, orë gjithsej në auditor 791, mesatarisht është 51% teori dhe 49% praktikë; raporti teori-praktikë për lëndët e vitit të dytë, orë gjithsej në auditor 751 është 56% teori dhe 44% praktikë; raporti teori-praktikë për lëndët e vitit të tretë, orë gjithsej në auditor 737 është 46% teori dhe 54% praktikë (me fjalën “praktikë” të përdorur më lart, kuptohen orët e laboratorëve, seminareve, etj., pra jo orë praktike profesionale e mirëfilltë). Kështu, mund të pohohet që raporti teori : praktikë për këtë program</p>

	<p>studimi është në përputhje me profilin e tij, gjë që krijon mundësi profilizimi të studentëve në fushën e inxhinierisë mekatronike.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike”, ka një ngjashmëri me programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike”, që ofrohet nga Universitetet italiane, gjermane, letoneze dhe polake. Me këtë program studimi ka një ngjashmëri mbi 70% programi i studimit, i hapur më pas, në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Inxhinierike në “Albanian University”</p>								
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja e veprimtarive formuese si dhe raporti teori: praktikë bëjnë të mundur formim përgjithësisht të mirë të studentëve dhe deri transferimin e studimeve në institucione të tjera brenda apo jashtë Shqipërisë.</p>								
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse përgjithësisht është e 10 viteve të fundit, por preferohet ajo e 5 viteve të fundit, përveç disa teksteve klasike, që janë më të hershëm, por që nuk ju ka humbur aktualiteti [Evidenca 12 - Sylabuset e programit të studimit]. Sylabuset përmirësohen edhe në bazë të librave të rinj të porositur nga pedagogët [Evidenca 61 – Lista e titujve të librave të rinj në tre vitet e fundit].</p>								
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Objektivi kryesor i programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike” është që studentët të fitojnë njohuri të thelluara në aspektet metodologjike dhe aplikative të makinave të automatizuara, pa pretenduar që me ciklin Bachelor formohen inxhinierë të mirëfilltë. Sidoqoftë ata do të jenë në gjendje që pas studimeve t’i përdorin këto njohuri për të kuptuar dhe zgjidhur problemet e ndryshme të automatizimit të proceseve industriale në praktikë. Vlerësojmë përvojën pozitive të pedagogëve të veçantë të Departamentit të Automatizimit, të cilët kanë ditur që dijet e tyre teorike e praktike t’i transmetojnë me sukses tek studentët e tyre.</p>								
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përgatitja në ciklin e parë Bachelor i lejon studentit të diplomuar vazhdimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e dytë Master Profesional dhe Master i Shkencave], gjë që është vërtetuar gjerësisht në FIE [Evidenca 20 – Gjurmimi për Alumni]. Mund të pohohet që duke patur kombinim të njohurive në fushën e inxhinierisë elektrike, mekanike dhe elektronike, të nevojshme për pajisjet e automatizuara, Inxhinieri Mekatronik është një profesion shumë i kërkuar për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në vendin tonë [Evidenca 13 Studimi i Tregut për Inxhinierinë Mekatronike].</p>								
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Vlerësojmë faktin që për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, UPT, FIE dhe DA marrin në konsideratë propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. UPT, FIE dhe DA, në bashkëpunim me njësitë e karrierës, alumnit dhe Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, organizoi në 2018 Panairin e punës dhe mori pjesë në aktivitetet Work and Study të organizuara nga Bashkia e Tiranës, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë si dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve, me qëllim komunikimet me kompanitë pjesëmarrëse [Evidenca 34 - Lista e marrëveshjeve aktive bashkëpunuese UPT me universitete brenda dhe jashtë vendit]; [Evidenca 21 - Panairi "Work - Study"]. Takimet e DA me kompani si Albaelektrika, Foshner, Fabrika e çimentos në Fushë Krujë, Schneider, Everest, etj. i shërbyen bashkëpunimit në projekte, përmirësimin të programit të studimit si dhe mundësimin të kryerjes së praktikës nga studentët në këto kompani.</p>								
	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përbushet</td> <td>Përbushet</td> <td>Përbushet</td> </tr> <tr> <td></td> <td>pjesërisht</td> <td>kryesisht</td> <td>plotësisht</td> </tr> </table>		Përbushet	Përbushet	Përbushet		pjesërisht	kryesisht	plotësisht
	Përbushet	Përbushet	Përbushet						
	pjesërisht	kryesisht	plotësisht						

Shkalla e përmbushjes së standardit

X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.

Personeli akademik PAE dhe PAK për mësimdhënie në programin e studimit Bsc. plotëson kërkesat ligjore, sepse minimumi i kualifikimit për këtë program studimi është Master i Shkencave (sipas Ligjit për arsimin e lartë), kur në fakt, në 3 vitet e fundit programi i studimit mbulohet nga pedagogët PAE dhe PAK me kualifikimet si më poshtë:

Kualifikimi	2019-2020		2020-2021		2021-2022	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof	4	-	1	-	2	-
Prof As	4	-	4	-	3	-
Dr.PhD	24	-	26	1	29	-
Msc	8	5	11	5	11	7
Totale	40	5	42	6	45	7

Sipas referencës [Evidenca 116 - Tabelat e Referencës BCH MEK), RVB, tabela 12] në tre vitet e fundit pedagogët PAE kanë pasur peshë të ngarkesës mësimore pak a shumë konstante për secilin grup, konkretisht:

- Në vitin akademik 2019 – 2020 pedagogët PAE kanë mbuluar 90.64 % të ngarkesës mesimore, ndërsa pedagogët PAK 9.36 % të saj.
- Në vitin akademik 2020 – 2021 pedagogët PAE kanë mbuluar 87.83 % të ngarkesës mesimore, ndërsa pedagogët PAK 12.17 % të saj.
- Në vitin akademik 2021 – 2022 pedagogët PAE kanë mbuluar 89.36 % të ngarkesës mesimore, ndërsa pedagogët PAK 10.64 % të saj.

Kështu, mesatarisht pedagogët PAE mbulojnë rreth 90 % të ngarkesës mesimore dhe pedagogët PAK rreth 10 % të saj, duke realizuar një standart pozitiv. Gjithashtu, numri i lëndëve semestrare që mbulon një pedagog dhe ngarkesa mesimore vjetore e tij plotësojnë kërkesat e Udhëzimit 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mesimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”.

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Siç u përmend në Kriterin paraardhës të këtij standarti, personeli akademik PAE dhe PAK për mësimdhënie në programin e studimit plotëson dhe tejkalon kërkesat ligjore, sepse të gjithë kanë nivelet e kualifikimit Master i Shkencave, Doktorë, Profesorë të Asociuar dhe Profesorë, ndërsa Ligji për Arsimin e Lartë kërkon nivele të paktën Master i Shkencave. Drejtuesi i DA ka gradën shkencore “Doktor”, pra konform Ligjit për Arsimin e Lartë.

Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit,

Bazuar në CV e Stafit akademik dhe Stafit ndihmës akademik [Evidenca 76 CV e stafit akademik të programit të studimit]; [Evidenca 78 CV e stafit ndihmës akademik], vlerësohet që niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulojnë programin e studimit, janë në përputhje me profilin e këtij programi, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: www.ascal.al

natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.									
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani [Evidenca 34 - Lista e marrëveshjeve aktive bashkëpunuese të UPT me universitete brenda dhe jashtë vendit], DA vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale. Provimi përfundimtar realizohet sipas një procedure të veçantë [Evidenca 54 - DA - Rregullore e provimit dhe Materialet orientuese për provimin e formimit BCH MEK].								
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Personeli ndihmës mësimor dhe shkencor i përshtatshëm angazhohet për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore si dhe të pajisjeve të teknologjisë së informacionit që përdoren në procesin mësimor, sipas natyrës specifike të programit të studimit, në përputhje me detyrat e përgjithshme dhe specifike, të përcaktuara në rregulloret e FIE dhe DA. Konkretisht, DA ka tre personel ndihmës mësimor shkencor, me diplomë Master i Shkencave, në Inxhinieri Elektrike, profili Automatizimi i Industrisë, që merren me përgatitjen e punëve të reja laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratorëve.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Vlerësojmë synimin e UPT për përdorimin e metodave të reja dhe inovative të mësimdhënies, krahas metodave tradicionale të zhvillimit të procesit mësimor të detajuara në “Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies”, e hartuar në nivel institucional dhe e zbatuar nga të gjitha njësitë kryesore dhe bazë në UPT [Evidenca 4 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies]. Kështu, gjatë periudhës së pandemisë, u hartua dhe shërbeu udhëzuesi i zhvillimit të mësimit në distancë [Evidenca 84 - UPT Udhëzues për zhvillimin e mësimit në distancë]. Në FIE studenti pajiset me hyrje në platformën Microsoft Office 365, ku modulet e platformës “Microsoft Office 365” mundësojnë bashkëpunimin dhe

	shkëmbimin e informacionit [Evidenca 111 - Platformë softuerike në përdorim nga/dhe për studentët, office 365]. Nga stafi akademik u hartua udhëzuesi përkatës për t'u ardhur në ndihmë kolegëve për përdorimin e këtij instrumenti [Evidenca 113 - Manual trajnimi dhe përdorimi Microsoft Teams (student, pedagog)].
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>UPT ka ngritur në Rektorat Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC) dhe Njësinë Qendrore të Sigurimit të Cilësisë (NJQSC) si dhe Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në çdo njësi kryesore të UPT [Evidenca 1 - UPT - Statuti]; [Evidenca 75 - UPT Organigrama].</p> <p>Vlerësimet e punës të stafit akademik janë: anketimet periodike studentore, bashkëpunimi me njësitë kryesore dhe bazë për vlerësimin e ecurisë së procesit mësimor-shkencor, studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga njësite bazë, etj.</p> <p>Nga anketimeve semestrale studentore mbi cilësinë në mësimdhënie, të plotësuar nga studentët, bëhen analiza duke evidentuar pikat e forta dhe problematikat specifike në çdo program studimi, që shërbejnë për përmirësimin e cilësisë [Evidenca 33 - Sondazhi me studentet 2019-2020 Sem I, Sem II]. Bazuar në këto analiza, jepen informacione në rektorat dhe dekanat për problematikat të mësimdhënies nga pedagogët të veçantë, të cilëve ju dërgohen këto informacione edhe nëpërmjet skedave personale të papublikuara.</p> <p><u>Rekomandojmë që problemet e cilësisë në mësimdhënie për pedagogët përkatës, të evidentuara nga vlerësimet e studentëve, të analizohen në mënyrë transparente, të paktën brenda departamentit. Gjithashtu, për të siguruar një sistem vlerësimi më domethënës, rekomandojmë që përveç vlerësimit të pedagogëve nga studentët, të shtohet edhe vetëvlerësimi nga vetë pedagogët si dhe vlerësimi i pedagogëve nga eprorët e tyre të drejtpërdrejtë.</u></p> <p>Funksionet kryesore të NJSBC të FIE lidhen me koordinimin e veprimtarisë së sigurimit të cilësisë në njësinë kryesore, për çdo program studimi; me planifikimin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit, me hartimin e raportit vjetor të cilësisë.</p> <p>Vetë Departamenti i Automatikës monitoron dhe vlerëson periodikisht aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik, nëpërmjet kontrolleve në auditor të realizuara nga drejtuesi i DA, kontrolleve nga titullari i lëndës, kontrolleve nga Dekanati i FIE dhe sekretaria mësimore për ecurinë e zhvillimit të procesit mësimor [Evidenca 4 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurikular dhe mësimdhënies, neni 64].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Studentët përfshihen në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe stafit akademik [Evidenca 1 - UPT - Statuti, neni 49, pika c] dhe ata përfaqësohen në organet kolegjiale të UPT-së, me të drejta të barabarta me anëtarët përkatës, në Senatin Akademik të UPT dhe në Këshillin e Etikës [Evidenca 3 - UPT - Kodi i Etikës].</p> <p>Studentët e këtij programi studimi mund të ankimohen lidhur me standardet dhe cilësinë e mësimdhënies; shkeljen e procedurave/rregullores ndaj tyre nga personeli akademik ose ai administrativ; për çdo problem tjetër akademik apo etik; për vlerësimin në format e ndryshme të kontrollit të dijeve si dhe në vlerësimin përfundimtar të lëndës [Evidenca 4 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurikular dhe mësimdhënies, neni 74, 75]; [Evidencë 6 - FIE - Rregullore e Brendshme), neni 52]; (Evidencë 8 - DA - Rregullore e Organizimit dhe funksionimit, neni 53].</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e UPT kujdeset për publikimin e vlerësimeve të studentëve në faqen web të UPT: http://upt.al/cilesia-ne-upt, dhe ju bëhen të njohura njëjse kryesore dhe bazë të UPT.</p> <p>DA realizon analizën e punës mësimore dhe shkencore të departamentit, mbështetur në analizat individuale të pedagogëve dhe kontrollin e drejtuesit të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	njësisë bazë, që shërben si bazë për hartimin e raportit analizues të njësisë kryesore FIE [Evidenca 32 - FIE - Raporti i procesit mësimor]; [Evidenca 62 - FIE - Raporti i analizës së punës kërkimore-shkencore 2020-2021]; [Evidenca 63 - DA - Raporti i analizës së punës kërkimore-shkencore 2020-2021].		
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	<p>Vlerësohet që UPT garanton dhe inkurajon stafin akademik që të marrë pjesë në mekanizmat e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, duke garantuar përfaqësimin, të drejtat dhe detyrimet përkatëse [Evidenca 1 - UPT - Statuti]; [Evidenca 4 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurikular dhe mësimdhënies]; [Evidenca 6 - FIE - Rregullore e Brëndshme]; [Evidenca 8 - DA - Rregullore e Organizimit dhe funksionimit].</p> <p>Gjithashtu, UPT nxit shembuj të praktikave më të mira, inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe seminare me profesorë të ftuar nga universitete të huaja. Edhe FIE është e përfshirë në projekte të ndryshme ndërkombëtare, në zbatim të memorandumit të mirëkuptimit që UPT ka nënshkruar me universitete ndërkombëtare, përmes të cilave motivon stafin të marrë pjesë në programet e mobilitetit si Erasmus+, KA1 ose KA2, për të përmirësuar aftësitë e tyre mësimdhënëse [Evidenca 34 - Lista e marrëveshjeve aktive bashkëpunuese UPT me universitete brenda dhe jashtë vendit]; [Evidenca 36 Lista e mobilitetit të stafit Eramsus+].</p> <p>Nëpërmjet mjeteve të komunikimit si e-mail, platformat e komunikimit dhe mësimin on-line UPT promovon shembujt e praktikave më të mira.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transferimit të dijeve e njohurive në PS Bachelor në Inxhinieri Mekatronike janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat (ushtrime, detyra e kursit dhe projektet), praktikat profesionale etj., të evidentuara në planet mësimore e sylabuset të organizuara konform legjislationit në fuqi dhe rregulloreve të brendshme, të hartuara nga departamentet dhe të miratuara deri nga Senati Akademik i UPT.</p> <p>Ndarja e formave të mësimdhënies sipas 3 viteve në Programin e Studimit është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Leksione 1164 (402+420+342) orë mësimore, • Seminare 784 (329+238+217) orë mësimore, • Laboratorë 184 (60+70+54) orë mësimore, • Detyrë /projekt kursi 39 (0+22.5+ 16.5) orë mësimore, • Praktikë lëndore 80(0+0+80) orë mësimore, • Punë e pavarur e studentëve 2249 (709+749.5+760.5) orë mësimore. <p>[Evidenca 24 - Plani mësimor i programit të studimit BCH MEK]; [Evidenca 116 - Tabelat e Referencës BCH MEK, RVB tabela 10]; [Evidenca 12 - Sylabuset e programit të studimit]; [Evidenca 49 - Suplementi i diplomës BCH MEK].</p> <p>Çdo vit akademik është i organizuar në 60 kredite, në një total prej 180 kredite. Stuentët vlerësohen me kontroll të vazhdueshëm. Bazuar në veçoritë e secilës lëndë, dhe brenda lirisë akademike të pedagogëve të angazhuar në zhvillimin e</p>

	<p>lëndëve, mënyrat e vlerësimit janë një apo disa prej formave si provim i ndërmjetëm, vlerësimi i projektit/detyrës së kursit, vlerësim i punëve të laboratorit, provim përfundimtar.</p> <p>Pesha e secilës mënyrë vlerësimi është e përcaktuar në sylabuset e lëndëve përkatëse [Evidenca 12 - Sylabuset e programit të studimit].</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Vlerësojmë përdorimin e metodave alternative, të parashikuara në programin mësimor dhe në sylabuset e lëndëve, të përdorura për të rritur efektivitetin dhe rendimentin e punës në mësimdhënie e mësimnxënie si dhe plotësimin maksimal të nevojave të studentëve [Evidenca 12 - Sylabuset e programit të studimit].</p> <p>Një mënyrë alternative është edhe mësimdhënia on-line, për të cilën personeli akademik i FIE është i mirë përparim dhe përdor metoda dhe teknika të ndryshme inovative të përshtatura sipas natyrës dhe programit të lëndëve. DA, përgjegjëse për këtë program studimi, ka të punësuar edhe staf akademik ndihmës i cili ndihmon studentët dhe është në funksion të mirëmbajtjes dhe zhvillimit të laboratorëve [Evidenca 113 - Manual trajnimi dhe përdorimi Microsoft Teams (student, pedagog)].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Kemi evidentuar faktin që UPT dhe FIE ofrojnë kushte dhe infrastrukturë të mirë për procesin e mësimdhënies, mbështesin dhe stimulojnë personelin akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike si dhe përditësimet e metodave të mësimdhënies, në përputhje edhe me objektivat dhe misionin e institucionit. FIE disponon salla mësimi të bollshme, të kompletuara me mjete bashkëkohore dhe me mundësi për akses të vazhdueshëm në Internet. Në funksion të programit të studimit janë laboratorët e FIE dhe në njësitë e tjera kryesore të UPT, me të cilat bashkëpunohet për realizimin e programit të studimit Bachelor në "Inzhinieri Mekanike", si ata të Automatikës, Matjeve elektrike dhe elektronike, Transmisioneve elektrike, Makinave elektrike, Elektroteknikës, Informatikës, Kimisë dhe laboratorët specifikë të fakulteteve të tjera. [Evidenca 97 - Prezantimi FIE]; [Evidenca 55 - Broshura informuese, guida për studentët]; [Evidenca 116 - Tabelat e Referencës BCH MEK), RVB Tabela 16. Mjediset e Fakultetit /Njësive Bazë].</p> <p><u>Baza laboratorike e FIE është e një niveli të mirë. Por sidoqoftë ka vend gjithmonë për përmirësim, me heqjen nga përdorimi të pajisjeve laboratorike të vjetra dhe shtimin e pajisjeve laboratorike të reja, duke shmangur burokracitë eventuale nga procedurat e prokurimit publik. Sigurisht që pasurimi i bazës laboratorike kërkon investime të rëndësishme, ndërkohë që financat e FIE mund të jenë të pamjaftueshme. Rrugët kryesore mbeten përfitimet nga projektet e zhvillimit, nga bashkëpunimet me universitetet e huaja dhe nga kontributet financiare të bizneseve private për studime dhe zgjidhje problemesh teknike, të realizuara nga FIE dhe UPT.</u></p> <p>Gjithashtu, FIE kujdeset për pasurimin e bibliotekës. Në çdo vit akademik me anë të një fondi të veçantë çdo pedagog kërkon shtimin e literaturës në funksion të aktiviteteve didaktike dhe shkencore të fushës përkatëse [Evidenca 103 - Praktika për porosi literature dhe blerje literature në FIE]; [Evidenca 61 - Lista e titujve të librave të rinj në tre vitet e fundit].</p> <p>Kualifikimi i stafit akademik mbështetet financiarisht për pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare dhe botime në revista të ndryshme. Veçanërisht në kuadër të projekteve Erasmus+ janë realizuar bashkëpunime me universitetet e ndryshme dhe me mbështetjen e UPT, një pjesë e stafit kanë kryer mobilitete të ndryshme në disa universitete europiane [Evidenca 36 - Lista e mobiliteteve stafit Erasmus +]; [Evidenca 37 - DA - Trajnime personeli Krakow, Italy].</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është</p>	<p>Pohojmë që personeli akademik në programin e studimit është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të</p>



<p>kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. Pedagogët në këtë program studimi kanë eksperiencë akademike dhe kualifikime të shumta [Evidenca 116 - Tabelat e Referencës BCH MEK, RVB Tabela 1 dhe 2. Stafit akademik i FIE, titujt dhe gradat]; [Evidenca 76 - CV e stafit akademik të programit të studimit]. Departamenti i Automatikës i kushton rëndësi të veçantë kualifikimit të stafit akademik, nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte të ndryshme ndërkombëtare dhe aktiviteteve të trajnimit. Titullarët e programeve lëndore kanë kualifikime të larta, me një eksperiencë të gjatë në këto fusha dhe ndër specialistët më të mirë në vend për fushat respektive [Evidenca 12 - Sylabuset e programit të studimit]; [Evidenca 76 - CV e stafit akademik të programit të studimit]. Nga rezultatet e pyetësorëve për studentët rreth 92% e tyre konfirmojnë vlerësimin shumë mirë dhe mirë për kompetencat dhe shpjegimin e njohurive dhe kompetencave të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi [Evidenca 33 - Sondazhi me studentet 2019-2020 Sem I, Sem II].</p>			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Pyetësorët e vlerësimit të studentëve, të organizuara në fund të çdo semestri, janë mjete të rëndësishme për vjeljen e mendimeve dhe sugjerimeve të studentëve. Gjithashtu, stafi mësimdhënës në mënyrë të organizuar japin mendime në lidhje me programet dhe sylabuset e lëndëve, analizojnë format e mësimdhënies dhe propozojnë përmirësimet eventuale.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Ka përpjekje të mira për përdorimin e metodave interaktive dhe diskutimeve të lira gjatë procesit mësimor, si gjatë leksioneve, por veçanërisht gjatë seminareve, detyrave e projekteve, duke rritur interesin e studentëve dhe duke forcuar kuptimin praktik të dijeve teorike.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Puna e pavarur e studentëve stimulohet veçanërisht gjatë përgatitjes dhe mbrojtjes së detyrave të kursit, projekteve dhe praktikave profesionale, gjatë të cilave studentit udhëzohet dhe orjentohe nga pedagogu nëpërmjet komunikimeve të formave të ndryshme, që i shërbejnë ndërtimit të marrëdhënieve të respektit reciprok pedagog – student. Studentit i garantohen të drejtat universale si e drejta e lirisë, arsimit, të shprehjes, e organizimit në organizata, etj. për të promovuar interesin e tyre të përbashkët brenda UPT-së. Gjithashtu, edhe detyrimet e studentit dhe të stafit të UPT-së synojnë në ndërtimin e një marrëdhënie respekti të ndërsjellë, në funksion të objektivave të programit të studimit dhe misionit të UPT-së [Evidenca 3 - UPT - Kodi i Etikës].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: right;">X</p>				

<p>Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Infrastruktura e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike përqëndrohet në ambientet e rikonstruara plotësisht në vitin 2020, të FIE, në mjediset e godinës Korpusi Qendror të UPT. Duke u bazuar në të dhënat e dokumentuara dhe të verifikuara del që hapësirat e nevojshme janë të mjaftueshme, me kushte përgjithësisht të përshtatshme higjeno-sanitare, sigurisë nga zjarri, ndriçimi, ajrosje, ngrohje-ftohje, akustikë, etj, si dhe në përputhje të mirë me standartet dhe normat e kërkuara.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Programi i studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike me rreth 160 studentë në të tre vitet e studimit, organizohet në grupe leksionesh me deri 50-70 studentë dhe grupe seminaresh jo më shumë se 25 studentë.</p> <p>Studentët e FIE kanë akses në të gjitha bibliotekat dhe burimet bibliotekare të UPT. Në veçanti, studentët bazohen kryesisht tek biblioteka e FIE, "Qendra Multimediale" si dhe në Bibliotekën Shkencore Qendrore të UPT]; [Evidenca 99 - FIE - Biblioteka dhe burimet e bibliotekës]; [Evidenca 116 - Tabelat e Referencës BCH MEK), RVB Tabela 16. Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë dhe tabela 17. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj].</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Ambientet e këtij programi studimi i kanë mundësitë për realizimin me cilësi të procesit mësimor, konform legjislacionit dhe standardeve për mësimdhënie në mjedise të përshtatshme. Të gjithë laboratorët kanë pajisjet e nevojshme në funksion të lëndëve specifike të këtij programi studimi [Evidenca 97 - Prezantimi FIE]; [Evidenca 55 - Broshura informuese, guida për studentët].</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Në FIE është ngritur një rrjet kompjuterik, në shërbim të procesit mësimor dhe shkencor, që siguron lidhje fizike (kablore) në çdo sallë mësimore dhe në zyrat e personelit si dhe rrjeti wireless.</p> <p>Laboratorët e FIE kanë internet, pajisjet bazë laboratorike dhe pajisjet ndihmëse si video-projektorë e printer të lidhur në rrjet [Evidenca 97 - Prezantimi FIE]; [Evidenca 55 - Broshura informuese, guida për studentët]; [Evidenca 116 - Tabelat e Referencës BCH MEK, RVB Tabela 16. Mjediset e Godinës Korpusi Qendror dhe tabela 17. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj].</p> <p>Studentët dhe stafi mund të përdorin platformën Office 365 për shkëmbim dhe përpunim informacioni dhe raportesh me/dhe për studentët [Evidenca 111 Platformë softuerike në përdorim nga/dhe për studentët, office 365].</p> <p>Platforma softuerike përdoret nga sekretaria mësimore në funksion të aktivitetit të saj, për gjenerimin e raporteve, të dhënave të përmbledhura dhe të detajuara për të gjithë studentët e regjistruar në programet e studimit të ofruara në FIE [Evidenca 110 - Programi kompjuterik për menaxhimin e sekretarisë mësimore dhe studentët].</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Mendojmë që literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve të UPT, në gjuhë shqipe dhe të huaj, në këtë kuadër edhe për studentët e programit të studimit, është voluminoze dhe në shumë sektorë e viteve të fundit. Literatura mund të gjendet në Bibliotekën Shkencore të UPT, Qendra Multimediale apo në bibliotekën e FIE [Evidenca 99 - FIE - Biblioteka dhe burimet e bibliotekës]; [Evidenca 101 - Biblioteka digjilale]; [Evidenca 92 - Lista e bibliotekës së FIE]; [Evidenca 61 - Lista e titujve të librave të rinj ne tre vitet e fundit]. Ndërsa Biblioteka digjitale ka një bazë të dhënash me mbi 193 mijë libra akademike, mbi 50 mijë revista shkencore, 30 paketa për mësimin e gjuhëve të huaj.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Studentët e FIE mund të përdorin lehtësisht rrjetin e bibliotekave të UPT-së, ku gjenden një numër i madh botimesh unike për çdo fushë teknike. Gjatë periudhës 2017- 2020, Biblioteka Shkencore ka zgjeruar fondin e saj me 2105 njësi bibliotekare dhe 605 tituj të rinj. Studentët kanë hapësira të mjaftueshme, lidhje në internet dhe mundësi hyrje në bibliotekat on-line. Ambientet e bibliotekave janë komode, me hapësirë, dritë dhe shërbim nga personel ndihmës akademik i dedikuar [Evidenca 103 - Praktika për porosi literature dhe blerje literature në FIE]; [Evidenca 61 - Lista e titujve të librave të rinje ne tre vitet e fundit].</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies,</p>	<p>Në dispozicion të studentëve është libraria digjitale [https://ulibrary.rash.al/] dhe [COBISS: [https://pius.al.cobiss.net-opac7/libraries]]. Përmes COBISS,</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>studentët mund të lidhen online edhe me 15 biblioteka universitare, 10 biblioteka publike dhe 3 biblioteka speciale në 11 qytete të Shqipërisë [Evidenca 101 - Biblioteka digjitale]. Në dispozicion të studentëve, është edhe libraria digjitale JSTOR, me të dhënat e nevojshme të aksesit dhe mundësive [http://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete/1544-njoflim-per-mundesine-e-studenteve-dhe-stafite-universitetit-politeknik-te-tiranes-per-te-shfrytezuar-biblioteken-digjitale-jstor].</p>			
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Komentet tona për llojet e laboratorëve në dispozicion janë dhënë në Standartin III.2, Kriteri 3. Për të ndihmuar studentët dhe stafin akademik në punët laboratorike si dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve, në UPT shërben personel ndihmës akademik i kualifikuar [Evidenca 55 - Broshura "Informuesë, guida për studentët"]; [Evidenca 97 - Prezantimi FIE]; [Evidenca 16 - Tabelat e Referencës BCH MEK, RVB Tabela 16. Mjediset e Godinës Korpusi Qendror].</p>			
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Konsiderojmë si një veprimtari pozitive përdorimin nga FIE të platformave online, si platforma Office 365, ku bëjnë pjesë edhe modulet e mësimin on-line (e-learning) si Teams, që lejon komunikimin interaktiv mes përdoruesve të platformës në kushtet e pamundësisë së takimit fizik në klasë, laborator, të studentëve etj. [Evidenca 111 - Platformë softuerike në përdorim nga/dhe për studentët, office 365]. Stafit dhe studentëve ju vihen në dispozicion manuale trajnimi [Evidenca 113 - Manual trajnimi dhe përdorimi Microsoft Teams (student, pedagog)].</p>			
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Personeli akademik i FIE dhe studentët shfrytëzojnë modulet e platformës Office365. Një nga modulet e vlefshme është "Microsoft OneDrive", që lejon ruajtjen dhe shkëmbimin e të dhënave dhe dosjeve apo dokumentave specifike mes shumë përdoruesve. Moduli "OneDrive" lejon edhe mbajtjen e versioneve dhe historikun e dokumenteve dhe kush përdorues i ka edituar. Për shkëmbimin e informacionit shërben edhe faqja zyrtare web e FIE, ku çdo njësi bazë apo administratori mund të japë njoftime të ndryshme për studentët dhe personat e interesuar mbi aktivitetet e FIE [http://www.fie.upt.al]. Gjithashtu në ndihmë të menaxhimit të brendshëm të informacionit vjen dhe platforma e përdorur nga sekretaria mësimore [Evidenca 110 – Programi kompjuterik për menaxhimin e sekretarisë mësimore dhe studentët].</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Konform planit mësimor të programit të studimit, studentët në fund të vitit të tretë i mbyllin studimet me provimin përfundimtar të formimit. Personeli akademik udhëzon dhe mbështet studentët në organizimin, formën dhe përmbajtjen e provimit të formimit sipas programit, planit mësimor dhe një orari konsultimi të publikuar [Evidenca 24 - Plani mësimor i programit të studimit BCH MEK]; [Evidencë.54 - DA - Rregullore e provimit dhe Materialet orientuese për provimin e formimit BCH MEK]; [Evidencë.53 - DA - Komisionet e provimeve dhe Komisionet e praktikës]]. Ky informacion publikohet dhe në faqen e internetit të FIE [http://www.fie.upt.al/bachelor.php]. <u>Kemi konstatuar që faqja e web www.upt.al përmban informacione të sakta e të përditësuara për çdo fakultet e departament të Univeritetit Politeknik të Tiranës. Ndërsa faqja www.fie.upt.al përmban informacione të pasakta e të vjetëruara për Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike (disa shembuj: Në organigramën e Fakultetit Departamenti i Automatikës emërtohet si Departamenti i Automatizimit të Industrisë, Plani mësimor i paraqitur për Bachelor Mekatronikë është i vitit 2005 dhe i menaxhuar nga Departamenti i Elektronikës, në rubrikën "Projekte" nuk është shënuar asgjë). Si e tillë, kjo faqe e ndërtuar në vitin 2020 duhet fshirë fare nga RASH ose duhet përditësuar.</u></p>			
	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="730 1897 943 1957">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="949 1897 1161 1957">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1168 1897 1369 1957">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Vlerësojmë ngritjen në UPT të strukturave kryesore për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të mësimdhënies - Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë [http://upt.al/cilesia-ne-upt] dhe Drejtoria e Kurrikulave [http://upt.al/dega-mesimore], si përgjegjëse për përmbushjen e standarteve të përgatitjes së planeve mësimore, syllabuseve të lëndëve dhe të gjithë dokumentacionit të programeve të studimit. Detyrat dhe funksionet kryesore të Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përcaktohen në Nenin 78 & 79 të Statutit të UPT. Ndërsa funksionet e Drejtorisë së Kurrikulave lidhen me punën koordinuese dhe monitoruese për hartimin, riorganizimin, rishikimin dhe mbylljen e programeve të studimit në të tre ciklet e studimit, punën me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve për çështje dhe problematika lidhur me administrimin e anës mësimore në UPT, punën për verifikime që vijnë nga institucione brenda dhe jashtë vendit, publike dhe/ose private, mbajtjen e databazës për të gjithë ish-studentët e UPT.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	FIE dhe DA janë përgjegjëse për cilësinë e programit të studimit që ofrojnë, gjë që kërkon rishikim të vazhdueshëm të programit mësimor dhe syllabuseve, monitorim dhe përmirësim të mësimdhënies, rekrutim të përshtatshëm të stafit akademik në përputhje me kërkesat e programit të studimit etj. [Evidenca 9 - Rast konkret i procedurës së punësimit në DA]. Vlerësojmë politikën e FIE për kualifikimin e personelit akademik, ku ndikojnë edhe studentët me opinionet e tyre. Raportet e hartuara evidentojnë arritjet në procesin mësimor gjatë një viti akademik, si dhe problematikat që shfaqen [Evidenca 31 – DA - Raporti i procesit mësimor]; [Evidenca 32 - FIE - Raporti i procesit mësimor]. Ndikim në rritjen e cilësisë së mësimdhënies ka edhe përfshirja e stafit dhe studentëve në diskutimet për rregulloret, buxhetin, pyetësorët, përmirësimet e pyetësorëve, sondazhin kombëtar të studentëve etj. [Evidenca 1 - UPT - Statuti].
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Konsiderojmë që FIE synon nxitjen e të mësuarit kreativ, forcimin e bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë për projekte shkencore si dhe zhvillimin e metodave inovative, që përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Në bazë të informacionit të ofruar nga dokumenta të ndryshme del që personeli akademik dhe ai mbështetës për programin e studimit kualifikohet vazhdimisht në mënyrë individuale dhe institucionale (projekte, seminare, trajnime, workshope, konferenca shkencore, etj). Personeli akademik i FIE është i kualifikuar, me tituj akademik e grada shkencore, sipas kërkesave që përcakton Ligji 80/2015 për arsimin e lartë në IAL të RSH dhe i vlerësuar si specialistët ndër më të mirët në vend për fushat përkatëse [Evidenca 76 - CV e stafit akademik të programit të studimit]. Personeli akademik i FIE në fillim të çdo viti akademik paraqet në departament planin e veprimtarisë së tij kërkimore, me paraqitje të rezultateve të kërkimit në konferenca dhe revista kombëtare dhe ndërkombëtare, me kërkesa ndaj buxhetit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	për pajisje të reja, etj, ndërsa në fund të vitit paraqet një raport të realizimit të planit të veprimtarisë së tij kërkimore. Mbi bazën e analizave vjetore, departamentet në FIE vlerësojnë punën e personelit akademik, të grupeve mësimore-kërkimore si dhe të departamentit në tërësi dhe nxjerrin rekomandimet përkatëse për orientimin me të mirë të kërkimit shkencor [Evidenca 63 - DA - Raporti i analizës së punës kërkimore-shkencore 2020-2021]; [Evidenca 62 - FIE - Raportli i analizës së punës kërkimore-shkencore 2020-2021].		
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Zyra në FIE si Njësi e Sigurimit të Cilësisë, Alumni dhe Karrierës është përgjegjëse për identifikimin e nevojave të stafit për kualifikime të ndryshme. Kjo zyrë në bashkëpunim me drejtuesit e departamenteve në FIE ka aktivizuar disa workshope, në lidhje me trajnimin e stafit akademik mbi përdorimin e platformave bashkëkohore të mësimdhënies dhe përdorimin e platformës Office365; trajnim mbi platformat e integruara të mësimiit ku studentët dhe pedagogët mund të marrin dhe të shkëmbejnë të dhëna për sa i përket orës së mësimiit, leksioneve, provimeve dhe detyrave praktike; trajnim mbi përdorimin e bibliotekës digjitale; trajnim mbi rritjen kërkimit shkencor dhe projekteve; etj.		
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Evidentohet fakti që personeli akademik dhe ndihmës akademik është i interesuar dhe i angazhuar, për implementimin sa më të sukseshëm të programit të studimit dhe për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, duke respektuar detyrimet nga rregulloret e UPT, FIE dhe DA. Para fillimit të vitit të ri akademik çdo pedagog bën parashikimin e ngarkesës mësimore. Ndërsa në cdo fund viti akademik ai dorëzon tek drejtuesi i departamentit raportin e tij për plotësimin e programit i departamentit ku pedagogu sugjeron përmirësimet e mundëshme dhe implementimin e metodave të reja në mësimdhënie.		
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Personeli akademik i FIE përpilqet për përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe testimin e metodave të reja, rezultatet e të cilave raportohen në relacionet e përgatitura nga çdo pedagog në përfundim të vitit mësimor dhe pasqyrohen në analizën vjetore të veprimtarisë së DA [Evidenca 31 - DA - Raporti i procesit mësimor]; [Evidenca 32 - FIE - Raporti i procesit mësimor].		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies [Evidenca 4 - UPT] sanksionohen detyrimet e studentëve për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme të procesit mësimor dhe jepen kriteret dhe mënyra e testimit, e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Studentët informohen mbi rregulloren e programit të studimit dhe pedagogët e lëndëve në fillim të çdo lënde apo moduli informojnë studentët për kriteret specifike të vlerësimit të dijeve të lëndëve [Evidenca 9 - DA - Rregullore mësimore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike]. Mënyrat e vlerësimit janë një apo disa prej formave: Provim i ndërmjetëm, Vlerësimi i projektit/detyrës së kursit, Vlerësimi i punëve të laboratorit, Provim përfundimtar. Pësja e secilës mënyrë vlerësimi është e përcaktuar në planin lëndor të lëndëve përkatëse [Evidenca 12 - Syllabuset e programit të studimit].

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studentët informohen rregullisht edhe mbi planet mësimore dhe kurrikulën e programit të studimit, ku një rol të rëndësishëm luajnë edhe koordinatori i programit të studimit dhe anëtarët e Këshillit të Programit të Studimit [Evidenca 9 - DA - Rregullore mësimore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike). Gjithashtu, informacion të hollësishëm studentët gjejnë edhe në syllabuset e lëndëve [Evidenca 12- Syllabuset e programit te studimit]. I gjithë informacioni mbi përmbajtjen e programit të studimit gjendet në faqen zyrtare të FIE [http://www.fie.upt.al/bachelor.php].</p>		
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nëpërmjet detyrave të kursit, projekteve të kursit, relacioneve të punëve laboratorike dhe testimeve (kolokiumeve) gjatë vitit. Provimet mund të bëhen me shkrim, ose me gojë sipas programit mësimor. Para provimit pedagogu informon studentët në se kanë të drejtë të futen në provim, sa pikë kanë fituar gjatë kontrolleve gjatë vitit dhe me cilët kriteret do të vlerësohen përfundimisht. Rregullat e provimeve, pikëvarazhi për testimet gjatë vitit, për detyrat, projektet, aktivizimin në seminare dhe forma të tjera vlerësimi janë të përcaktuara në syllabuset e lëndëve, që njihen nga studentët.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Evidentohet fakti që raportet ndërmjet testimit e vlerësimit të vazhduar dhe vlerësimit përfundimtar përcaktohen nga pedagogët në programin e lëndës dhe miratohen nga Drejtuesi i departamentit. Format kryesore të kontrollit të vazhduar janë detyrat e kursit, projektet e kurat, kolokiumet, aktivizimi në seminare dhe relacionet e punëve laboratorike dhe ato shërbejnë, ashtu si dhe provimi për vlerësimin përfundimtar me notë [Evidenca 12 - Syllabuset e programit te studimit]; [Evidenca 116 - Tabelat e Referencës BCH MEK), RVB Tabela 15 Format e kontrollit të njohurive].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>FIE ofron për stafin dhe studentët paketën e plotë të moduleve të Office 365 [Evidenca 111 - Platformë softuerike në përdorim nga dhe për studentët, office 365]. Në këtë platformë stafi ka zbatuar sistemin e kontrollit në modulën "Forms", i cili lejon jo vetëm marrjen dhe përpunimin e të dhënave në formën e pyetësorëve, por edhe për menaxhimin e kontrolleve të para dhe të dyta të diplomave për studentët e këtij fakulteti. Personeli akademik i këtij programi studimi ka përdorur formën "assignment" për detyrat dhe projektet e ndryshme të studentëve, duke eliminuar format e ndryshme të abuzimit dhe duke rritur transparencën. Sistemet elektronike të testimit dhe vlerësimit janë mirëpritur nga studentët.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Sipas Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, komisionet e provimeve përbëhen nga pedagogu i lëndës dhe të paktën 1 pedagog tjetër i aktivizuar në mësimdhënien e lëndës ose në një lëndë të përafërt. Në se për raste madhore ata pedagogë nuk mund të marrin pjesë, drejtuesi i departamentit propozon pedagogët zëvendësues. Komisionet e provimit të lëndës miratohen nga Dekani i FIE. Tezat e provimit hartohen nga lektori i lëndës, së bashku me asistentin e tij, dhe miratohen e nënshkruhen nga drejtuesi i departamentit. Një kopje e tezës së provimit depozitohet në departament.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Në format e kontrollit të njohurive dhe dijeve me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, i deklaruar në fletën e provimit dhe i kthyer në notë. Gjatë kontrollit me shkrim, provimet bëhen të sekretuara, ku personi ndihmës akademik ndihmon për sekretimin e tij [Evidenca 70 Teza e provimit]; [Evidenca 71 Teza e provimit te formimit me sekretim].</p> <p>DA merr masa që procesi i testimit të kryhet konform rregullores, duke siguruar ambientet dhe personelin monitorues. Pedagogët e lëndës mbajnë përgjegjësi për vlerësimin e studentëve dhe vendosjen e rezultateve në afatin e përcaktuar.</p> <p>Provimet me shkrim bëhen të sekretuara. Sistemi i pikëve dhe konvertimi përkatës me notë, që përdoret në provimin me shkrim, i bëhen të njohur studentit para fillimit të provimit [Evidenca 4 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurikular dhe mësimdhënies, neni 34].</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Gjatë procesit të vlerësimit të vazhduar (detyra, projekte, laboratore, etj), gjatë korrigjimit të provimit me shkrim apo gjatë zhvillimit të provimit me gojë, pedagogu i lëndës bën komente të ndryshme për të ndihmuar studentin në përmirësimin e njohurive si dhe për sqarimin e paqartësive eventuale. Komisioni i Provimit bën me dije studentin për rezultatin e vlerësimit para plotësimit të dokumentacionit përkatës, studenti mund të kërkojë sqarime ose të paraqesë pretendime dhe Komisioni i Provimit detyrohet t'a sqarojë. Këto veprime janë pjesë e procesit të transparencës në mënyrën e vlerësimit dhe janë të bazuara në rregulloren e brendshme të FIE [Evidenca 6 - FIE - Rregullore e Brëndshme] dhe rregulloren e programit të studimit [Evidenca 9 - DA - Rregullore mësimore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike].</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Studentët që në fillim të procesit mësimor informohen për veprime të ndaluara si kopjimi e plagjiatura. Studentët duhet të mos kopjojnë, të mos mashtrjnë gjatë procesit mësimor, si dhe të mos shmangen nga shlyerja e detyrimeve mësimore [Evidenca 3 - UPT - Kodi i Etikës, neni 6]; [Evidenca 12 - Syllabuset e programit të studimit]. Studenti që kryen veprime të ndaluara, përjashtohet nga provimi, sipas një procedure të caktuar, ku Komisioni i provimit vë në dijeni drejtuesin e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, për të proceduar më tej në përputhje me Kodin e Etikës së UPT.</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësojmë faktin që stafi akademik i angazhuar në programet e studimit në FIE ka aftësi të larta profesionale në mësimdhënie dhe udhëhiqet në parimet e vlerësimit të dijeve bazuar në vlerat dhe meritat. Në të gjitha format e organizimit të provimit, studenti merr vlerësimin përkatës nga komisioni jo më vonë se pesë ditë pune nga data e dhënies së provimit [Evidenca 4 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurikular dhe mësimdhënies), neni 34].</p> <p>Në rastet e provimeve të zhvilluara online studenti merr përgjigje për çdo pyetje dhe komentet e pedagogut për vlerësimin e secilës pyetje, në sistemin Teams [Evidenca 83 - FIE - Rregullore për zhvillimin e provimeve online 2020-2021].</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Çdo student ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e marrë në provim. Komisioni i vlerësimit është i detyruar të sqarojë kur kërkohet nga studentit mbi vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur [Evidenca 4 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurikular dhe mësimdhënies), neni 34].</p> <p>Në rast mos-dakortësie studentit i lind e drejta e ankimit. Ankesa duhet të depozitohet me shkrim në sekretarinë e Dekanit, i cili shqyrton kërkesën dhe mund të thërrasë për sqarime të mëtejshme drejtuesin e departamentit, komisionin e provimit dhe studentin sipas procedurave të përcaktuara [Evidenca 4 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurikular dhe mësimdhënies, neni 35] dhe në rregulloren e programit të studimit. Procedura e ankimit dokumentohet në arshivë [Evidenca 72 Procedure ankesë studentit].</p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i</p>	<p>Siç u sqarua në kriterin paraardhës ankesa depozitohet në sekretarinë e Dekanit. Dekani mund të thërrasë për sqarime drejtuesin e njësisë bazë përkatëse,</p>

vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	komisionin e provimit dhe vetë studentin dhe, pas gjykimit të çështjes, merr vendimin përkatës të formës së prerë. Në rast se ankesa është e drejtë, dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit, për të cilin studenti është ankuar dhe vendos që studenti të rivlerësohet ose të rijapë provimin, me të njëjtin komision, të plotësuar edhe me anëtarë të tjerë.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike në thelbin e tij ka si objektiv kryesor t'u japë studentëve njohuri shkencore themelore, zhvillimin e kompetencave dhe aftësive profesionale në projektimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen në fushën e Inxhinierisë Mekatronike, në mënyrë që t'u ofrohen studentëve perspektiva më të mira për përshtatjen dhe integrimin në tregun e punës dhe mundësinë që të vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklin e dytë Master [Evidenca 9 - DA - Rregullore mësimore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike, neni 4], [Evidenca 24 - Plani mësimor i programit të studimit BCH MEK]. Formimi i të diplomuarve ju mundëson atyre drejtimin e sistemeve të ndërmarrjeve apo kompanive që punojnë në fushën e mekatronikës. Gjithashtu, ata mund të merren me aktivitete të promovimit, shitjes, asistencës teknike si dhe të profesionistit të lirë.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i Studimit siguron zhvillimin e aftësive bazike në fushat e teknologjisë së informacionit, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, sepse në kurrikulën e tij janë përfshirë lëndë të tilla si Elementë të informatikës, Teknikat dhe gjuhët e programimit, Gjuhë e huaj, Ekonomi dhe administrim ndërmarrje, Praktikë profesionale, etj [Evidenca 116 - Tabelat e Referencës BCH MEK, RVB tabela 10]; [Evidenca 24 - Plani mësimor i programit të studimit BCH MEK]. Planet mësimore të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike dhe programet lëndore [Evidenca 12 - Syllabuset e programit të studimit] garantojnë, përveç zhvillimit të aftësive e kompetencave në fushën e mekatronikës, edhe aftësimin në fushat e menaxhimit, ekonomike, të komunikimit dhe bashkëveprimit inxhinierik.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Konstatohet që Programi i studimit dhe syllabuset [Evidenca 12 - Syllabuset e programit të studimit], përmbajnë lëndët bazë për zhvillimin e mëtejshëm shkencor, lëndët e shumëllojshme karakterizuese për një formim inxhinierik me kompetenca të mira teorike-praktike. Në përfundim të vitit akademik pedagogët titullarë të lëndëve analizojnë kompetencat dhe aftësitë e përfituara nga studenti, të cilat paraqiten në analizën individuale vjetore, ku pedagogu paraqet rezultatet e punës për çdo lëndë, objektivat, realizimin, rezultatet e arritura, pengesat dhe mundësitë për përmirësim [Evidenca 31 - DA - Raporti i procesit mësimor]. Bazuar në analizën individuale të pedagogut, Departamenti i Automatikës analizon treguesit cilësorë të kompetencave të fituara nga studentët, analizë që është bazë për përgatitjen e analizës vjetore mësimore të njësive kryesore FIE [Evidenca 32 - FIE - Raporti i procesit mësimor].
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik	Është e rëndësishme që pedagogu, në përfundim të çdo lëndë bën një përmbledhje të temave më të rëndësishme ku studentët duhet të fokusohen për provimin

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	përfundimtar dhe zbatimin e dijeve në praktikë, si dhe qartëson strukturën, natyrën dhe peshën e pyetjeve që do të ketë provimi përfundimtar.
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik në FIE realizon orë të hapura me personel akademik të UPT dhe jashtë UPT, për zhvillimet e reja, seminare ku ftohen inxhinierë nga ndërmarrje shtetërore dhe nga disa kompani të njohura [Evidenca 39 - Njoftime në faqen e UPT për trajnime dhe mësimdhënie në universitete të tjera]; [Evidenca 34 - Lista e marrëveshjeve aktive bashkëpunuese UPT me universitete brenda dhe jashtë vendit]. Gjithashtu, krahas zhvillimit të mësimin të parashikuar në auditor, personeli akademik zhvillon orë të hapura për studentët, në lidhje me zhvillimet e reja teknologjike në fushën e Inxhinierisë Mekatronike.
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Format kryesore të punës mësimore janë format e mësimin teorik e praktik (leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, konsultimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit, etj) dhe format e kontrollit të dijeve (bashkëbisedimet, mbrojtje e punëve laboratorike, mbrojtje e detyrave dhe/ose projekteve të kursit, mbrojtje e praktikave profesionale, provime të ndërmjetme, provimet e lëndës, provimet e formimit, etj). Laboratorët në FIE janë të pajisura me mjetet laboratorike bazë, dhe pajisjet specifike profesionale, por edhe në përmirësim të vazhdueshëm bazuar në nevojat dhe kërkesat e njësisë bazë përkatëse [Evidenca 97 - Prezantimi FIE]; [Evidenca 55 - Broshura informuese, guida për studentët]. Ata i mundësojnë studentit një përvetësim më të mirë të njohurive teorike të analizuara gjatë aktivitetëve didaktike në auditor.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Vlerësojmë faktin që personeli akademik mbështet punën në grup, nxit debatin midis studentëve për zgjidhjen e problemeve të ndryshme, kërkon zgjidhjen e detyrave në grup. Detyrat e kursit (apo projektet e kursit) ju mundësojnë studentëve që të analizojnë raste reale me të dhëna të caktuara, nëpërmjet bashkëpunimit e punës në grup, të zhvillojnë projekte të vogla, të analizojnë rezultatet dhe të nxjerrin përfundime. Personeli akademik i programit të studimit mbështet punën në grup duke marrë pjesë në organizimin e seminareve dhe workshope-ve për të rritur kompetencat e studentëve në fusha dhe teknologji të reja në fushën e studimit [Evidenca 39 - Njoftime në faqen e UPT për trajnime dhe mësimdhënie në universitete të tjera]; [Evidenca 21 - Panairi "Work - Study"]; [Evidenca 20 -Panairi 2018 dhe aktivitete të tjera]. Në këtë kuadër edhe studentët aktivizohen në projekte dhe aktivitete shkencore [Evidenca 116 - Tabelat e Referencës BCH MEK].
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Eshtë evidentuar që personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve nëpërmjet përfshirjes së tyre në projekte kërkimore dhe studimore, në të cilat stafi jep ekspertizën e tij. Personeli akademik komunikon efektivisht me studentët dhe procesi monitorohet, ku një nga mënyrat është dhe pyetësori me studentët në fund të lëndës. Stafi zhvillon orë të hapura, ku pedagogë të ndryshëm shpesh kanë fuar profesorë të huaj dhe inxhinierë të njohur të fushës së studimit [Evidenca 39 - Njoftime në faqen e UPT për trajnime dhe mësimdhënie në universitete të tjera]; [Evidenca 21 - Panairi "Work - Study"]; [Evidenca 20 -Panairi 2018 dhe aktivitete të tjera]. Gjithashtu aktivizimi i studentëve në projekte dhe punë shkencore është një tregues pozitiv për këtë program studimi [Evidenca 116 - Tabelat e Referencës BCH MEK].
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e	FIE ka mbështetur dhe organizuar konferenca shkencore të studentëve, ku studentët janë paraqitur edhe me referime të vlefshme, si rezultat i bashkëpunimit të tyre me personelin akademik [Evidenca 97 - Prezantimi FIE]; [Evidenca 55 - Broshura informuese, guida për studentët], por sigurisht pa pretenduar për punë

shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	të mirëfillta e të pavarura kërkimore shkencore. FIE mbështet studentët financiarisht nëpërmjet orientimit drejt aplikimeve të tyre në programet GRADUA dhe ERASMUS+, mobiliteteve dhe trajnimeve me disa universitete si në Krakow, etj [Evidenca 36 - Lista e mobiliteteve të stafit Erasmus +], [Evidenca 22 - Sondazhe mbi tregun e punës dhe kompanitë - Projekti GRADUA]; [Evidenca 35 - Lista e projekteve Europiane].						
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Konstatohet që FIE kombinon format e mësimdhënies me institucione të tjera me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, ku përfshihen edhe mobilitetet e studentëve. Mobiliteti i studentëve dhe i stafit është realizuar kryesisht nëpërmjet projekteve të FIE dhe UPT pranë universiteteve homologe jashtë vendit, në veçanti nëpërmjet projektit ERASMUS+. Gjithashtu personeli akademik ndihmon studentët në realizimin e praktikës profesionale, duke sugjeruar kompanitë pritëse dhe duke ndihmuar ata në hartimin e raportit të praktikës [Evidenca 18 - Lista e Institucioneve bashkëpunuese për praktikën profesionale].						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Rregullorja e UPT për zhvillimin kurrikular dhe mësimdhënien përcakton një procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve [Evidenca 4 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies, nenet 57, 58 dhe 59]. Të gjithë studentët e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike", që kanë shlyer të gjitha kreditet e lëndëve të programit të studimit, kanë të drejtat përkatëse në provimin përfundimtar të formimit [Evidenca 9 - DA - Rregullore mësimore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike, neni 19]; [Evidenca 54 - DA - Rregullore e provimit dhe Materialet orientuese për provimin e formimit BCH MEK]. Data e provimit përfundimtar caktohet 2 javë pas sezonit të provimeve dhe studentëve iu bëhet e ditur data dhe informacioni i nevojshëm. Ata mund të informohen edhe nga faqja e internetit të FIE http://www.fie.upt.al/bachelor.php .
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Përgjegjësitë e strukturave përgjegjëse për procesin e diplomimit lidhen me Dekanatin e FIE për të kontrolluar zbatimin korrekt të procesit dhe me drejtuesit e departamenteve për menaxhimin e sezoneve të provimeve të zakonshme dhe provimit përfundimtar të formimit. Për studentët është përgatitur rregullorja e provimit përfundimtar të formimit si dhe materiali ndihmës [Evidenca 54 - DA - Rregullore e provimit dhe Materialet orientuese për provimin e formimit BCH MEK].
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Departamenti i Automatikës ngre komisione të posaçme për administrimin e provimit final, për testimin e njohurive të dhëna gjatë tri viteve akademike. Teza e provimit përmban pyetje me alternativa dhe me zhvillim [Evidenca 54 - DA - Rregullore e provimit dhe Materialet orientuese për provimin e formimit BCH MEK]. Të gjithë studentët e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike", që kanë shlyer të gjitha kreditet e parashikuara, kanë të drejtë të hyjnë në provimin përfundimtar të formimit [Evidenca 9 - DA - Rregullore

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>mësimore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike]; [Evidenca 54 - DA - Rregullore e provimit dhe Materialet orientuese për provimin e formimit BCH MEK].</p> <p>Në FIE ngrihen komisione të posaçme për realizimin dhe administrimin e provimit të formimit, të tilla si Komisioni i hartimit të provimit të formimit, Komisioni i korigjimit të provimit të formimit; Komisioni i ndjekjes të provimit të formimit; Komisioni i vlerësimit të provimit të formimit [Evidenca 53 - DA - Komisionet e provimeve dhe Komisionet e praktikës].</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Personeli akademik përgatit materiale orjentuese për provimin përfundimtar [Evidenca 54 - DA - Rregullore e provimit dhe Materialet orientuese për provimin e formimit BCH MEK]; [http://www.fie.upt.ai/Orari i konsultimeve.phpl.]. Departamenti iu bën të ditur studentëve në fillim të vitit akademik, sezonet përkatëse të provimeve dhe provimit përfundimtar të formimit [Evidenca 60 - UPT - Struktura mësimore 2021 -2022].</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Nëpërmjet ndihmës që personeli akademik dhe ndihmës akademik ju jep studentëve realizohen testime dhe matje për kryerjen e analizave dhe testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit [Evidenca 12 - Syllabuset e programit të studimit]. Në këtë drejtim, funksionojnë laboratorët e FIE [Evidenca 97 - Prezantimi FIE]; [Evidenca 55 - Broshura informuese, guida për studentët]. Studentët në praktikë mësimore pranë kompanive mund të realizojnë matje dhe vlerësime të ndryshme [Evidenca 18 – Lista e Institucioneve bashkëpunuese për praktikën profesionale]; [Evidenca 40 - FIE - Marrëveshjet e bashkëpunimit me kompanitë private dhe shtetërore].</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në Programin e Studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike nuk ka mbrojtje diplome, por vetëm provim përfundimtar mbas studimeve 3-vjeçare. <u>Rekomandojmë, që pavarësisht numrit të kufizuar të personelit akademik efektiv ndaj numrit të lartë të studentëve të programit Bachelor Inxhinieri Mekatronike, të studjohet mundësia që në të ardhmen, duke përdorur një kriter përzgjedhës, si përshembull nota mesatare, një grup i vogël studentësh të realizojnë mbrojtjen e Diplomës me tema të caktuara.</u></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Komisioni i vlerësimit të provimit përfundimtar të formimit vlerëson me notë tezat e sekretuara të provimit përfundimtar të formimit, si mesatarizim i vlerësimit të çdo anëtarit të komisionit. Rezultatet e provimit iu komunikohen studentëve një ditë pas provimit nga komisioni i vlerësimit. Njëkohësisht, procesverbalet dërgohen në sekretari për tu hedhur në sistemin e sekretarisë dhe arkivohen. Informacionin për notën studentët mund ta marrin dhe në sekretari [Evidenca 73 Model korigjimi të provimit përfundimtar].</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike” dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe Senati Akademik i UPT [Evidenca 50 - Modeli i diplomës BCH MEK (Urdhëri i aprovimit)]. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë, duke përshkruar natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës përcaktohen në statutin e UPT-së, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve [Evidenca 49 - Suplementi i diplomës BCH MEK]; [Evidenca 4 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurikular dhe mësimdhënies, Neni 61].</p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në</p>	<p>Sipas kërkesave të paraqitura në sekretarinë mësimore dhe kundrejt pagesës përkatëse, studentët e interesuar mund të pajisen me një kopje të plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar. Të interesuarit aplikojnë pranë Dekanit të FIE,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	që ja përcjell kërkesat departamentit përkatës dhe në një kohë të shkurtër studentët pajiset me programin e plotë në formë zyrtare [Evidenca 65 - Rregullore e Sekretarisë mësimore].		
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Konstatohet që ka procedura të veçanta në lidhje me arshivimin, sipas kërkesave ligjore, e gjithë dokumenteve të studentëve gjatë ciklit të studimeve të tyre. Ka raste që studentët kërkojnë dokumente specifike për arsye të ndryshme dhe, sipas kërkesave, atyre ju lëshohen lloje të ndryshme të dokumenteve të regjistruara, të përdorshme nga institucione të tjera [Evidenca 65 - Rregullore e Sekretarisë mësimore].		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X



IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtar në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	Në UPT struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve është Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Juridike [Evidenca 75 UPT Organigrama], për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në çdo fakultet http://upt.al/burimet-njerezore . Në FIE, Specialisti i personelit dhe arkivit, që është njëkohësisht Asistentja e Dekanit, përgatit një informacion të detajuar për evidencat e punonjësve. [Evidenca 6 FIE - Rregullore e Brendshme, neni 37]. Në dosjen e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ ruhen dhe përditësohen të gjitha të dhënat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi [Evidenca 91 - Dokumentacioni i Dosjes Personale të Stafit në FIE]. GVJ, nga shikimi i kontratës individuale të punës, konstatoi se jepet edhe përshkrimi i punës për çdo punonjës, ndërsa përgjegjësitë për çdo funksion janë të përcaktuara në rregulloren e FIE dhe departamenteve [Evidenca 6 FIE - Rregullore e Brendshme, Kreu IV Personeli dhe punësimi në FIE, neni 30 Punësimi i personelit akademik], si dhe në Statutin dhe Rregulloren e UPT [Evidenca 1 Statuti i UPT, Kreu V Punësimi i personelit akademik dhe ndihmës-akademik në UPT neni 42 e 43]. Stafi akademik i përditëson vetë dosjet personale në lidhje me karrierën apo titujt e fituar në kohë. Konstatohet se për PS Bsc. në Inxhinieri Mekatronike, pjesë e përpunimit të të dhënave është edhe parashikimi i ngarkesës mësimore për stafin efektiv dhe me kontratë, që do të angazhohet në këtë program. Në përfundim të vitit akademik, administrohen edhe evidencat e detajuara për plotësimin e orëve mësimore

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	[Evidenca 114 Model evidence për raportimin e zhvillimit mësimor]; Evidenca 85 Parashikimi i ndarjes së ngarkesës].
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	<p>UPT në përputhje me statutin ka hartuar procedura të veçanta për rekrutimin e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme.</p> <p>Sipas dokumentacionit të paraqitur GVJ [Evidenca 67 Procedura për punësimin e personelit me kohë të plotë]; [Evidenca 68 Procedura për punësimin e personelit me kohë të pjesshme] konstatohet se, procedura fillon me përcaktimin e nevojave për staf akademik prej vetë njësisë bazë.</p> <p>Departamenti Automatikës në fillim të çdo viti akademik përpilon një dokument të planit të ngarkesave mësimore për stafin aktual dhe miraton në mbledhjen e tij nevojat konkrete për staf të ri për mbulimin e lëndëve në PS Bsc. Inxhinieri Mekatronike.</p> <p>Drejtuesi i njësisë bazë ia përcjell drejtuesit të njësisë kryesore numrin e vendeve të lira dhe kriteret për PAE e PAK, në zbatim të rregullores përkatëse. Këto gjithashtu bëhen publike në faqet web të FIE dhe UPT si dhe afishohen https://upt.al/images/stories/punesim/Shpallje_FIE_Dep%20Automatikes.pdf</p> <p>Pas një periudhë kohore 2 javore, kërkesat që kanë ardhur në përmbushje të thirrjes shqyrtohen nga një komision. Komisioni <i>Ad-hoc</i> verifikon dokumentacionin e paraqitur, harton listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret dhe kryen procedurën e vlerësimit me pikë për secilin nga kandidatët që përmban lista, sipas skemës së vlerësimit të miratuar. Më pas bën renditjen e kandidatëve dhe vendimin ja përcjell Dekanit të FIE, Dekani ja përcjell listën me emrat fitues për miratim tek Rektori, së bashku me kontratat përkatëse për firmë. Rektori me anë të DBNJ bën njoftimin e fituesit/ve në faqen zyrtare të UPT, në rubrikën vende pune, www.upt.al</p> <p>Kandidatët jo fitues kanë 3-ditë kalendarike kohë për t'u ankumuar. Në rast ankesash, Komisioni <i>Ad-hoc</i> ka të drejtë t'i shqyrtojë, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, dhe institucioni ju përgjigjet atyre me shkrim, brenda 10-ditëve kalendarike. Rektori, brenda 5 pesë ditëve kalendarike, nga përfundimi i afatit të ankimit, nënshkruan kontratën/at dhe bën emërimin/et e PAE [Evidenca 69 Rast konkret i procedurës së punësimit në DA].</p> <p>Për PAK në Komisionin <i>Ad-hoc</i> bëjnë pjesë drejtuesi i departamentit, drejtuesi i grupit kërkimor-shkencor dhe titullari i lëndës përkatëse.</p> <p>Këto procedura dhe dokumenta u konstatuan të rregullta nga GVJ në dosjet e personelit në Zyrën e Burimeve Njerëzore të UPT.</p>
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion të GVJ, UPT e bën rekrutimin e stafit akademik referuar procedurave e kriterëve të përgjithshme që përfshijnë ato të diktuarat prej ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH", [nenet 57, 59, 64], Statutit dhe Rregullores së UPT të cilat janë pjesë e akteve rregullatore, [Evidenca 1 Statuti i UPT neni 42, pika 3] dhe kriterëve specifike [Evidenca 67 Procedura për punësimin e personelit me kohë të plotë]; [Evidenca 68 Procedura për punësimin e personelit me kohë të pjesshme] të përcaktuara nga njësitë bazë dhe kryesore për plotësimin e nevojave në vitin aktual, dhe i bën ato publike.</p> <p>Punësimi i personelit akademik dhe ndihmës-akademik kryhet me konkurrim, përmes thirrjeve të hapura. Shpallja e thirrjeve bëhet nga DBNJ në Buletinin e Njoftimeve Publike, në faqen zyrtare dhe publikohen edhe në rrjete sociale.</p> <p>Nga vëzhgimi i bërë në faqen zyrtare web të FIE https://upt.al/vende-pune GVJ konstaton se janë lehtësisht të aksesueshme.</p>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë	<p>UPT ndjek një politikë të qartë dhe transparente punësimi në përputhje me rritjen e numrit të studentëve. Procedurat e rekrutimit dhe të vlerësimit të stafit akademik bëhen mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura paraprakisht.</p>

përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Kriteret specifike propozohen prej njësisë bazë, në referencë të specifikave e kërkesave të lëndës/grup lëndëve për mbulimin e të cilave kërkohet ky staf. Konstatohet se, Departamenti Automatikës bën përpjekje për të rekrutuar personel akademik me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje të plotë me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike [Evidenca 69 Rast konkret i procedurës së punësimit në DA].		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësisë të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>UPT ka krijuar mjedise dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p> <p>Nga vërtetimi në vend, GVJ vërejt se godina e FIE, ku zhvillohet PS Bsc. Inxhinieri Mekatronike, është plotësisht e rikonstruktuar, duke shtuar dhe riorganizuar auditorë dhe zyra për personelin akademik, si dhe përmirësim të ndjeshëm si në ambientet e punës edhe të mësimdhënies. Aktualisht ambientet janë të pajisura me sisteme ngrohje/ftohje, me izolim optimal termik dhe akustik, me infrastrukturë të kënaqshme informatike, me ndriçim me plafone led, etj, me auditorë të pajisur me tabela të bardha dhe lapsa lapustile. Si pjesë e riorganizimit të fundit, godina historike është pajisur me dalje dhe shkallë emergjence, me sistem monitorimi me kamera, me sistem për mbrojtjen kundra zjarrit, me tabela të emëruara për çdo klasë, sallë apo zyrë. FIE ka edhe disa salla mësimi në katin e parë të godinës së Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit [Evidenca 74 Labororet e FIE, foto].</p> <p>Referuar Planit Strategjik [Evidenca 2 UPT - Plani strategjik 2019-2024, Kreu III 1.1] UPT dhe FIE [Evidenca 5 FIE – Strategjia 2018-2023] synojnë një mjedis me kushte të përshtatshme dhe bashkëkohore, tërheqës dhe krijues për personelin akademik, maksimizimin e arritjeve të tyre dhe garantojnë mundësi të barabarta për zhvillimin e karrierës [Evidenca 89 Informacion në lidhje me infrastrukturën në funksion të programit të studimit].</p>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<p>Sipas dokumentacionit të paraqitur, GVJ konstaton se, angazhimi i UPT në mbështetje të personelit që mbulon dhe administron PS Bsc. në Inxhinieri Mekatronike është konkret, veçanërisht në realizimin e mobiliteteve të ndryshme për periudha të shkurtra kohore, në kuadër të programeve Erasmus+ apo mundësisë të tjera, siç janë projektet e ndryshme [Evidenca 36 Lista e mobiliteteve të stafit Erasmus+].</p> <p>Në funksion të kësaj, UPT ka hartuar dhe është duke zbatuar strategjinë e ndërkombëtarizimit, ku një pikë kyçe është ndërkombëtarizimi si qëllim i kualifikimit të vazhdueshëm të personelit akademik [Evidenca 2 Plani Strategjik i UPT 2019-2024, Kreu V. 1].</p> <p>Për pjesëmarrje në projekte kërkimore, zhvillimore, për realizimin e punës shkencore (pjesëmarrje në Konferenca të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, me botime në revista ndërkombëtare) ofrohet mbështetje financiare për secilin prej anëtarëve të stafit akademik sipas procedurave të përcaktuara qartë për këtë qëllim të FIE [Evidenca 56 FIE Praktikë mbështetje financiare për botime shkencore në DA].</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtjeshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>UPT përmes Planit Strategjik [Evidenca 2 Plani Strategjik i UPT 2019-2024, Kreu V.3], Planit Strategjik të FIE [Evidenca 5 FIE – Strategjia 2018-2023] synon të jetë një institucion aktiv në implementimin e dijes, gjenerimin e ideve krijuese dhe nxitjen e shkencës në Shqipëri, nëpërmjet një mësimdhënie bashkëkohore sipas të gjitha standarteve ndërkombëtare, europiane ESCO, deklaratës së Bolonjës dhe Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Për këtë, UPT angazhohet në zbatimin e politikave integruese të personelit të vet akademik, nëpërmjet formave të ndryshme të asistencës, mbështetjes për sigurimin e bazës materiale didaktike të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe kërkimit, ofrimin e mundësive për kualifikim dhe zhvillim profesional, etj Departamentet, si pjesë e FIE dhe UPT-së synojnë të jenë pjesë aktive e strategjisë së UPT në përmirësimin e metodave inovative të mësimdhënies. [Evidenca 8 DA - Rregullore e Organizimit dhe funksionimit].</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstaton se stafi akademik i FIE dëshmojnë për një angazhim optimal në përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Mekatronike. Këtë e dëshmon qartë shkalla e kualifikimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme për këtë program studimi [Evidenca 116 Tabelat e References BCH MEK], RVB tabela 12 Personeli akademik].</p> <p>Ngarkesa e personelit akademik, përcaktohet në respekt të plotë të lirisë akademike dhe në përputhje me ekspertizën përkatëse [Evidenca 1 UPT – Statuti neni 34, 35]. Në fillim të çdo viti akademik, çdo anëtar i personelit akademik kryen parashikimin e ngarkesës mësimore, e cila aprovohet nga drejtuesi i njësisë bazë DA [Evidenca 85 Parashikimi i ndarjes së ngarkesës]. Konstatohet se Departamenti Automatikës e planifikon ngarkesën mësimore për të gjithë anëtarët e personelit akademik, mbështetur në normat sipas udhëzimeve të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në shkallën e kualifikimit, të eksperiencës dhe fushën e kompetencës të secilit [Evidenca 4 - UPT - Rregullore e zhvillimit kurikular dhe mësimdhënies, Neni 26].</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.3



Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Nga vëzhgimi në vend dhe dokumentacioni GVJ konstaton se FIE ka në dispozicion ambiente të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor. Në godinën e Korpusit Qëndror, FIE ka në dispozicion godinën anësore, ku 3 kate të saj përdoren për zhvillimin e mësimin (klasa, laboratore), ambiente të përbashkëta (koridore, biblioteka, nyje sanitare), ambiente zyresh për stafin. Në godinën shtesë (godinën e FTI) FIE disponon gjysmën e katit të parë.</p> <p>FIE ka në përdorim sipërfaqen prej 6450 m² për studentet, dhe 546.6 m² salla dhe ambiente të tjera për personelin akademik [Evidenca 116 Tabelat e References BCH MEK], RVB tabela 16].</p> <p>Numri i studentëve aktivë për vitin akademik 2021 – 2022 është 671. Raporti i sipërfaqes është 9.61 m²/student.</p> <p>Normativa 5 m²/student, e përcaktuar nga VKM nr. 418 datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen,</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	bashkimin ose mbylljen e IAL dhe të degëve të tyre" për IAL e profileve inxhinierike është tejkaluar.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga vizita në FIE, GVJ vëzhgon se mjediset janë të restauruara dhe sipas standardeve bashkëkohore. Lartësia e katit tavan/dyshe në secilën godinë është më e madhe se 3 m, ka izolim të mirë akustik, me dritë, të pajisura me sisteme ngrohje-ftohje të centralizuara (të tipit chiller-AHU), duke i bërë efektivisht ambiente komode për mësimdhënien. Auditorët e leksioneve janë të pajisura me videoprojektorë fiks në mur, si dhe burime të shumëfishta të furnizimit me energji elektrike dhe lidhje me kabëll për internetin [Evidenca 89 Informacion në lidhje me infrastrukturën në funksion të programit të studimit]. Ajo që mungon, në disa auditorë, është kompjuteri fiks tek tavolina e pedagogut. Gjithashtu FIE ka në dispozicion edhe shumë ambiente laboratorike që i shërbejnë procesit mësimor, por edhe atij kërkimor-shkencor. Të gjithë këto laboratore janë të pajisur me pajisje elektronike dhe IT [Evidenca 74 Labororet e FIE, foto].
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga vëzhgimi në vend dhe dokumentacioni GVJ konstaton se UPT zotëron 88 laboratorë specifik sipas moduleve dhe 12 laboratorë për informatikën, të shpërndara nëpër godinat e tij. Nga këto laboratorë, FIE zotëron 12 laboratorë, ku 1 njëri është laborator IT dhe 11 të tjerët mbështesin lëndët përkatëse, të cilat mbulohen nga personeli akademik i departamenteve të FIE dhe departamenti i Konstruksioneve Mekanike në FIM [Evidenca 74 Labororet e FIE, foto]. Laboratorët janë të pajisur me pajisje fizike dhe makete të nevojshme që mbështesin disa prej lëndëve të zhvilluara në programin Inxhinieri Mekatronike. Disa prej maketeve laboratorike shërbejnë për studimin e qarqeve elektronike digjitale, për të studiuar teknikat e modulimit, për të analizuar sensorët dhe shndërruesit, etj. Përveç këtyre janë edhe laboratorët informatik me një numër të mjaftueshëm kompjuterash për të zhvilluar të gjitha ato aktivitete didaktike të cilat bazohen në zhvillimin e simulimeve të ndryshme kryesisht mbi software MATLAB, teknikat e procesimit të sinjalit, etj. Të gjitha këto laboratorë janë të lidhur në rrjetin internet në dispozicion të studentëve [Evidenca 89 Informacion në lidhje me infrastrukturën në funksion të programit të studimit]. Laboratorët, përveç aparaturave të nevojshme dhe specifike, janë të pajisur edhe me instrumente ndihmëse sikurse janë video-projektorët dhe printer të lidhur në rrjet.
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	FIE disponon 12 laboratore për lëndët e informatikës dhe teknologjisë së informacionit në tërësinë e ambienteve të tij. Çdo sallë informatike është e pajisur me hapësirën e nevojshme për zhvillimin normal të leksioneve /seminareve. Lëndët e teknologjisë së informacionit si p.sh. Informatika bazë apo gjuhët e programimit, zhvillohen nga personeli i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, i cili ka në dispozicion 7 laboratorë modern dhe të pajisur me programe profesionale (gjuhët C, C++, Java, Python, Sinjalet, Rrjetat, Sistemet elektronike, etj). Gjithashtu FIE në ambientet që administron ka një laborator të IT, në të cilin janë instaluar software e nevojshëm për lëndët që zhvillohen në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike, ku vlen të theksohet software MATLAB, i cili shërben për një pjesë të madhe të lëndëve që zhvillohen në këtë program studimi [Evidenca 74 Labororet e FIE].
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë	UPT, nëpërmjet ambienteve të veta në të gjitha fakultetet, garanton zhvillimin e proceseve laboratorike për studentët. Këto ambiente mund të përdoren edhe për realizimin e një pjese të praktikave mësimore profesionale.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	FIE në mënyrë specifike, me 12 laboratorët që ofron, garanton të gjithë hapësirat e nevojshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve didaktike, laboratorike dhe praktike për studentet e këtij programi studimi. Sipas GVB kryesisht praktikën profesionale me studentët e programin të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike kryhen pranë subjekteve private e shtetërore. Kjo është bërë e mundur falë marrëveshjeve që UPT dhe FIE ka me këto subjekte [Evidenca 18 Lista e institucioneve bashkëpunuese për praktikën profesionale].		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Sipas RVB, UPT ka në dispozicion Bibliotekën Shkencore që ofron 65570 tituj dhe 75 vende leximi [Evidenca 100 Rregullore e Bibliotekës Shkencore]. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike ka gjithashtu një bibliotekë të veten të pajisur me afro 2018 tituj dhe 32 poste leximi/konsultimi, në dispozicion për studentët dhe personelin akademik [Evidenca 99 FIE Biblioteka dhe burimet e bibliotekës] http://www.fie.upt.al/biblioteka.php . Studentët e FIE mund të aksesojnë dhe mësojnë në të gjitha bibliotekat dhe burimet bibliotekare të UPT, por në veçanti, për objektivat formuese të programeve të studimit të ofruara në FIE, bazohen kryesisht në Bibliotekën "Qendra Multimediale", e cila ndodhet në ambientet e FIE dhe është e përbashkët me FTI, Bibliotekën Shkencore Qendrore të UPT, Bibliotekën e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike. Qasja në bibliotekë garantohet në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët dhe stafin akademik dhe të gjithë të interesuarit.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Sipas informacionit nga vizita, Biblioteka Shkencore është e pajisur me një literaturë të pasur shqip dhe të huaj. Ajo disponon libra, monografi, revista, akte kongresesh apo konferencash, manuale, doracakë, etj. Biblioteka Shkencore ofron edhe reprografë ose fotokopje e autorizuar e pjesëve të ndryshme të librit. Ofrohet gjithashtu restaurim dhe lidhje librash. Biblioteka përmban tituj për fusha të ndryshme studimi dhe kjo i vjen në ndihmë studentëve të cilët kanë lëndë të ndërvarura nga fakultete të tjera (studenti i inxhinierisë mekatronike mund të konsultojë tekste mbi mekanikën dhe elektronikën, të cilët janë në dispozicion të FIM e FTI, etj). Biblioteka Shkencore në vitet 2017-2020 e ka zgjeruar fondin e saj me 2105 njësi bibliotekare dhe 605 tituj të rinj, sipas kërkesave të njëjësive kryesore për të siguruar përputhshmëri me kurrikulat e programeve të studimit [Evidenca 61 Lista e titujve të librave të rinj në tre vitet e fundit]. Sipas RVB, studentëve të FIE ju shërben kryesisht Biblioteka Shkencore dhe "Qendra Multimediale".
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Nga dokumentacioni dhe RVB konstatohet se UPT u ka krijuar kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët e të gjitha programeve të studimit, pra edhe të Inxhinierisë Mekatronike, në bibliotekat on-line. [Evidenca 99 FIE Biblioteka dhe burimet e bibliotekës]. https://bibliotekashkencore.edu.al/aksesimi-ne-bsh/

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	<p>UPT është i lidhur me sistemin COBISS (Co-operative Online Bibliographic System and Services) që përfshin një rrjet të gjerë bibliotekash dhe shërben për krijimin e një sistemi katalogimi të përbashkët, ku përdoruesit mund të aksesojnë në lidhjen https://plus.al.cobiss.net/opac7//libraries Përmes COBISS, studentët mund të lidhen online edhe me 15 biblioteka universitare, 10 biblioteka publike dhe 3 biblioteka speciale në 11 qytete të Shqipërisë.</p> <p>Në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik është edhe Portali i Bibliotekës Dixhitale, përmes sistemit ILS KOHA https://koha-community.org/, ku mund të shfletohen online artikuj shkencorë, mbi 193 mijë libra akademikë, mbi 50 mijë revista shkencore, mbi 200 milion lajme shkencore si dhe 30 paketa për mësimin e gjuhëve të huaj.</p> <p>Në dispozicion të studentëve është edhe libraria digjitale Jstor sikurse mund të konfirmohet nga informacioni në faqen ueb institucionale me të dhënat e nevojshme të aksesit dhe mundesive.</p> <p>http://www.upt.al/bashkepuni/aktivitete/1544-njoftim-per-mundesine-e-studenteve-dhe-stafit-te-universitetit-politeknik-te-tiranes-per-te-shfrytezuar-biblioteken-digjitale-jstor</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka Shkencore ofron lidhjen me internetin me kabëll ose edhe wireless, për të mundësuar që studentët të shfrytëzojnë katalogët online apo bibliotekat online që i vihen në dispozicion.</p> <p><u>Ambientet e bibliotekës nuk janë të pajisura me kompjutera fizik për të lehtësuar konsultimin e titujve online</u>, por studentët mund të përdorin tabletin/ laptopin personal apo pajisje të tjera për t'a bërë të mundur këtë gjë.</p> <p>Biblioteka e FIE duke patur kompjutera, fotokopje, printer, projektor, rrjet wireless, katalog elektronik, etj, bën të mundur shfrytëzimin pakufizim nga ana e të gjithë studentëve. Nga ana e FIE po bëhen përpjekje për dixhitalizimin e materialeve të bibliotekës dhe pajisjen e sallave të leximit me kompjutera dhe projektore. http://www.fie.upt.al/biblioteka.php/</p> <p>"Qendra Multimediale", e cila ndodhet në ambientet e FIE, është e pajisur me kompjutera dhe softje kompjuterike të përshtatshme për shfrytëzimin e literaturës së huaj.</p> <p>Këtë vit është mundësuar aksesit nga COBISS tek baza e të dhënave UNPAYWALL, që përmban me shumë se 31 milion artikuj shkencore me qasje të hapur në tekst të plotë, nga bazat e të dhënave të mbi 50.000 botuesve dhe repositorëve.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Sipas RVB, përditësimi i fondit të bibliotekës dhe shtimi i tij, ka qenë edhe një nga rekomandimet e akreditimit institucional të UPT në vitin 2017 [Evidenca 108 Plotesimi i rekomandimit për akreditimin institucional].</p> <p>Bazuar në këtë rekomandim, UPT ka hartuar e po zbaton një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, sipas kërkesave të të gjitha fakulteteve dhe departamenteve të saj, si edhe nga kërkesat e përdoruesve. Përveç blerjeve, pasurimi i fondit të BSH bëhet edhe përmes dhurimeve dhe shkëmbimeve me bibliotekat e tjera duke u fokusuar në profilin teknik dhe shkencor të koleksionit [Evidenca 102 Pasurimi i koleksionit të BSH 2017-2020].</p> <p>Ndërkohë në nivel institucioni, po zbatohet projekti për Automatizimin dhe Digjtimin e BSH. Aktualisht është duke u zhvilluar procedura e prokurimit për pajisjet e nevojshme për funksionimin e sistemit dhe vënien e tij në punë.</p> <p>Ndërkohë është duke u zhvilluar faqja e re https://biblioteka-shkencore.edu.al/ Përtej sistemit COBISS, prej vitit 2019 ofrohet edhe shërbimi i https://ulibrary.rash.al/, ku mund të shfletohen online artikuj shkencorë, mbi 193 mijë libra akademikë, mbi 50 mijë revista shkencore, mbi 200 milion lajme shkencore si dhe 30 paketa për mësimin e gjuhëve të huaj, i cili aksesohet me kredencialet personale institucionale të secilit student/pedagog dhe pa pagesë.</p>

	Edhe në nivel njësie kryesore, FIE dhe njësitë përbërëse të tij, në planifikimin e projekt-buxhetit [Evidenca 94 FIE - Evidence mbi hartimin e buxhetit 2019-2022], parashikojnë literaturën e nevojshme që duhet ti shtohet fondit ekzistues për mbështetjen e aktiviteteve didaktike dhe atyre shkencore [Evidenca 103 Praktika për porosi literature dhe blerje literature në FIE]. Kjo procedurë, ka garantuar që në nivel FIE, biblioteka të pasurohet me tituj të rinj [Evidenca 61 Lista e titujve të librave të rinj në tre vitet e fundit].		
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka Shkencore është në dispozicion të studentëve dhe të stafit akademik nëpërmjet infrastrukturës së saj, ajo zbaton këto orare: e Hënë-e Premte: 8.00: 19.00, e Shtunë: 8.00: 14.00 [Evidenca 99 FIE Biblioteka dhe burimet e bibliotekës]. Praktikisht, oraret e bibliotekës pasqyrojnë në kushte normale oraret e zakonshme të mësimdhënies në auditor [Evidenca 100 Rregullore e Bibliotekës Shkencore]. Sipas RVB, shfrytëzimi i ambienteve të bibliotekës nga studentët është 77% e kapaciteteve. <u>Mendojmë se Biblioteka Shkencore e UPT duhet të funksionojë edhe në oraret e pasdites, edhe në fundjavë.</u>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X
Standardi IV.5			
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Sipas RVB dhe dokumentave të vëna në dispozicion të GVJ evidentojmë se UPT mban në formë të shkruar (sipas Ligjit nr. 80/2015 neni 101): Regjistrin themeltar të studentëve, Regjistrin e arritjeve akademike (notave), Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave, Regjistrin e gradës shkencore “Doktor”, Regjistrin e titujve akademik. Prej Sekretarisë Mësimore administrohen edhe: Dosjet e regjistrimit të studentëve me dokumentacion sipas Udhëzimeve të MAS; Dosjet me procesverbalet e çdo provimi apo detyrimi tjetër akademik sipas viteve akademike; Dosjet e transferimeve dhe çregjistrimeve. Sekretaritë mësimore i plotësojnë këto regjistra në formë elektronike e fizike [Evidenca 93 Model Regjistri kurs]. Detyrat dhe organizimin e punës së Sekretarisë i ka të specifikuar qartë Rregullorja [Evidenca 6 Rregullore e brendshme FIE, neni 35 e 36]. <u>Konstatohet se nuk ka evidencë të veçantë për Rregulloren e Sekretarisë.</u> FIE ka në përdorim një sistem informatik për menaxhimin e të dhënave të lidhura me sekretarinë [Evidenca 110 Programi kompjuterik për menaxhimin e sekretarisë mësimore dhe studentët]. Sekretaria mësimore, përveç programit kompjuterik në dispozicion, ka qasje edhe në sistemin e qendëruar të ngritur U-Albania ku kryen regjistrimin e studenteve në vitin e parë dhe plotëson të dhënat përkatëse të pranimit të tyre në Universitetin Politeknik të Tiranës.		
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe	Sipas RVB, UPT dhe FIE administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe të gjithë personave të angazhuar në realizimin e programit Inxhinieri Mekanike nëpërmjet DBNJ. Specialistia e BNJ dhe Arkivit menaxhon dokumentacionin personal të punonjësve si dhe plotëson regjistrin themeltar, ndjek procedurat për kontratat e		

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al



E-mail: info@ascal.al

<p>partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>punës, hedh të dhënat e çdo punonjësi në regjistrin themeltar, si dhe nxjerr të dhëna nga dosjet e personelit kur kërkohen, bazuar në ligjin e “Mbrojtjes së të Dhënave Personale”.</p> <p>Sekretaria e dekanit të FIE, mban, ruan dhe administron, në përputhje me rregullat zyrtare, të gjithë dokumentacionin e departamentit si njësi administrative, ashtu edhe ato të stafit akademik që lidhen me procesin mësimor dhe administrativ, sipas akteve ligjore dhe nënligjore [Evidenca 6 Rregullore e brendshme FIE, neni 37].</p> <p>Përgjegjësi i departamentit plotëson dhe nënshkruan realizimin e ngarkesës mësimore, semestrale dhe vjetore të anëtarëve të departamentit, miraton planet mësimore kalendarike dhe marrëveshjen e punës, miraton tezat e provimeve, organizon aktivitete të ndryshme shkencore ose veprimtari të tjera që lidhen me funksionimin administrativ të departamentit dhe të procesit mësimor si dhe angazhohet për të lidhur marrëveshje me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Për sa i përket komunikimit shkresor zyrtar, në UPT administrimi i dokumentacionit bëhet nga Sektori i Arkivit dhe Protokollit në DBNJJ sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës në fuqi.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB, platformat softuerike në përdorim në FIE garantojnë qasje në informacion bazuar në profilin e përdoruesit, si student, si staf, apo administrator sistemi, etj. Të gjitha modulet e platformës "Microsoft Office 365" arrihen me anë të kombinimit përdorues/fjalëkalim, ku përdorues është adresa zyrtare e postës elektronike në domain emer.mbiemer@fie.edu.al. [Evidenca 111 Platformë softuerike në përdorim nga dhe për studentët]</p> <p>GVJ konstatoi se, në FIE në funksion të menaxhimit të brendshëm të informacionit është edhe platforma softuerike e përdorur nga sekretaria mësimore në funksion të aktivitetit të saj, me të drejta ndaj sistemit konform akteve në fuqi që rregullojnë aktivitetin e saj [Evidenca 110 Program i kompjuterik për menaxhimin e sekretarisë mësimore dhe studentët].</p> <p>Modulet e përfshira në këtë platformë lejojnë gjenerimin e raporteve, të dhënave të përmbledhura dhe të detajuara për të gjithë studentet e regjistruar në programet e studimit të ofruara në FIE. Në këtë platformë paraqiten planet mësimore të miratuara për çdo vit akademik dhe për secilin nga programet e studimit të ofruara në FIE, bëhet ndarja e studentëve në grupe mësimore dhe lidhja e tyre me planin mësimor përkatës, lëndët e zhvilluara janë të lidhura me stafin akademik që e zhvillon atë dhe kjo pasqyrohet edhe në raportet apo procesverbalet e krijuara nga sekretaria mësimore në funksion të aktivitetit të saj. Të dhënat e paraqitura në sistemin e sekretarisë mësimore, gjithashtu garantojnë qasje të dedikuara për studentët, të cilët mund të shohin vetëm të dhënat personale dhe avancimin e tyre akademik.</p> <p>Studentët mund të informohen në çdo kohë pranë SM, pranë departamentit si dhe mund të marrin të gjithë informacionin e kërkuar nëpërmjet sistemit on-line, të dedikuar.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sipas RVB, platformat softuerike në përdorim në FIE garantojnë qasje në informacion. Të gjitha modulet e platformës "Microsoft Office 365" kanë të integruar mundësinë e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit. E gjithë platforma bazohet në Microsoft Share Point, e cila, sikurse e thotë edhe emri "Share point", ka në thelb bashkëpunimin [Evidenca 111 Platformë softuerike në përdorim nga dhe për studentët, office 365].</p> <p>Në veçanti, moduli "Microsoft Teams", gjeti një përdorim të gjerë në periudhën akademike të pandemisë Covid -19 [Evidenca 112 Vendim mbi zhvillimin e procesit akademik në platforma on-line].</p> <p>Me vendim të Dekanit është ngritur në FIE një grup pune për të vlerësuar platformën më të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve didaktike në këtë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>periudhë. Bazuar në njohjen e hershme të stafit të FIE për platformën Microsoft Office 365 si dhe formimin e tyre në fusha të IT, u hartuan disa udhëzues për të rritur njohuritë e për tu ardhur në ndihmë kolegëve të UPT për përdorimin e këtij instrumenti. Në krijimin e udhëzuesve u vlerësuan mundësitë e raportimit të detyrimeve si frekuentimi i aktiviteteve on-line nga studentët dhe se si kjo mund të gjurmohej [Evidenca 90 Shembull klase virtuale në platformën Microsoft Teams].</p> <p>Udhëzues i ngjashëm u hartua edhe për studentët, material i shpërndarë më pas në të gjithë trupën studentore të UPT për të rritur njohuritë rreth përdorimit të platformave online në aktivitetin didaktik dhe shkëmbimit të informacionit student-student dhe student-staf [Evidenca 113 Manual trajnimi dhe përdorimi Microsoft Teams (student, pedagog)].</p>		
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sipas RVB, sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p> <p>Në përdorimin e platformave on-line të përfshira në paketën "Microsoft Office 365" gjurmimi i aktivitetit të përdoruesve realizohet në mënyrë të përmbledhur statistikore në zëra të veçanta të quajtura "Insights" ku përmbledhen të dhëna rreth përdorimit të moduleve specifike.</p> <p>Në modulën "Microsoft Teams", në zërin "Insights" shfaqen të dhëna statistikore rreth përfshirjes së studenteve por edhe stafit. Ka të dhëna rreth numrit të postimeve në platformë, komenteve mbi një postim, analizën e detyrave të caktuara (assignments), nëse studenti e ka parë apo jo, e ka dorëzuar apo jo si detyrë. Të dhëna mbi oraret me më shumë aktivitete në platformë, kush janë përdoruesit me aktiv, kush janë studentët e futur në një aktivitet online, kohën e prezencës e pare si orar i prezencës dhe i daljes prej saj [Evidenca 111 Platformë softuerike në përdorim nga dhe për studentët, office 365].</p> <p>Një pjesë e këtyre të dhënave janë përdorur gjatë periudhës së diktuar nga përhapja e virusit Sars-Cov-2 për të raportuar zhvillimin e aktivitetit didaktik në platforma on-line si dhe përfshirjen e studentëve sipas një model evidence të miratuar [Evidenca 90 Shembull klase virtuale në platformën MS Teams].</p>		
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ vërejtë se faqen web https://www.upt.al/fakultete-dhe-institute, UPT publikon të dhënat e përgjithshme për të gjitha fakultetet dhe institutet e saj, linku pastaj të çon tek faqja e secilit fakultet. Faqja zyrtare web e UPT ofron informacionin edhe në gjuhën angleze.</p> <p>FIE ka faqen e saj web ku publikon të gjitha informacionet me karakter publik të nevojshme për informimin e studentëve dhe të stafit www.fie.upt.al ku listohen aktivitetet, orari, rregulloret, programet e studimit, organika e secilit departament etj.</p> <p><u>Përsërisim këtu komentet tona për të dhëna të pasakta e të vjetëruara në faqen web direkte të FIE, të paraqitura në Standartin III.3, Kriteri 10.</u></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<p>Standardi IV.6 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Sipas RVB, UPT miraton tarifat e shkollimit çdo vit, referuar Ligjit 80/2015 dhe VKM-ve specifike, me vendim të BA, pasi është marrë mendimi paraprak i SA të UPT, për çdo PS, mbi bazën e propozimeve të njësie kryesore. Në faqen web evidentohen tarifat e miratuara studentore të regjistrimit dhe kalimit në vitet pasardhëse https://www.upt.al/keshilli-i-administrimit/ .</p> <p>Sipas RVB, Autoriteti përgjegjës për raportimin financiar në UPT është Administratori [Evidenca 75 UPT Organiograma]. Në varësi të tij gjendet administratori i njësisë kryesore [Evidenca 96 FIE Organiograma], përgjegjës për mirëfunksionimin financiar dhe administrativ të fakultetit. Administratori harton në mënyrë periodike raportin financiar të UPT [Evidenca 115 Analiza financiare UPT], që paraqitet për miratim si pjesë e raportit vjetor pranë SA dhe BA. Në të pasqyrohen kostot financiare mesatare për student në nivel universiteti. Edhe në nivel njësie kryesore, Administratori i fakultetit harton raporte të përvitshme në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet FIE [Evidenca 116 Tabelat e Referencës BCH MEK]. Nëpërmjet planifikimit të buxhetit për çdo vit pasardhës, i cili realizohet në mënyrë periodike, si rregull në përfundim të vitit, kjo strukturë harton edhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për vitin pasardhës, si dhe harton buxhetin afatmesëm, i cili mbulon një periudhë 3 vjeçare, çka jep mundësinë për një plan mbështetjeje financiare për të paktën një cikël të plotë studimi. [Evidanca 94 FIE Evidencë për hartimin e buxhetit 2019-2022]. Të dhënat e plota mbi mbështetjen financiare të programeve të studimeve janë publike dhe gjenden në faqen zyrtare të UPT, në linkun: https://www.upt.al/rreth-nesh/programi-i-transparences .</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Sipas RVB, në planin strategjik FIE bën një analizë të detajuar të gjendjes aktuale dhe strategjike, duke e ndarë këtë të fundit në një planifikim afatshkurtër dhe afatgjatë. FIE vë në dispozicion për programin e studimit "Bachelor në Inxhinieri Mekatronike" të gjitha burimet njerëzore dhe asetet e nevojshme për realizimin e tij.</p> <p>Sipas RVB, UPT nuk harton plan financiar të dedikuar për një program studimi specifik, por ky plan vjen si pjesë integrale e planit financiar të njësisë kryesore dhe përmban si rregull financimin e BNJ në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij [Evidanca 94 FIE Evidencë për hartimin e buxhetit 2019-2022]. Në fillim të çdo viti financiar personeli akademik i DA harton parashikime buxheti në lidhje me nevojat për investime laboratorike, bibliotekare, mbështetje për pjesëmarrje në konferenca, botime shkencore, libra të rinj, etj. [Evidenca 95 DA - Evidencë mbi hartimin e buxhetit 2021-2022].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare</p>	<p>Sipas RVB, Autoriteti i auditimit të brendshëm i UPT është nën varësinë e Bordit të Administrimit BA [Evidenca 75 UPT Organiograma]. Statusi organizativ, qëllimi, misioni, objektivat e punës, përgjegjshmëria dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit të brendshëm përcaktohen në Kartën e Auditit të Brendshëm, e cila miratohet nga BA [Evidenca 1 Statuti i UPT]. UPT, ndjek një politikë transparente të shpërndarjes së burimeve financiare, pasi të gjitha transaksionet financiare kryhen nëpërmjet sistemit të thesarit të shtetit. Për analizën financiare, UPT e bazon veprimtarinë në ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" dhe zbaton të gjitha</p>

<p>për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>detyrimet që lindin prej tij. UPT kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe efektivitetin financiar të tij, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 114/2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.</p> <p>Raporti financiar realizohet në mënyrë periodike dhe përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. Ky raport paraqitet prej Administratorit të universitetit pranë SA dhe BA. Raportet financiare të hartuara nga UPT janë objekt kontrolli nga organet ligj zbatuese [Evidenca 115 Analiza financiare UPT]; [Evidanca 81 FIE Relacion të dhënat financiare 2019-2022].</p> <p>Sipas RVB, raporti për veprimtarinë financiare të universitetit publikohet dhe vihet në dispozicion të publikut, përmes programit të transparencës në faqen zyrtare të UPT, përmes lidhjes http://www.upt.al/rrethesh/programi-i-transparences/ dhe në portalin https://u-transparenca.al/.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>UPT ka autonomi financiare. Referuar nenit 24 e 25 të Statutit burimet kryesore të financimit janë: të ardhurat nga buxheti i shtetit, pagesat e studentëve për shkollim, të ardhurat nga veprimtaria kërkimore dhe shërbimet për të tretë, donacione, të ardhurat nga administrimi i ambienteve të tij e të tjera të ligjshme. Drejtoria Ekonomike është struktura në UPT, që ndjek zbatimin e të gjitha procedurave financiare të lidhura me planifikimin dhe realizimin e buxhetit në UPT e përmes së cilës UPT analizon treguesit e monitorimit për zbatimin e politikës financiare https://upt.al/dega-finance/.</p> <p>Sipas RVB, institucioni çdo vit harton buxhetin, mbështetur në kërkesat buxhetore të fakulteteve, të cilat përfaqësojnë nevojat me qëllim arritjen e objektivave strategjike si dhe realizimin e misionit të tij</p> <p>https://upt.al/images/stories/ngjarje/Vendim%20Bordi%20NR.16.pdf</p> <p>Kërkesat hartohen fillimisht nga DA e më pas nga FIE. Projektbuxheti diskutohet në Dekanat, Rektorat e SA para se të miratohet nga Bordi i Administrimit BA [Evidenca 86 Rregullore e bordit të administrimit].</p> <p>Dokumenti i analizës financiare të UPT në fund të çdo viti, miratohet [Evidenca 109 Praktikë buxheti afatmesëm 2022-2024] e më pas protokollohet e ruhet në arkivën e vetë universitetit, në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore për arkivë–protokollin.</p> <p>Kjo analizë bazohet mbi propozimet e bëra nga njësitë kryesore dhe ato bazë si dhe parashikimet e projekt-buxhetit afat-mesëm 2019-2021, pra ai nuk përshkruan vetëm periudhën koherente, por ka edhe një natyrë krahasuese për shumicën e zërave të buxhetit me periudhat ushtrimore të shkuara, çka do të thotë se të jep mundësinë për të gjykuar mbi raportet financiare të tre viteve të kaluara akademike dhe të planifikojë ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të secilit program studimi për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Sipas RVB, për mirëmenaxhimin e fondeve dhe sigurimin e një qëndrueshmërie financiare, gjatë analizës vjetore shqyrtohet edhe realizimi i treguesve mbi zbatimin e politikës financiare të vetë institucionit.</p> <p>GVJ mbi bazën e evidencave konstaton se UPT ka burime financiare dhe kapacitete menaxhimi të qëndrueshme. Mesatarisht rreth 66% e të ardhurave (2017- 2019) financohen nga shteti dhe rreth 34% e tyre gjenerohen prej UPT. Buxheti vjetor i UPT ka pësuar rritje të vazhdueshme me 8-10%/vit gjatë viteve të fundit. Në të ardhurat që vetë UPT gjeneron, 53% burojnë nga tarifa e shkollimit.</p> <p>Referenca [Evidenca 107 UPT Tabela e të ardhurave dhe investimeve 2018-2021] pasqyron qartë gjendjen financiare dhe kolonat e saj të institucionit, duke evidentuar një gjendje luhatjeje rreth një pike ekuilibri.</p>

	Në të ardhurat, peshë të rëndësishme zënë shërbimet për të tretë. Këto shërbime përfshijnë konsulenca dhe ekspertiza që ofrohen përmes personelit të UPT dhe përmes infrastrukturës laboratorike dhe shkencore që institucioni disponon. Personeli akademik i DA jep një kontribut të rëndësishëm në shërbimet për të tretët duke përgatitur projekte elektrike dhe oponenca për pjesën e instalimeve elektrike të objekteve të ndryshme. Për të menaxhuar këto shërbime dhe për të rritur performancën në vitin 2020 është ngritur Drejtoria e Shërbimeve ndaj të Tretëve, e cila funksionon në bazë të Rregullores për Disiplinimin e Sistemit të Shërbimeve në UPT dhe është publike https://www.upt.al/images/stories/menu/rregullore_e_sherbimit_ndaj_te_treteve			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE


Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Sipas RVB, UPT, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe aktet e tjera rregullatore në zbatim të tyre, ka hartuar një sërë dokumentash bazë me qëllim mbulimin e plotë të cikleve të studimit, ndër to edhe të programit të studimit Bachelor në “Inzhinieri Mekatronike” si: Statuti UPT [Evidenca 1 Statuti i UPT, Kreu V dhe VI Organizimi i studimeve]; Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies i dedikohet zhvillimit dhe menaxhimit të programeve të studimit dhe të procesit mësimor nga hyrja deri në dalje (diplomim) [Evidenca 4 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT].</p> <p>UPT në drejtim të politikave ka hartuar dhe zbaton Planin Strategjik të tij [Evidenca 2 Plani Strategjik i UPT 2019-2024] ku Kreu IV i është dedikuar studentëve. Ky plan synon: Zhvillimin e qendrueshëm të cilësisë së pranimeve në të gjitha programet e studimit në UPT; Përmirësimin e kulturës së cilësisë në procesin e edukimit nëpërmjet zbatimit të standardeve më të përparuara; Reformimin në bazë të rezultateve të të mësuarit dhe me qendër studentin; Vlerësimin periodik të programeve të studimit dhe akreditimin e tyre; Rritjen e cilësisë së praktikave profesionale dhe diversifikimin e tyre; Zhvillimin e infrastrukturës dixhitale për përmirësimin e edukimit dhe krijimin e oportuniteteve për personelin akademik; Fuqizimin e nismave mbështetëse për të ndihmuar suksesin profesional dhe futjen e të diplomuarve në tregun e punës. Strategji janë hartuar dhe në nivel fakulteti dhe departamentesh Po ashtu janë hartuar dhe zbatohen rregullore për mirëfunksionimin e njëjve kryesore dhe</p>

	<p>njësive bazë [Evidenca 6 FIE Rregullore e Brendshme], [Evidenca 8 DA Rregullore e organizimit dhe funksionimit].</p> <p>Konstatohet se edhe Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike" që ofrohet në UPT nga DA në FIE, ndjek të gjitha aktet rregullatore të ngritura në nivel institucional dhe në njësitë përbërëse kryesore dhe bazë.</p> <p>Gjithashtu në UPT dhe FIE janë ngritur dhe funksionojnë struktura të posaçme të cilat kanë për detyrë kontrollin dhe zbatimin e rregulloreve dhe procedurave të mësipërme, si: Drejtoria e Kurrikulave, Drejtoria e Komunikimit dhe Kordinimit, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë Sekretaria Mësimore, Sigurimi i Cilësisë.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UPT në politikën e pranimit të studentëve bazohet në legjislacionin në fuqi dhe në rregulloret e brendshme. Për çdo vit akademik, kriteret propozohen në departamentin përgjegjës për programin e studimit.</p> <p>Barazinë dhe të drejtat e njëjta për kandidatët për Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike", DA, FIE dhe UPT e sigurojnë nëpërmjet transparencës së të gjitha procedurave nga hyrja në dalje e studentëve të këtij program studimi.</p> <p>Bërja publike e këtyre rregulloreve [Evidenca 9 DA Rregullore mësimore e Programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike] si dhe procedurave në websitet e UPT http://upt.al/ dhe FIE http://www.fie.upt.al/ shërben gjithashtu për garantimin e barazisë dhe drejtësisë në ofrimin e shërbimeve ndaj studentit, duke mundësuar një konkurrencë të drejtë bazuar në vlerat individuale të gjithsecilit student.</p> <p>Kandidatët aplikojnë online të koordinuar nga QSHA. Në përputhje me informacionin e marrë nga QSHA Departamenti i Automatikës bën përzgjedhjen e kandidatëve në përputhje me kriteret e pranimit dhe FIE shpall listën paraprake e më pas atë përfundimtare të fituesve në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi [Evidenca 52 - DA - Procedure e komisionit Ad - Hoc për pranimin e studentëve në BCH MEK dhe AUT].</p> <p>http://upt.al/bashkepunime/aktivitete/931-listat-e-renditura-te-kandidateve-ne-programet-e-studimit-2019-2020-raundi-1-sipas-fakulteteve-perkatese .</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Sipas RVB, kriteret e pranimit shpallen nga UPT dhe vihen në dispozicion të QSHA dhe në portalin e RASH [Evidenca 117 – FIE Kriteret e Pranimit në Programet e studimit], me qëllim bërjen publike të tyre për maturantët, përpara se ata të zgjedhin programet e preferuara.</p> <p>Të gjitha kriteret dhe procedurat përkatëse janë lehtësisht të aksesueshme dhe të kuptueshme nga studentët në faqen zyrtare të UPT së në rubrikën "Legjislacion" https://www.upt.al/2014-11-05-10-00-43 dhe FIE http://www.fie.upt.al/ .</p> <p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për GVJ, konstatohet se njohja e plotë dhe e pjesshme e krediteve të studentëve që vijnë me transferim nga programe të tjera studimi brenda ose dhe jashtë UPT-së, mundësohet sipas Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies së UPT. [Evidenca 4 Kreu VI, Transferimet, njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i lëndëve https://www.upt.al/transfertime]. Pranë FIE për PS Bachelor në Inxhinieri Mekatronike ngrihet në fillim të çdo viti akademik një komision ad-hoc për ekuivalentimin dhe njohjen e lëndëve/krediteve. Ky komision shqyrton dokumentacionin e studentit dhe kryen ekuivalentimet përkatëse [Evidenca 57 Procedurë transferim studimi në programin e studimit BCH MEK].</p> <p>Të gjitha strukturat e UPT që kanë lidhje direkt me informimin dhe pranimin e studentëve të rinj, si zyrat e karrierës, sekretaritë mësimore dhe zyrat e financës kanë të publikuara oraret e pritjes së studentëve për plotësimin e nevojave të tyre. Të angazhuar plotësisht në informimin dhe pranimin e studentëve të rinj, janë stafet drejtuese të fakulteteve dhe departamenteve si dhe i gjithë stafi akademik. Pranë FIE funksionon zyra e Sigurimit të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, që jep informacion mbi programet e studimit, mundësitë e punësimit dhe ofron shërbimin e këshillimit. Kjo zyrë mbështet studentët për orientim dhe këshillim gjatë gjithë cikleve të studimit [Evidenca 6 FIE Rregullore e brendshme, neni 38]. 5.</p> <p><u>Mungesa e incentivave (jo vetëm financiarë) për studentët ekselentë si dhe informacion i paplotë për nivelin e punësimit të të diplomuarve në FIE.</u></p> <p>Guida Studentore është një instrument i rëndësishëm në drejtim të informimit të studentit për përparimin e tij gjatë studimeve [(Evidenca 55 Broshura informuese, guida për studentët)].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Sipas RVB, kriteret e veçanta për zgjedhjen e studentëve vendosen mbështetur në një analizë të kushteve konkrete në të cilat veprohet, duke synuar të tërhiqen kandidatët me rezultate më të larta. Kriteret dhe kuotat hartohen dhe bëhen publike një vit përpara se ato të hyjnë në fuqi, me qëllim që maturantët të njihen që më përpara me to dhe të kenë mundësinë të orientohen më drejt në zgjedhjen e tyre. Kriteret e pranimit shpallen nga UPT në website e tij http://upt.al/bashkepuniime/aktivitete/1584-njoftim-kriteret-e-pranimit-ne-programet-e-studimit-te-ciklit-te-pare-dhe-programet-e-integruara-te-studimit-te-ciklit-te-dyte-te-ofruara-nga-fakultetet-e-upt-se-per-vitin-akademik-2023-2024.</p> <p>Kriteret së bashku me kuotat e pranimit miratohen në nivel institucional dhe më pas raportohen në ministrinë përgjegjëse për arsimin, konform akteve rregullatore në fuqi. [Evidenca 119 Vendim për miratimin e kuotave të pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve].</p> <p>Këto kriteret u bëhen të njohura maturantëve edhe përgjatë aktiviteteve të ndryshme të informimit me ta (Panairt Work & Study).</p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënllore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Sipas RVB, kriteret e përgjithshme [Evidenca 4 Rregullore e Zhvillimit Kurrrikular dhe Mësimdhënie në UPT neni 19] dhe kriteret specifike për PS Bachelor në Inxhinieri Mekanike [Evidenca 9 DA Rregullore mësimore e Programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike] hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet ligjore në fuqi për arsimin e lartë dhe maturën shtetërore, i përcillen QSHA dhe bëhen publike përmes https://ualbania.al/ dhe shpalljes në faqet zyrtare https://www.upt.al/senati?start=1</p> <p>Kriteret e pranimit në programin e studimit Inxhinieri Mekanike parashikojnë dhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p> <p>Kuotat e pranimit të studentëve në këtë program studimi, të propozuara prej Departamentit të Automatikës parashikojnë kandidatët të kategorive të veçanta si kandidatët nga trojet shqipfolëse jashtë kufijve, shtetas të huaj, nga shtetas në nevojë, kandidatët me aftësi të veçanta, për transferim studimesh apo program të dytë studimi [Evidenca 118 FIE Kuotat e Pranimit në Programet e studimit].</p>
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB, UPT përpara plotësimit të formularëve të aplikimit prej maturantëve, në ambientet e gjimnazeve të tyre, në ambientet e UPT nëpërmjet Open Days 2022, shpall kalendarin përkatës për këto veprimtari dhe organizon takime promovuese me kandidatët për studentët https://www.upt.al/bashkepuniime/aktivitete/1690-njoftim-13.</p> <p>Në këto takime marrin pjesë stafi akademik, ku qartësojnë nxënësit – maturantët mbi të gjitha programet e studimit që FIE ofron, si dhe mbi procedurat dhe kriteret për tu regjistruar si student në secilin program studimi, për të informuar të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit Inxhinieri Mekanike.</p> <p>Në website-in e UPT dhe të FIE gjenden gjithashtu informacione dhe për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit https://www.upt.al/pranime-ne-upt http://www.fie.upt.al/</p>

	Përcjelljen e këtij informacioni për publikun dhe të interesuarit, UPT e realizon edhe nëpërmjet aktiviteteve të tjera të realizuara në koordinim me DAR dhe MAS. [Evidenca 20 Panairi i punës 2018 dhe aktivitete të tjera]; [Evidenca 21 Panairi work study].		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Sipas RVB, kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin janë të përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT [Nenet 37 & 38, Evidenca 4]. Këto kushte janë publike dhe në faqen zyrtare të UPT http://upt.al/kushtet-e-kalimit-ne-vitin-pasardhes</p> <p>Informacioni është publikuar edhe në faqen elektronike të FIE http://www.fie.upt.al/bachelor.php [Evidenca 52 Procedurë e Komisionit <i>ad-hoc</i> për pranimin e studentëve në BSC MEK]</p> <p>Në FIE, në ditën e parë të javës orientuese studentët marrin informacion të përgjithshëm nga drejtuesi i njësisë kryesore, njësisë bazë, stafi akademik i Departamentit të Automatikës dhe ai administrativ mbi përmbajtjen e programit të studimit. Më tej ata informohen nga anëtarët e KPS si dhe nga zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës që ofron gjithë informacionet e nevojshme për përparimin akademik të studentëve. Çdo titullar lënde apo moduli në orën e parë të zhvillimit të lëndës, në fillim të semestrit qartëson studentët mbi përmbajtjen e syllabusit, mbi mënyrën e kontrollit të njohurive dhe mbi të gjitha detyrimet e lëndës.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Sipas RVB, kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme jepen në mënyrë të hollësishme në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT [neni 45, Evidenca 4]. Këto kritere dhe procedura janë publike dhe të aksesueshme nga studentët gjithashtu në faqen web të UPT http://upt.al/transferime si dhe në faqen web të FIE https://fie.upt.al</p> <p>Informacioni gjithashtu jepet dhe nga strukturat e tjera të FIM si: Zv. Dekani për anën mësimore, Sekretaria mësimore, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, etj.</p> <p>Sipas RVB, UPT mund të njohë si kredite të formimit universitar, në programet e veta të studimit, njohuri dhe aftësi profesionale të certifikuara sipas akteve ligjore në fuqi, si dhe njohuri të veprimtarive formuese, të nivelit pas shkollës së mesme dhe që janë në përputhje me objektivat specifike të programit përkatës të studimit. Në këtë rast, numri maksimal i krediteve të njohura nuk i kalon 60 (gjashtëdhjetë) kredite për programet e studimit të ciklit të parë dhe 40 (dyzet) kredite për programet e studimit të ciklit të dytë [Evidenca 58 Njohje kredite për student në BSC MEK].</p> <p>UPT njej studime të pjesshme të realizuar jashtë në kuadër të projekteve të ndryshme europiane, studentët mund të shkojnë dhe të realizojnë lëndë/module në IAL jashtë vendit, me të cilat UPT-ja ka marrëveshje. Lëndët dhe kreditet e përfutuara në institucionin pritës u njihen dhe pasqyrohen në suplementin e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	diplomës së programit të studimit që ndjek studenti [neni 44, Evidenca 4]; [Evidenca 59 Njohje kredite për student në Erasmus].		
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	<p>Sipas RVB, kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve jepen në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT [neni 29, Evidenca 4]. Këto kritere dhe procedura janë të aksesueshme dhe në faqen web të UPT http://upt.al/sesionet-e-provimeve.</p> <p>Sipas RVB, në FIE bazuar në veçoritë e secilës lëndë, dhe brenda lirisë akademike të pedagogëve të angazhuar në zhvillimin e lëndëve, mënyrat e vlerësimit janë një apo disa prej formave të më poshtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> · Provim i ndërmjetëm · Vlerësimi i projektit/detyrës së kursit · Vlerësim i punëve të laboratorit · Provim përfundimtar <p>Pesha e secilës mënyrë vlerësimi është e përcaktuar në planin mësimor dhe syllabuset e secilës lëndë [Evidenca 12 Syllabuset e programit të studimit].</p>		
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>Sipas RVB, kriteret e përgjithshme dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit jepen në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT [Kreu VIII Diplomimi, neni 59 Evidenca 4]. Këto kritere dhe procedura janë të aksesueshme dhe në faqen web të UPT http://upt.al/diplomimi</p> <p>Në FIE, studentët informohen rreth kritereve të përgjithshme dhe procedurat e diplomimit për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekanike” me fillimin e vitit akademik edhe nga KPS, drejtuesi i departamentit si edhe nga sekretaria mësimore, por një informim më të hollësishëm marrin studentët në vitin e tretë.</p> <p>GVJ konstaton se ky program studimi përfundon me provim përfundimtar [Evidenca 116 Tabelat e Referencës BCH MEK, RVB, tabela 10 Plani mësimor]; [Evidenca 66 Rregullore Diplomimit në Inxhinieri Mekanike]. <u>Përsërisim këtu komentet tona mbi mundësinë e përfundimit të studimeve 3-vjeçare nëpërmjet mbrojtjes së diplomës me tema konkrete, të shprehura këto komente në Standartin III.8, kriteri 6.</u></p>		
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>GVJ evidenton se Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit është njësi strukturore mbështetëse e UPT-së. Kjo drejtori harton dhe publikon çdo fillim viti akademik Guidën Studentore http://upt.al/bashkepunime/aktivitete/1456-njoftim-publikohet-guida-studentore-2021-2022 për t’u ardhur në ndihmë studentëve, sidomos atyre të viteve të para [Evidenca 55 Guida Studentore].</p> <p>Sipas RVB, çdo fillim viti akademik e në mënyrë periodike, UPT organizon ditët informuese me kandidatët për student, me bashkëpunimin e MAS, e cila informon në shkollat e mesme profesionale dhe gjimnaze për organizimin e këtyre aktiviteteve. Këto realizohen me pjesëmarrës të së paku tre anëtarëve nga stafi akademik i secilës njësi bazë që ofron programe studimi të ciklit të parë apo programe të integruara të ciklit të dytë [Evidenca 48 Aktivitete informuese mbi programet e studimit] dhe janë të hapura, për të gjithë të interesuarit</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X



Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Sipas RVB, struktura, organizimi dhe kohëzgjatja e programit të studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike janë të përcaktuara në Rregulloren e Programit të Studimit [Evidenca 9 DA Rregullore mësimore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike]. Këtë informacion studentët e gjejnë edhe në http://www.fie.upt.al/bachelor_mekatronike.php</p> <p>UPT dhe FIE ndjekin një politikë të informimit të vazhdueshëm të studentëve nëpërmjet të gjitha formave të mundshme si njoftimet e ndryshme në faqen zyrtare web http://upt.al dhe http://fie.upt.al njoftimet në ambientet e fakultetit, komunikimin direkt me pedagogët, tutorët, përgjegjësit e departamenteve.</p> <p>Studentët informohen që në momentin e regjistrimit pranë Sekretarisë mësimore mbi organizimin, kohëzgjatjen dhe statusin e programit të studimit.</p> <p>Javën e parë të vitit akademik për studentët e regjistruar për herë të parë në programin e studimit Inxhinieri Mekatronike bëhet një takim informimi nga Drejtuesi i DA dhe anëtarët e KPS.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Sipas RVB, bëhet publik informacioni mbi lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit Inxhinieri Mekatronike. Pedagogët e secilës lëndë kanë detyrim që në fillim të procesit mësimor tu japin studentëve një informacion të hollësishëm mbi lëndën, ndarjen në kredite të çdo aktiviteti mësimor, frekuentimin, komponentët e vlerësimit të lëndës [Evidenca 12 Sylabuset e programit të studimit].</p> <p>Sipas RVB, në faqen web të FIE studentëve u jepet informacioni i nevojshëm për programin e tyre të studimit, nëpërmjet planit mësimor e rregullore së programit të studimit. http://www.fie.upt.al/bachelor_mekatronike.php</p> <p>Për çdo informacion studentët mund të kontaktojnë direkt ose përmes e-mail-it me: pedagogët kujdestarë, Sekretarinë Mësimore, Drejtuesit e departamenteve, Zv. Dekanin mësimor, etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Konstatohet se UPT ka në fokusin e vet bashkëpunimin me industrinë, biznesin, kompanitë dhe institucionet. [Evidenca 34 Lista e marrëveshjeve aktive bashkëpunuese UPT me universitete brenda dhe jashtë vendit]</p> <p>UPT informon në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet njoftimeve aktive në faqen e tij zyrtare www.upt.al dhe zyrave të karrierës në UPT dhe FIE studentët e programit Inxhinieri Mekatronike mbi mundësitë e punësimit, intership-e, trajnime dhe i mbështet për të hyrë sa më shpejt në tregun e punës [Evidenca 23 Shembuj njoftimi punësimi dhe intershipi]</p> <p>http://upt.al/bashkepunime/aktivitete</p> <p>Sipas RVB, UPT ka qenë partner në projektin GRADUA me universitet të tjera shqiptare dhe të huaja, MAS dhe RASH për krijimin e një platforme, e cila shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe kompanitë private dhe shtetërore. Studentët vendosin të dhënat e tyre dhe kompanitë private dhe shtetërore mund të përzgjedhin direkt nga platforma studentët për punësim [Evidenca 22 Projekti GRADUA].</p> <p>Konstatohet se, studentët, jo vetëm informohen rreth mundësive të punësimit, por edhe inkurajohen të marrin pjesë në aktivitetet informuese/trajnuese që organizohen për të rritur aftësitë dhe njohuritë e tyre rreth tregut të punës https://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete/1530-njoftim-u-zhvillua-trajnimi-me-teme-si-te-shkruajme-nje-cv-dhe-nje-leter-te-suksesshme-motivimi</p> <p>UPT me përfaqësues nga të gjitha njësitë kryesore, merr pjesë në aktivitetin Work and Study, ku kompani të ndryshme marrin pjesë duke paraqitur ofertën e tyre të punësimit [Evidenca 20 Panairi i punës 2018 dhe aktivitete të tjera]; [Evidenca 21 Panairi Work Study]</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe</p>	<p>Studentëve të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij</p> <p>Para fillimit të vitit akademik, shpallen në ambiente publike orari mësimor që përmban informacion të detajuar në lidhje me ditën, orën, klasën, lëndën, personelin akademik përgjegjës [Evidenca 51 FIE - Orari i Mësimit dhe Orari i Provimeve BCH].</p> <p>Në faqen web të UPT http://upt.al dhe FIE http://fie.upt.al gjendet gjithashtu një hapësirë e dedikuar për studentët, në të cilën ata marrin informacion në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, oraret e provimeve, kalendarin akademik, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet, Bibliotekën Shkencore të UPT dhe atë të FIE, njoftime të ndryshme për projektet Erasmus+, punësimi, workshope, etj.</p>		
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Sipas RVB, informacioni në lidhje me programin Inxhinieri Mekatronikë është lehtësisht i arritshëm edhe nga studentët në distancë, përmes: Faqes zyrtare të FIE www.fie.upt.al ; Komunikimit në vijimësi në nivel departamenti; Njoftimi përmes adresave zyrtare të email, emër.mbiemër@fie.edu.al; Strukturës së plotë të krijuar në platformën Teams; Njoftime në rrjetet sociale.</p> <p>Sipas RVB, nëpërmjet platformës MS TEAMS, studentët marrin njoftime të ndryshme nga sekretaria mësimore, pedagogët e lëndës në lidhje me detyra projektet si udhëzimet dhe afatet e dorëzimit të tyre etj. Për të rritur efikasitetin e përdorimit të platformës TEAMS elektronike në dispozicion, është përgatitur edhe një udhëzues specifik për studentët [Evidenca 113 Manual trajnimi dhe përdorimi Microsoft Teams (student, pedagog)].</p> <p>Studentët marrin informacione të personalizuara edhe nëpërmjet komunikimit me anë të postës elektronike dhe platformës Microsoft Teams, të dhëna personale mbi avancimin e tyre akademik nëpërmjet portalit online të sekretarisë mësimore, informohen rreth vlerësimit në lëndët e programit të studimit që ndjekin. [Evidenca 110 Programi kompjuterik për menaxhimin e sekretarisë mësimore dhe studentët].</p> <p>Në kuadër të situatës së krijuar nga pandemia globale, stafi i IT-së ka mundësuar akses të plotë online të studentëve për të zhvilluar mësimin në distancë nëpërmjet platformës MS Teams, në funksion të realizimit të programit të studimit dhe provimeve. Ky sistem menaxhohet nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të FIE [Evidenca 90 - Shembull klase virtuale në platformën Microsoft Teams].</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.4


Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Sipas RVB, informacioni lidhur me statistikat vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Mekatronike menaxhohet nga Sekretaria mësimore e FIE. Numri i studentëve të rregjistruar në 3 vitet e fundit është përkatësisht 80, 70, 70 me mesatare hyrëse nëntë.</p> <p>Këto të dhëna ruhen në formë të shkruar (hard copy) dhe në formë elektronike në regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave sipas mënyrës së</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p>përcaktuar në udhëzimet përkatëse të MAS [Evidenca 93 Modeli i Regjistrave në SM]. Ruajtja dhe përpunimi i këtyre të dhënave personale të studentëve kryhet bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale</p> <p>http://www.pp.gov.al/web/ligj_mbrojtja_e_te_dhenave_personale_40.pdf.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sipas RVB, statistikat vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për programin Bsc. Inxhinieri Mekatronike [Evidenca 116 Tabelat e Referencës BCH MEK, Tabela 21] mbahen nga sekretaria mësimore e programit të studimit dhe kryesekretaria e FIE që menaxhon dhe administron të gjithë informacionin e studentëve ndër vite..</p> <p>UPT-ja, në nivel institucioni përmes Sektorit të Statistikes dhe Informacionit [Evidenca 65 Menaxhimi i aktivitetit të sektorit të statistikave] disponon statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të të diplomuarve për çdo program studimi, për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve, të cilat raportohen në raportet vjetore të FIE dhe UPT-së.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Konstatojmë se, informacioni lidhur me ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre për programin e studimit Bsc. Inxhinieri Mekatronike, mbahet nga Sekretaria mësimore e FIE. Këto të dhëna ruhen në formë të shkruar dhe në formë elektronike dhe në regjistrat përkatës, sipas mënyrës së përcaktuar nga udhëzimet e MAS.</p> <p>Sipas RVB, secili pedagog i angazhuar në procesin mësimor në FIE, përgatit në përfundim të vitit akademik, një raport të hollësishëm të lëndëve të zhvilluar prej tij [Evidenca 30 Analizë e procesit mësimor të një lënde]. Ndër të dhënat e raportuara, janë edhe statistika rreth frekuentimit të lëndës, kalueshmërisë së studentëve, vlerësimit mesatar dhe pjesëmarrjes në provim.</p> <p>FIE të gjitha këto statistika i bën pjesë të raportit të analizës mësimore [Evidenca 31 DA - Raporti i procesit mësimor].</p> <p>Sipas RVB, të dhënat për ecurinë e studentëve janë burim i nevojshëm informacioni për ofrimin e shërbimeve të tjera në UPT, në funksion dhe për studentët [Evidenca 79 Vendim i SAUPT për tarifa zero për shërbimet], si përfitimi i bursave të plota apo të pjesshme bazuar mbi meritë, apo i detyrimeve ekonomike për studentët që paraqesin provime të bartura përtej kohëzgjatjes normale të ciklit të studimeve.</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sipas RVB, të dhënat statistikore të studentëve të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit, sistemi i sekretarisë mësimore dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> <p>Ky sistem mund të aksesohet nga studentët përmes portalit të Sekretarisë Mësimore në https://bit-albania.com/. Përmes këtij portalit, studentët mund të informohen për rezultatet e tyre dhe për informacione të tjera të lidhura me aktivitetin mësimor. Portali mundëson dërgimin e mesazheve, njoftimeve dhe, përmes tij, kryhen edhe anketimet semestrale për cilësinë në mësimdhënie. GVJ konstatoi se, të dhënat hidhen në mënyrë automatike përmes skanimit optik të procesverbaleve dhe fletë detyrimeve të plotësuar nga pedagogët. Në këtë mënyrë, dokumentacioni ruhet në hard copy dhe në formë elektronike, duke ofruar siguri të lartë.</p> <p>Sipas RVB, ky sistem, ofron zgjidhje specifike për forma të ndryshme të mësimdhënies, që ofrohen në UPT/FIE dhe lejon përpunimin e thjeshtuar dhe në kohë më të shkurtër të të dhënave [Evidenca 110 Programi kompjuterik për menaxhimin e sekretarisë mësimore dhe studentët].</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike</p>	<p>UPT nëpërmjet NJQSC, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë harton çdo vit raportin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, në të cilin jepet</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>informacion i detajuar mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe në lidhje me punësimin e tyre. Raporti shoqërohet me konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse.</p> <p>Sipas RVB, këto të dhëna përdoren nga DA për të përmirësuar objektivat e programit të studimit në përshtatjen e aktiviteteve didaktike drejt tregut të punës, ashtu edhe në vendosjen e marrëdhënieve të reja të bashkëpunimit me industrinë. Konstatohet se, në masën më të madhe studentët e këtij programi studimi vazhdojnë programet e ciklit të dytë në Inxhinieri Mekatronike. Gjurmimi i punësimit të studentëve evidentohet përmes një regjistri përkatës që mbahet dhe përditësohet nga Specialisti i Karrierës dhe Alumni.</p> <p>Përsa i përket punësimit të studentëve të diplomuar në nivelin Bachelor Mekatronikë përsërisim këtu komentet tona të shprehura në Standartin I.3.</p> <p><u>Kriteri 2.</u></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Konstatohet se pjesëmarrja e studentëve në jetën institucionale të UPT është shumë e rëndësishme. Angazhimi i tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese është sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre si anëtarë (4 studentë) të SA të UPT, të cilët zgjidhen me votim të vetë studentëve [Evidenca 104 Zgjedhjet për autoritetet drejtuese 2020-2024].</p> <p>Sipas RVB, studentët përfaqësohen në vendimmarrje vijuese dhe në organet e tjera të UPT: NJQSC në nivel institucioni (1 student); NJBSC për program studimi (1 student); Këshilli i etikës (ka 1 anëtar përfaqësues të studentëve); Komisioni Institucional Zgjedhor – UPT (1 student); Komisioni i zgjedhjeve në fakultet (1 student); KPS e programit të studimit (1 student); GVB e programit të studimit (1 student) [Evidenca 38 FIE - Procesi akreditimit ngritja e grupeve të GVB]; [Evidenca 87 FIE – Vendim i Dekanit për ngritja e NJSCB]; [Evidenca 26 Vendimi i ngritjes KPS 2020], [Evidenca 121 Studentët në KIZ dhe KZF].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Sipas RVB, Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve në IAL, të cilat nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike. UPT mbështet krijimin e Këshillave Studentorë dhe aktivitetet e organizuara prej tyre, si dhe financon veprimtarinë e tyre [Evidenca1 Statuti i UPT, Neni 51]</p> <p>Konstatohet se, studentët kanë mundësi që nëpërmjet përfaqësuesëve të tyre në organet drejtuese të shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të UPT. Rritja e përfshirjes së studentëve në kërkimin shkencor ka mundur pjesëmarrjen e tyre në konferenca kombëtare e ndërkombëtare.</p> <p>Konstatohet se, studentët janë përfshirë gjithashtu në GVB të programeve të studimit si dhe të vlerësimit institucional [Evidenca 38 FIE Procesi akreditimit ngritja e grupeve të GVB]. Studentët me anë të anketimeve periodike të realizuara në nivel institucional, përfshihen në këshillimet e nevojshme për përmirësimin e cilësisë [Evidenca 33 Sondazhi me studentet 2019-2020 Sem I, Sem II].</p>

	<p>Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilanci vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Sipas RVB, programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Mekatronike është hartuar në përputhje dhe zbatim të bazës ligjore në fuqi. Ngarkesa totale, vjetore, semestrale dhe javore e orëve mësimore në auditor për këtë program studimi, ndarja në orë në auditor dhe për studim të pavarur bazohet në VKM nr. 41, date 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL", i ndryshuar, me VKM nr. 879, datë 18. 12. 2019. Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronikë është i shtrirë në 3 vite akademike pra 6 semestra. Çdo semestër ka 30 kredite dhe një ngarkesë mësimore javore jo më shumë se 25 orë në javë në auditor [Evidenca 116 Tabelat e Referencës BCH MEK, Tabela 10 Plani mësimor, Tabela 13 Ngarkesa totale në auditor e studentëve për format e mësimdhënies në programin e studimit MEK, Tabela 15 Format e kontrollit të njohurive].</p> <p>Sipas RVB, studentët informohen rreth kushteve për kalimin në vitin pasardhës, sikurse është e përcaktuar në nenin 37 të Rregullores të Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, po kështu edhe për kriteret dhe procedurat lidhur me njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e moduleve dhe transferimin e studimeve të plota apo të pjesshme nga një IAL në tjetrin apo brenda institucionit, si edhe studentëve që marrin pjesë në projektet Erasmus + [Evidenca 57 Procedurë për Transferim Studimesh FIE]; [Evidenca 58 Njohje kredite në programin Bsc MEK për transferim brenda vendit]; [Evidenca 59 Njohje kredite për studentë në Erasmus+].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Konstatohet se studentët në UPT janë pjesë përbërëse e KPS-ve të programit të studimit.</p> <p>Sipas RVB, përfaqësuesi i studentëve në KPS bën të mundur transmetimin e të gjitha shqetësimeve dhe problematikat e studentëve në lidhje me programin Inxhinieri Mekatronike, pasi KPS është përgjegjëse për [Evidenca 4 UPT - Rregullore e zhvillimit kurikular dhe mësimdhënies, neni 4 dhe neni 5]: Analizon çdo propozim për ndryshim ose përmirësim të PS; Harton draft propozimin për programet e reja të studimit; Përgatit raportin e analizës vjetore të PS; Analizon format e vlerësimit të studentit dhe i propozon departamentit mënyrat e përmirësimit të tyre; Organizon tërheqjen e mendimit të studentëve për përmirësimin e programit të studimit; Mbështet proceset për sigurimin e cilësisë.</p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezulttit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Sipas RVB, në UPT studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezulttit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e pedagogut përgjegjës dhe DA, sipas të drejtave të sanksionuara në dy dokumenta bazë: Statuti, Kreu VI, Studenti në UPT [Evidenca 1] dhe në Rregulloren Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në nenin 35, 70, Kreu XII, Ankimi [Evidenca 4].</p> <p>Sipas RVB, në FIE dhe në DA, përgjegjëse për këtë program studimi, studentët, informohen nga komisioni i provimit për vlerësimin e tyre përfundimtar të lëndës. Për të qartësuar studentët për vlerësimin por edhe për ti informuar rreth pikave të forta dhe të dobëta që kanë patur në përvetësimin e njohurive të lëndës së vlerësuar, komisioni i provimit cakton një datë informimi/konsultimi me studentët.</p> <p>Konstatohet se, studenti ka të drejtën të ankimohet, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord</p>

	<p>me vlerësimin e bërë [Evidenca 4 UPT - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, neni 35]. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime Drejtuesin e njësisë bazë përkatëse, komisionin e provimit dhe vetë studentin. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos që studenti të rivlerësohet ose të rijapë provimin, me të njëjtin komision, të plotësuar edhe me anëtarë të tjerë.</p> <p>Nëse ankesa e studentit ka lidhje me standardet dhe cilësinë e mësimdhënies, shkeljen e rregullave akademike, probleme të tjera të procesit mësimor, ankimuesit mund t'i drejtohen drejtuesit të njësisë bazë, drejtuesit të njësisë kryesore apo drejtuesit të institucionit në varësi të kompetencës së shkeljes së vërejtur. Studenti mund të drejtohet për ankesë edhe në këshillin e Etikës së UPT, ku studentët kanë edhe përfaqësues të tyre [Evidenca 3 UPT - Kodi i Etikës, neni 6, Detyrimet dhe të drejtat e studentëve].</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
			X	

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Sipas RVB, në UPT, në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve operojnë dy drejtori [Evidenca 75 UPT Organiograma]:</p> <p>1.Drejtorja e Kurrikulave në përbërje të së cilës janë dy sektorë në shërbim të studentëve: Sektori i Kurrikulave dhe Sektori i Procesit Mësimor.</p> <p>2.Drejtorja e Komunikimit dhe Koordinimit që ofron shërbimin e Karrierës dhe ALUMNIT.</p> <p>Procedurat e ndjekura prej këtyre njësive në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve janë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të vetë universitetit.</p> <p>Sipas RVB, FIE ka Zyrën e Sigurimit të Cilësisë, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI-t që të orientojë, inkurajojë dhe mbështesë studentët dhe të diplomuarit me mundësi për zhvillim personal dhe profesional përmes informimit, këshillimit, trajnimit dhe udhëzimit në karrierë.</p> <p>Konstatojmë se, UPT dhe FIE ndjekin politika për përthithjen dhe integrimin e studentëve të rinj, duke organizuar takime informuese për një klimë të ngrohtë dhe bashkëpunuese [Evidenca 48 Aktivitete informuese mbi programet e studimit], [Evidenca 55 Broshura informuese, guida për studentët Guida Studentore].</p> <p>Informimi i vazhduar realizohet edhe nga anëtarët e KPS, drejtuesi i DA dhe dekanati i FIE, jo vetëm për avancimin e tyre akademik por edhe për karrierën e tyre mbas universitare, publikohen edhe në faqen web të FIE dhe të UPT-së [Evidenca 23 Shembuj njoftimi punësimi dhe intershipi], www.upt.al</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që</p>	<p>Sipas RVB, FIE ka si pjesë përbërëse të tij në funksion të informimit, këshillimit, ndjekjes e përparimit të studentëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> •Këshillin e Programit të Studimit [Evidenca 4 UPT - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, neni 4 e 5], •Koordinatorët e programeve të studimit [Evidenca 26 Vendimi i DFIE për ngritjen e KPS dhe Koordinatorëve] •Sekretaria mësimore e FIE

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>•Zyra e Sigurimit të Cilësisë, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI në FIE [Evidenca 6 Rregullore e brendshme e FIE].</p> <p>Të gjitha strukturat e FIE që kanë lidhje direkt me informimin e studentëve, si zyrat e karrierës, sekretariatë mësimore dhe zyrat e financës kanë të publikuara oraret e pritjes së studentëve me qëllim plotësimin e nevojave të studentëve.</p> <p>GVJ konstaton se, Departamenti i Automatikës ofron kujdestarinë akademike për studentët e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronikë gjatë gjithë periudhës së studimeve. Në këtë kuadër DA ofron konsultime sipas orareve të miratuara nga çdo pedagog i tij për studentët me vështirësi në përvetësimin e njohurive si edhe këshillim dhe konsultime në lidhje me provimin e diplomës [Evidenca 54 DA - Rregullore e provimit dhe Materialet orientuese për provimin e formimit BCH MEK].</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Sipas RVB, në UPT është ngritur Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit e përbërë nga dy sektorë, ai i Koordinimit dhe Partneritetit dhe ai Komunikimit me Publikun, ku bëjnë pjesë Specialistët për Këshillimin e Karrierës dhe ALUMNI, si zyra të ngritura pranë çdo njësie kryesore në UPT.</p> <p>Këto funksionojnë në shërbim të këshillimit akademik të studentit, në kuadër të politikave për zgjerimin e hapësirave dhe mundësive ndërvepruese të studentëve, si pjesë përbërëse e mobilitetit rinor dhe monitorojnë zhvillimin e karrierës akademike të studentëve [Evidenca 125 Procedura për mobilitete Erasmus+]; [Evidenca 48 Aktivitete informuese për programet e studimit]..</p> <p>Konstatojmë se, UPT ofron shërbime me pikësynim integrimin optimal të të diplomuarve të tij në tregun e punës dhe ndërmerr nisma, që synojnë krijimin e vendeve të reja për punë të kualifikuar. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMN-it e FIE shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, duke krijuar kontaktet e duhura me punëdhënësit potencial, me qëllim promovimin e studentëve dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit.</p> <p>GVJ konstaton se, UPT mbështet aktivisht zhvillimin e aftësive praktike të studentëve, me fokus në zhvillimin efikas të praktikave profesionale për ta. Ai nxit dhe mbështet krijimtarinë e studentëve, në partneritet të plotë me biznesin dhe mbi bazën e shanseve të barabarta dhe zgjerimin e intership-it. UPT është gjithmonë i hapur për aktivitete të përbashkëta me industrinë [Evidenca 23 Shembuj njoftimi punësimi dhe intershipi].</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra për Këshillimin e Karrierës dhe ALUMNI e FIE përmes njoftimeve në web dhe materialeve informuese të afishuara në mjediset e tij njofton vazhdimisht studentët për mundësi për aplikime në lidhje me punësimin e tyre http://upt.al/bashkepuni/aktivitete dhe i këshillon studentët e diplomuar për mënyrën e prezantimit të parë tek punëdhënësi (CV, letërmotivuese, intervistë, etj) [Evidenca 6 Rregullore e brendshme e FIE, neni 38].</p> <p>Kjo zyrë këshillon studentët edhe për vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë të studimeve në lidhje me drejtimet që mund të marrin për plotësimin e njohurive të tyre drejt profesionit që dëshirojnë.</p> <p>Konstatojmë se pjesa më e madhe e studentëve (mbi 90%) të cilët përfundojnë programin e studimit Bsc. Inxhinieri Mekatronike ndjekin një program studimi të ciklit të dytë të ofruar nga DA, Master Profesional ose Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike ose në Inxhinieri Elektrike, profili Automatizimi i Industrisë [Evidenca 116 - Tabelat e Referencës BCH MEK].</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës V	Përbushet pjesërisht		Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR



Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Sipas RVB, UPT ka hartuar politika [Evidenca 2 UPT - Plani strategjik 2019-2024] dhe ka ngritur struktura [Evidenca 1 Statuti i UPT Kreu IX, neni 78] në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke ofruar shërbime sipas standardeve europiane, mbështetur në Ligjin nr.80/2015. Rrjeti i cilësisë përbëhet:</p> <p>Njësia Qendrore e Sigurimit të Cilësisë (NJQSC), në Rektoratin e UPT dhe Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në çdo njësi kryesore të UPT.</p> <p>Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë DSBC dhe Drejtoria e Kurrikulave DK, nëpërmjet FIE, koordinojnë punën me departamentet e FIE për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Pranë FIE është ngritur NJSBC [Evidenca 6 Rregullore e brendshme e FIE, neni 38]; [Evidenca 87 Vendim i Dekanit për ngritjen e NJSBC në FIE].</p> <p>Konstatojmë se, DSBC ka miratuar pyetesorët për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UPT [Evidenca 33 Sondazhi me studentët sem I, sem II 2019-2020], në të cilën përshkruhet procedura e përmirësimit të programeve të studimit, duke filluar që prej analizmit të rezultateve të pyetësorëve deri në planin e masave që propozohet për përmirësim.</p> <p>Sipas RVB, UPT për sigurimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së programeve të studimit të ofruara ka në strukturë edhe Drejtorinë e Kurrikulave, që merret me përputhshmërinë e planeve mësimore dhe sugjerimet e nevojshme për përmirësim në vazhdim të diktuar nga ndryshimet e akteve ligjore dhe nën ligjore. Miratimi i përvitshëm i planeve mësimore, pasi ndjek të gjithë strukturën e miratimit në nivel njësie bazë dhe asaj kryesore, merr edhe kontrollin cilësor të kësaj drejtorie https://www.upt.al/dega-mesimore</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Sipas RVB, NJQSC harton standardet institucionale të cilësisë bazuar në Kodin e proceseve vlerësuese [Evidenca 19 Agjenda e ASCAL]. Këto standarde miratohen nga SAUPT, ku janë edhe 4 studentë si anëtarë të tij. UPT zhvillon dhe zbaton mekanizma për promovimin dhe zotërimin e një kulture të cilësisë në të gjitha njësitë dhe të gjitha nivelet, me synim rritjen e cilësisë në të gjitha programet e studimit që ofron [Evidenca 2 UPT - Plani strategjik 2019-2024, Kreu IV.1].</p> <p>Sigurimi i cilësisë në UPT dhe në të gjitha njësitë përbërëse nuk është vetëm në aspektet e lidhura me mësimdhënien, por në të gjithë aktivitetin dhe rolin e tij në shoqërinë e vendit si ambient social, shoqëror, akademik dhe kërkimor shkencor. Për këtë, është i ngritur dhe funksional Këshilli i Etikës në UPT i cili është garanti për zbatimin e kodit të etikës si një ndër përbërësit kyç të rritjes së cilësisë [Evidenca 3 UPT - Kodi i Etikës].</p>

	<p>Konstatohet se, DA e FIE operojnë në koherencë të plotë me procedurat e UPT, në të cilat garantohet dhe përfshirja e stafit dhe studentëve. Kështu në vlerësimin e brendshëm krahas stafit akademik përfshihen dhe studentët si pjesë e rëndësishme e këtyre proceseve [Evidenca 38 FIE - Procesi akreditimit ngritja e grupeve të GVB].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>GVJ konstaton se, në vlerësimin e jashtëm një rol të rëndësishëm ka luajtur bashkëpunimi me ASCAL dhe specialistët e tij për kryerjen me sukses të procesit të akreditimit. Mirëfunksionimi i sistemit të brendshëm të cilësisë është vlerësuar edhe nga ASCAL, e cila me vendimin e BA nr. 01, datë 07.01.2022 vendosi akreditimin e UPT me kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vite [Evidenca 14 UPT - Vendimi i BA për akreditimin].</p> <p>Një nga objektivat e planit strategjik [Evidenca 5 FIE - Strategjia e 2018-2023], [Evidenca 7 DA - Strategjia 2018-2023] është edhe rritja e cilësisë së stafit akademik, për këtë FIE e UPT i motivon për avancimin e tyre me mbështetje për pjesëmarrje në konferenca shkencore dhe botime [Evidenca 56 FIE - Praktike mbështetje financiare për botime shkencore në DA], shkëmbime me institucionet partnere [Evidenca 36 Lista e mobiliteteve stafit Erasmus +]. FIE është duke organizuar Konferencën ndërkombëtare “Energjitë e Rinovueshme dhe Teknologjitë Smart”, që do të mbahet në ambientet e këtij fakulteti https://ic-rest.org/.</p> <p>Duke ju referuar edhe RVB, të gjitha këto janë aktivitete në funksion të rritjes së vazhdueshme të cilësisë, ato raportohen [Evidenca 63 DA - Raporti i analizës së punës kërkimore-shkencore 2020-2021], bëhen pjesë e analizës dhe diskutimeve [Evidenca 62 FIE - Raporti i analizës së punës kërkimore-shkencore 2020-2021] dhe në mënyrë periodike paraqiten në Drejtorinë e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve në UPT.</p> <p>UPT ju nënshtrua në muajt Prill-Maj 2022 dhe vlerësimit nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve, rezultatet e të cilit priten të dalin së shpejti dhe të bëhen publike prej ASCAL https://www.ascal.al/sq/sondazhi-kombetar-i-studenteve/metodologjia-dhe-instrumentat/sks-2022.</p> <p>Konstatohet se, këto raporte përfshihen në mënyrë periodike si në vlerësimin institucional dhe në atë të programeve të studimit duke u bërë kështu, materiale sasiore dhe cilësore të vlerësueshme nga palë të treta si GVJ e BA në ASCAL https://www.ascal.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-07-janar-2022.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Sipas RVB, UPT ka hartuar një sërë procedurash dhe akte rregullatore të brendshme të unifikuara, në kuadër të rritjes së cilësisë, për të garantuar që procedurat e ndjekura për avancimin akademik, rekrutimin e stafit, hartimin apo modifikimin e planeve mësimore dhe aktivitetet të ndryshme në njësitë kryesore dhe ato bazë, të jenë procedura të qarta dhe uniforme në nivel institucioni. UPT ka hartuar:</p> <p>Rregullore për fitimin e titujve akademik, Rregullore e komisionit për promovimin e personelit akademik në UPT, Rregulloren e këshillit të profesorëve në UPT, për dhënien e gradës shkencore “Doktor”, Rregulloren e shkollës së doktoratës në UPT.</p> <p>Konstatohet se këto rregullore janë publike në faqen zyrtare të UPT në rubrikën legjisacion. Kjo garanton rritjen e transparencës dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara si për studentët ashtu edhe për palët e treta të interesuara, https://www.upt.al/2014-11-05-10-00-43.</p> <p>Sipas RVB, në funksion të rritjes së cilësisë, përveç vetëvlerësimit periodik apo vlerësimeve periodike të drejtorive të ndryshme, janë edhe rekomandimet e lëna nga vlerësimet e jashtme si në nivel institucioni ashtu edhe në nivel programi studimi. Për këtë qëllim, bazuar edhe në akreditimin institucional të vitit 2017, në UPT u hartua një plan veprimi për përmirësimin e rekomandimeve [Evidenca</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	108 Plotësimi i rekomandimit për akreditimin institucional - ekstrakt RVB UPT], të cilat më pas janë vlerësuar pozitivisht nga ASCAL dhe BA.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2



Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	<p>Sipas RVB, UPT me qëllim monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë, ka në strukturën e vet Drejtorinë e Kurrikulave [Evidenca 75 UPT Organiograma] https://upt.al/dega-mesimore</p> <p>Në UPT kjo kryhet sipas një procedure të mirëpërcaktuar, të pasqyruar në rregulloret e institucionit, njësive kryesore dhe njësive bazë.</p> <p>Në UPT, për të patur një menaxhim më të mirë të procesit të hapjes dhe riorganizimit të programeve të studimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të tyre, pranë departamenteve janë ngritur Këshillat e Programeve të Studimit (KPS) për çdo program studimi që është nën përgjegjësinë e departamentit si dhe janë caktuar koordinatorët e programeve të studimit [Evidenca 26 Vendimi i Dekanit të FIE për ngritjen e KPS dhe Koordinatorëve].</p> <p>Në përbërjen e KPS Bsc. në Inxhinieri Mekatronike të ofruar në DA, janë të përfshirë personel akademik me përvojë së paku 10 vjeçare në mësimdhënie. Këto këshilla shqyrtojnë në mënyrë periodike dokumentacionin e plotë të një programi studimi duke përfshirë planin mësimor dhe syllabuset përkatëse si dhe njëkohësisht analizojnë edhe raporte e zhvillimit të aktiviteteve didaktike të hartuara nga secili pedagog i angazhuar në këtë program [Evidenca 31 DA-Raporti i procesit mësimor]. Pjesë e rishikimit janë edhe mbledhjet e DA, të cilat analizojnë edhe gjetjet e pyetësorëve studentorë të hartuara në nivel institucional [Evidenca 33 Sondazhi me studentet 2019-2020 Sem I, Sem II]. Drejtoria e Kurrikulave e Rektoratit, verifikon përputhshmërinë e programit të studimit të rishikuar me standartet e cilësisë, harton një raport teknik në lidhje me mangësitë e konstatuara dhe ia përcjell SA për shqyrtim e miratim. Komisioni i Mësimi i SA analizon dosjen dhe raportin, SA në fund shprehet me vendim për miratimin ose jo të ndryshimeve të propozuara [Evidenca 29 Procedurë për hapjen e programit të studimit].</p>
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	<p>Sipas RVB, KPS ka si funksion rishikimin e programit të studimit, mbështetur në nevojat e tregut të punës, zhvillimet në rajon dhe në botë, tendencat e zhvillimit të programeve të studimit të ngjashme në Europë e më tej, propozimet për përmirësim të ardhur nga mësimdhënësit, analizën e procesit mësimor [Evidenca 32 FIE - Raporti i procesit mësimor] [Evidenca 31 DA - Raporti i procesit mësimor] në nivel njësish dhe universiteti, anketimet e studentëve [Evidenca 33 Sondazhi me studentet 2019-2020 Sem I, Sem II], ndryshimet në infrastrukturën laboratorike, rezultatet e projekteve të ndryshme të mbështetura nga BE ose nga vende të tjera të lidhura me zhvillim kurrikular në Shqipëri, kërkesa të ardhura nga biznesi ose qeveria si përgjigje e kërkesave të tregut të punës, etj. Gjatë analizës për rishikim të programit të studimit, KPS mund të arrijë në përfundimin e kryerjes së një riorganizimi të plotë të tij, ose përmirësime të elementëve të programit të studimit, të cilat nuk e kalojnë masën e ndryshimit 20% të tij të shprehur në kredite.</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Në nivel njësie bazë dhe asaj kryesore, vlerësimi i brendshëm i cilësisë për këtë program studimi, vlerësohet edhe nëpërmjet hartimit të RVB.</p> <p>Procesi i propozimit të përmirësimit dhe i miratimit kalon në disa hallka: Hartimi i draftit të rishikimit të programit të studimit nga grupi nismëtar nën drejtimin e KPS. Diskutimi i draftit të ndryshimeve në departament dhe në dekanat. Dekanati shprehet me vendim dhe përcjell në rektorat dosjen, dhe argumentimin e dekanatit për riorganizimin e këtij PS, në përputhje me procedurat administrative të UPT.</p> <p><u>Konstatohet se, miratimi i propozimit për hapjen/ riorganizimin e programit të ri të studimit nuk shqyrtohet në NJSBC.</u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Sipas RVB, analiza e procesit mësimor bëhet në përfundim të vitit akademik [Evidenca 32 FIE - Raporti i procesit mësimor] dhe është objekt analize në Departament, Fakultet dhe në SA.</p> <p>Çdo mësimdhënës [Evidenca 30 Analiza e procesit mësimor të një lënde], në përfundim të procesit mësimor shprehet për problematikat që ka hasur dhe mund të propozojë ndryshime në elementë të programit të lëndës, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të saj.</p> <p>KPS analizon të gjitha elementët e realizimit të tij, për këtë mbështetet në sugjerimet dhe komentet e stafit mësimdhënës, në anketimet e studentëve, si dhe në të dhëna të shumta që gjenerohen nga sekretariatë mësimore.</p> <p>Departamenti shqyrton raportet e hartuara nga KPS për të gjitha programet e studimit që mbulon dhe përcjell në dekanat raportin e analizës mësimore të departamentit.</p> <p>Dekanati harton raportin e analizës mësimore të fakultetit, të cilën e përcjell në Rektorat mbështetur në këto raporte.</p> <p>SA harton raportin e punës mësimore të UPT, të cilën e miraton në një mbledhje të tij. Ky raport se bashku me analizën e punës kërkimore dhe atë financiare përcillen në MAS.</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Sipas RVB, personeli akademik i nënshtrohet vlerësimit periodik për të garantuar cilësinë në mësimdhënie dhe përmirësimin e vazhdueshëm të saj, duke realizuar kontrole periodike të procesit të mësimdhënies, sidomos për stafin e ri akademik.</p> <p>Gjithashtu DSBC organizon në mënyrë periodike pyetësorë adresuar studentëve për vlerësimin e pedagogut të hartuar në mënyrë të tillë që të përfshijnë të gjithë indikatorët e mësimdhënies [Evidenca 4 UPT - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT].</p> <p>Raportet studentore të organizuar në nivel institucional, përpunohen nga sektori i Statistikës dhe Informacionit konform rregullores së brendshme. Të dhënat e këtij raporti i përcillen njësisë kryesore e më pas atyre bazë për informim dhe përmirësim të mëtejshëm të aktivitetëve të tyre [Evidenca 33 - Sondazhi me studentet 2019-2020 Sem I, Sem II].</p> <p>Këto metoda vlerësimi janë transparente dhe i bëhen me dije individualisht çdo pedagogu.</p> <p><u>Përsërisim këtu komentet tona për shtimin e vlerësimeve, të paraqitura në Standartin III.1, Kriteri 2.</u></p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Konstatohet se raporti i rezultateve të pyetësorëve si dhe rekomandimet e përpiluara prej NJSBC-së ju përcillen Njësisë Kryesore të cilat realizojnë më tej një diskutim të gjerë në çdo departament me stafin akademik.</p> <p>Këto raporte bëhen publike në faqen web të UPT https://upt.al/cilesia-ne-upt</p> <p>Bazuar mbi raportet e anketimeve, por edhe ato të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm institucional apo për programe studimi, hartohen planet e veprimit për arritjen e objektivave për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë [Evidenca 108 Plotësimi i rekomandimit për akreditimin institucional - ekstrakt RVB]</p>

	Megjithëse ka përpjekje pozitive, transparenca dhe gjithëpërfshirja kërkojnë një angazhim të drejtëpërdrejtë në informimin e studenteve dhe pedagogëve, debat të hapur dhe diskutim me ata. Pavarësisht kësaj njësitë kryesore diskutojnë rezultatet respektive duke dhënë propozime përkatëse, të cilat më pas diskutohen në mbledhjen e Rektoratit.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>GVJ konstaton se, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC), në përputhje me Statutin e UPT [Evidenca 1 Statuti i UPT Kreu IX], është përgjegjëse për organizimin e vlerësimeve të brendshme të programeve të studimit dhe atij institucional. DSBC përcakton mënyrën e organizimit të vlerësimit të brendshëm, aktivitetet që kryhen, përgjegjësitë dhe mënyra e paraqitjes së rezultateve.</p> <p>Sipas RVB, vlerësimi i brendshëm i programeve të studimit dhe kërkimit shkencor apo institucional, realizohet në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe me udhëzimet përkatëse të ASCAL dhe organizohet si rregull një herë në tre vjet. Nëse është e nevojshme, mund të organizohen vlerësime të pjesshme apo të plota edhe më shpesh.</p> <p>Grupi i vlerësimit të brendshëm (GVB) ngrihet nga Dekani i FIE, që mbulon programin e studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike. GVB gëzon autonomi funksionale dhe ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit.</p> <p>Përfundimet e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit bëhen pjesë e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm institucional periodik.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Konstatohet se, referuar natyrës së programit të studimit vlerësimi kryesor kryhet përmes analizës mësimore që bëhet çdo fund viti akademik në nivel stafi, departamenti dhe fakulteti.</p> <p>Sipas RVB, NJSBC përpilon raportin e analizës së pyetësorëve i cili ka për qëllim matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikën më të mira [Evidenca 1 Statuti i UPT. Të dhënat e pasqyruara në këtë raport shërbejnë si një instrument i rëndësishëm për njësitë kryesore/bazë për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore aty ku shihet e nevojshme.</p> <p>Referuar natyrës dhe specifikës së kërkimit (vlerësimi i cilësisë së programeve akademike), për kryerjen e vlerësimit, UPT ka përdorur metodën sasiore dhe cilësore si një metodë e përshtatshme dhe instrumenti i përdorur është pyetësori. [Evidenca 33 Sondazhi me studentet 2019-2020 Sem I, Sem II].</p> <p>Pjesë e metodikës është edhe gjurmimi i ALUMNI i realizuar edhe në projektin GRADUA ku UPT është anëtar [Evidenca 22 Projekti GRADUA].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtëpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të</p>	<p>Konstatohet se, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Mekatronike, janë përdorur disa metoda të drejtëpërdrejta, duke konsistuar në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit si dhe vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në nivel njësie bazë Drejtuesi informohet në mënyrë të vazhduar nga i gjithë stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi rreth procesit të mësimdhënies dhe ushtron kontroll rreth zbatimit të tij. Rezultatet pasqyrohen në analizat periodike të njësisë bazë. Drejtuesi i DA përgjigjet në Dekanatin e FIE për mbarëvajtjen e procesit mësimor për programet e studimit që mbulon, por edhe për lëndë të veçanta që mbulohe në njësi të tjera bazë në UPT.</p> <p>Në fillim të vitit akademik Drejtuesi i njësisë bazë në bashkëpunim me stafin akademik kontrollon dhe vlerëson përmbajtjen e syllabuseve. Syllabuset diskutohen në department, por aprovohen nga titullari i lëndës.</p> <p>Sipas RVB, Drejtuesit e njësisë bazë realizojnë vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së leksioneve/seminareve etj, praktikë që verifikon kryerjen e procesit të mësimdhënies nga pikpamja sasiore (orët leksion, seminare, laboratore) [Evidenca 6 Rregullore e brendshme e FIE, neni 21]. Drejtuesi i njësisë bazë nuk disponon asnjë praktikë ligjore të miratuar nga Senati për grumbullim të dhënash cilësore.</p> <p>Në nivel njësie kryesore Dekani me anë të Zv. Dekanit për anën mësimore dhe sekretarisë mësimore, mbikëqyr zhvillimin e aktiviteteve didaktike konform strukturës mësimore [Evidenca 60 UPT - Struktura mësimore 2021-2022] dhe orarit mësimor të miratuar [Evidenca 51 FIE - Orari i Mësimit dhe Orari i Provimeve BCH], http://www.fie.upt.al/Orari_i_mesimeve.php.</p> <p>Ndjek dhe monitoron cilësinë e zbatimit të kurrikulës së programit të studimit në përputhje me planin mësimor. Përpunon të dhënat e nxjerra nga analizat mësimore të njësisë bazë përgjegjëse dhe i raporton ato në Rektorat.</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Sipas RVB, UPT përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista me studentët aktualë, me ato të diplomuar (ALUMNI), me personelin akademik, ndihmës akademik e administrativ.</p> <p>UPT disponon të dhëna, për punësimin e studentëve të vet, me të cilët mban kontakte të vazhdueshme. Për ngritjen e rrjetit Alumni ka filluar puna përmes një pyetësori. Është krijuar një databazë me të diplomuar.</p> <p>Me qëllim forcimin e lidhjeve dhe krijimin e një rrjeti me të diplomuarit në fushat që mbulon, edhe FIE përmes Specialistit të keshimës dhe Alumnit ka krijuar dhe përditëson rregjistrin e vet të alumni me qëllim ndjekjen e studentit nga fillimi i studimeve deri në punësim.</p> <p>UPT / FIE nëpërmjet pjesëmarrjes në projektin GRADUA, ka krijuar një databazë të rëndësishme të studentëve dhe kompanive. Studentët regjistrohen dhe publikojnë CV në këtë databazë, duke rritur kështu mundësinë e punësimit. Kompanitë e ndryshme në bazë të kriterëve të tyre përzgjedhin drejtpërdrejtë studentët e regjistruar në sistemin GRADUA.</p> <p>Një nga format që UPT përdor për të favorizuar punësimin e studentëve është edhe punësimi brenda Universitetit. Ish studentë ekselentë të UPT punësohen si personel akademik efektiv dhe me kontratë, kur ata plotësojnë kriteret e punësimit të stafit akademik si dhe si staf akademik ndihmës dhe administrativ</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VL4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB, në Statutin e UPT-së, Rregulloren e FIE, në Planin Strategjik 2019-2024 të UPT [Evidenca 2 Plani Strategjik i UPT 2019-2024, Kreu III], miratuar me vendim të BA nr. 28, datë 01.11.2019 parashikohet përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Njëkohësisht në këto dokumente përcaktohen qartë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor apo vlerësimin e brendshëm institucional, ngrihet GVB, ku merr pjesë edhe një përfaqësues nga organizata studentore. Në rast nevojë, ftohet një përfaqësues ekspert i jashtëm.</p> <p>Në UPT, pedagogët janë jo vetëm realizues të procesit mësimor, por edhe si një faktor i rëndësishëm për rritjen e nivelit të cilësisë duke u angazhuar në përpunimin e rregulloreve dhe standardeve të ndryshme të cilësisë.</p> <p>Konstatohet se, UPT bazuar edhe në politikat institucionale të rritjes së bashkëpunimit dhe ndërkombëtarizimit, merr pjesë me njësitë e saj përbërëse në disa projekte ndërkombëtare [Evidenca 35 Projekte institucionale UPT] dhe përmirëson shërbimet e ofruara për tu përshtatur edhe me ato të institucioneve partnere ndërkombëtare. [Evidenca 34 Lista e marrëveshjeve aktive bashkëpunuese UPT me universitete brenda e jashtë vendit].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Konstatohet se, përfaqësimi i studentëve është instrument i rëndësishëm që realizohet në mënyra të ndryshme, si tërheqja e mendimit nga këshilltarët akademikë, përfaqësimin e tyre në senat dhe në organe të tjera vendimmarrëse të institucionit [Evidenca 1 Statuti i UPT, neni 49 & 51], që është sanksionuar edhe në rregulloren specifike për organizimin e zgjedhjeve.</p> <p>Studentët janë pjesëmarrës edhe në NJQSC/NJSC dhe në KPS [Evidenca 26 Vendimi i DFIE për ngritjen e KPS dhe Koordinatorëve].</p> <p>Sipas RVB, funksionet dhe detyrat e KPS si edhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët, pedagogët dhe palë të tjera të angazhuara për garantimin e cilësisë së programit të studimit përcaktohen në Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies [Evidenca 4 UPT - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, neni 4 & 5 & 6], në Rregulloren e FIE si dhe në Rregulloren e Departamentit të Automatikës përgjegjës këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB, në procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, në UPT ndiqet një strukturë hierarkike e vlerësimit dhe analizës së raporteve të hartuara.</p> <p>Konstatohet se për monitorimin në vijimësi të PS janë ngritur dhe funksionojnë KPS për çdo program studimi [Evidenca 26 Vendimi i DFIE për ngritjen e KPS dhe Koordinatorëve]. Ndërsa për vlerësimin e sigurimit të cilësisë në PS janë ngritur GVB, të cilët në përbërje të tyre kanë përveç stafit akademik edhe staf ndihmës akademik, administrativ dhe student për çdo PS [Evidenca 38 FIE - Procesi akreditimit ngritja e grupeve të GVB].</p> <p>Një tjetër tregues që dëshmon përfshirjen e studentëve është pyetësori i organizuar prej NJQSC-së në fund të çdo semestri për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për çdo lëndë [Evidenca 33 Sondazhi me studentet 2019-2020 Sem I, Sem II]. Në këtë proces studentët përfshihen jo vetëm në plotësimin e pyetësorit por edhe si aktorë aktiv në procesin e ngritjes së kulturës së cilësisë duke i angazhuar në fushatat informuese dhe promovuese mbi rëndësinë e përfshirjes së studentëve në politikat e vlerësimit të UPT-së, duke marrë pjesë aktivisht në plotësimin e pyetësorëve të studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, Sondazhin Kombëtar, etj.</p>



<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë është një proces gjithë përfshirës, me angazhimin e stafit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe pa dyshim studentët.</p> <p>Sipas RVB, gjatë implementimit të instrumentave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të përdorur prej strukturave përkatëse me qëllim vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit është respektuar liria dhe etika akademike si dhe Ligji nr. 9887 datë 10.03.20008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.</p> <p>Edhe në ngritjen e GVB, stafi akademik është i përfaqësuar në mënyrë jo diskriminuese si në bazë gjinie, ashtu edhe grade apo kualifikimi akademik [Evidenca 38 FIE - Procesi akreditimit ngritja e grupeve të GVB].</p> <p>Plotësimi i anketimeve studentore, është i barabartë për të gjithë studentët, pavarësisht gjinisë, prejardhjes, ecurinë akademike etj. Hartimi i pyetësorit studentor realizohet nga DSBC, është objektiv dhe adreson nevoja dhe tematika objektive të nevojshme për tu monitoruar në funksion të përmirësimit të cilësisë. GVJ konstaton se, në FIE nuk ka asnjë praktikë ankimi nga ana e studentëve apo stafit akademik dhe administrativ në shërbim të tyre për diskriminim dhe pabarazi.</p>		
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Sipas RVB, në vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë, në FIE dhe njësitë bazë përbërëse, si pjesë integruese e vlerësimit janë edhe ekspertë nga tregu i punës, ku një pjesë përfaqësuese janë të angazhuar si staf akademik i jashtëm.</p> <p>Konstatojmë se, zhvillimi i praktikave mësimore pranë kompanive partnere shërben për vlerësimin cilësor të programit të studimit. Vlerësimi është i dyanshëm, nga kompanitë [Evidenca 46 FIE – Formular miratimi i praktikës mësimore] të cilat vlerësojnë aftësitë personale të studentëve dhe ato të programit të studimit ku janë formuar dhe nga FIE [Evidenca 47 FIE – Relacioni studentit i praktikës mësimore], vlerësohet përputhshmëria dhe cilësia e praktikave mësimore të ofruara nga kompanitë, por edhe përputhshmëria e formimit të programit të studimit në lidhje me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Pjesë aktive e procesit të vlerësimit cilësor të programit të studimit është edhe prania e ekspertëve të fushës, të cilët me orët e hapura që zhvillojnë me studentët, bëhen pjesë e rritjes cilësore të njohurive të ofruara.</p> <p>Një burim i rëndësishëm informacioni rreth përputhshmërisë së tregut të punës me dijet e ofruara në këtë program studimi janë edhe ish studentët e diplomuar, të cilët tashmë janë pjesë aktive e këtij tregu.</p> <p>Sipas RVB, pjesë e vlerësimit gjithë përfshirës është edhe analiza e përputhshmërisë së planit mësimor dhe syllabuseve përkatëse me atë të ofruar në IAL të ngjashme jashtë vendit. Programe studimi të ngjashme (Torino, Milano), www.polimi.it, www.polito.it.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të</p>	<p>Sipas RVB, UPT, i bën transparente dhe publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit, politikën, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për të gjitha programet e studimit, nëpërmjet postimit në</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>faqen zyrtare elektronike http://upt.al/ (Statuti, Vendime të SA, Vendime të BA, Raportet e analizës së rezultateve të pyetësorëve të anketimit të studentëve, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë, etj) si dhe nëpërmjet shkresave zyrtare tek të gjitha njësitë kryesore, njësitë bazë, duke krijuar kështu një universitet të hapur e transparent me të gjithë aktorët e brendshëm e të jashtëm të tij.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Sipas RVB, NJQSBC, harton në mënyrë periodike raporte të vlerësimit të brendshëm, të cilat ruhen në arkivën institucionale konform akteve rregullatore në fuqi.</p> <p>Konstatohet se në zbatim të VKM nr.531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë” (VKM nr. 824, date 24.12.2021), është përpiluar Raporti i Analizës së Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për çdo Lëndë të çdo Programi Studimi [Evidenca 33 - Sondazhi me studentet 2019-2020 Sem I, Sem II].</p> <p>Vërejmë se këto raporte publikohen online në web-in e UPT https://upt.al/cilesia-ne-upt . Informacioni i publikuar në raport respekton lirinë dhe etikën akademike si dhe Ligjin nr. 9887, datë 10.03.20008, ndryshuar me Ligjin nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Sipas RVB, prej vitit 2018, Drejtoria e SBC ka kryer rregullisht edhe anketimin semestral studentor mbi cilësinë në mësimdhënie. Pyetësi i hartuar plotësohet nga studentët për çdo pedagog duke dhënë indikatorë të perceptimit të performancës nga studenti. Rezultatet e pyetësorit i përcillen Rektorit së bashku me një analizë statistikore mbi indikatorët.</p> <p>Ndërkohë, përmes rezultateve individuale të personelit akademik, hartohen analiza për të evidentuar pikat e forta dhe problematikat specifike në çdo program studimi. Këto analiza përmbledhen në trajtë raporti dhe i përcillen njësisë kryesore dhe atyre bazë për të zhvilluar analiza të mëtejshme e për të vijuar punën mbi përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Raportet janë publike dhe të aksesueshme online [Evidenca 33 Sondazhi me studentet 2019-2020 Sem I, Sem II], https://upt.al/cilesia-ne-upt .</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB, Departamenti i Automatikës përgjegjës për programin Inxhinieri Mekatronike dhe FIE në UPT, vlerësojnë në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore. Raportet e hartuara evidentojnë arritjet në procesin mësimor e kërkimor gjatë një viti akademik, si dhe problematikat që shfaqen në elementë të caktuar përbërës të tyre.</p> <p>Bazuar tek nevojat për përmirësim, të identifikuar në këto analiza, DA, përpara fillimit të vitit akademik, propozon ndryshimet në planin mësimor.</p> <p>Sipas RVB, për të patur një menaxhim më të mirë të procesit të hapjes dhe riorganizimit të programit të studimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të tyre, pranë departamenteve janë ngritur Këshillat për çdo program studimi që ofron dhe janë caktuar koordinatorët e programeve të studimit [Evidenca 26 - Vendimi i DFIE për ngritjen e KPS dhe Koordinatorëve]. Një nga funksionet kryesore të KPS është rishikimi i programit të studimit.</p> <p><u>Konstatohet se, në programin e studimit Bsc. Inxhinieri Mekatronike nuk ka pasur ndryshim të kurrikulës në tre vitet e fundit akademike [Evidenca 24 - Plani mësimor i programit të studimit BCH MEK].</u></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB, me qëllim ngritjen e kulturës së cilësisë UPT organizon aktivitetet dhe seminareve informuese me studentët, me qëllim ndërgjegjësimin e studentëve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në institucion (si për shembull plotësimi i pyetësorëve, pjesëmarrja në Sondazhin Kombëtar të Studentëve etj).</p> <p>Konstatohet se, Koordinatorët e PS në mënyrë periodike organizojnë takime me studentët si për ti informuar ata rreth akteve rregullatore institucionale,</p>

	ashtu edhe për të dëgjuar mendimin e tyre, e më pas për ta përcjellë atë në njësinë bazë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të Jashtëm të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Politeknik i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike FIE, në përbërje të UPT, ka traditë akademike shkencore shumë vjeçare në përgatitjen e specialistëve, inxhinierëve dhe shkencëtarëve në fushat përkatëse, gjë që paraqet avantazh edhe për fushën e Mekatronikës.
2. Pedagogët e programit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike kanë një kualifikim të lartë tekniko-shkencor e praktik.
3. Rrjeti i gjerë i laboratoreve (kryesisht të karakterit didaktik) mbulojnë në masë të madhe zhvillimin e laboratoreve për lëndët me karakter aplikativ.
4. Studimet në inxhinieri mekatronike ofrohen në 2 (dy) ciklet e studimit: Bachelor dhe Master. Kjo mundëson një perspektivë të qartë dhe të qëndrueshme për të gjithë studentët që dëshirojnë të ndjekin studimet në këtë program.
5. Marrëveshjet dhe bashkëpunimet me institucionet publike, si dhe me kompanitë private, bëjnë të mundur jo vetëm realizimin e praktikave profesionale, por edhe rritjen e mundësive të punësimit të studentëve në përfundim të studimeve.
6. FIE ka kapacitete humane të kualifikuara që mbulojnë një spektër të gjerë të kërkimit shkencor në fusha të ndryshme të automatizimit dhe robotikës.
7. UPT dhe FIE kanë lidhje të konsoliduar me shumë universitete europiane, për projekte të përbashkëta, diploma dhe studime të doktoratës.
8. Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike vazhdon të ketë një numër të kënaqshëm të regjistrimeve të studentëve.
9. Vitet e fundit është rritur interesi për punësimin e inxhinierëve mekatronikë.

Pika të dobta:

1. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe programet e tij të studimit kanë financim të pamjaftueshëm, si pjesë e institucioneve publike të arsimit të lartë. **(Standarti III.2, kriteri 3)**

2. Punësimi i specialistëve, të diplomuar në nivelin Bachelor në Inxhinieri Mekatronike, është shumë i pakët dhe shumica dërmuese e tyre preferon të vazhdojë studimet në nivelin Master. **(Standarti I.3, kriteri 2)**
3. Volumi i praktikës profesionale prej vetëm 4 kreditesh ECTS ose 80 orë faktike në fund të vitit të tretë është i vogël, i pamjaftueshëm, sidomos për një profil inxhinierik si programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike. **(Standarti I.5, kriteri 4)**
4. Këshillimi i karrierës për studentët dhe ALUMNI është në hapat e para të tij dhe ende i pa konsoliduar. **(Standarti I.3, kriteri 2)**
5. Mungesa e incentivave (jo vetëm financiarë) për studentët ekselentë si dhe informacion i paplotë për nivelin e punësimit të të diplomuarve në FIE. **(Standarti V.1, kriteri 3)**



Rekomandime:

1. Të rritet ndjeshëm numri i krediteve në vitet akademike pasardhës për përmirësimin e shprehive praktike dhe aftësive për integrim të shpejtë në tregun e punës të studentëve të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike.
2. Për të siguruar një sistem vlerësimi më domethënës, përveç vlerësimit të pedagogëve nga studentët, të shtohet edhe vetëvlerësimi nga vetë pedagogët si dhe vlerësimi i pedagogëve nga eprorët e tyre të drejtpërdrejtë.
3. Të vazhdojnë përpjekjet për pasurimin e bazës laboratorike.
4. Të zhvillohet një diskutim i gjerë me specialistë me përvojë të FIE, UPT, Industrisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për mundësinë e riorganizimit të programit të studimit të profilit "Inxhinieri Mekatronike", për të pasur vetëm një diplomë të integruar "Inxhinier Mekatronik", mbas studimeve të plota 5-vjeçare.

Conclusions of the External Evaluation of the first cycle Bachelor's study program "Mechatronic Engineering" of the Higher Education Institution "Polytechnic University of Tirana"

Strengths and affirmations:

1. The Faculty of Electrical Engineering FIE, part of UPT, has a long scientific academic tradition in the preparation of specialists, engineers and scientists in the field of Mechatronic Engineering. In this context, the Bachelor study program in Mechatronic Engineering generally is well consolidated.
2. The lecturers of the Bachelor program in Mechatronic Engineering have a high technical-scientific and practical qualification.
3. The wide network of laboratories (mainly of didactic character) largely covers the development of laboratories for applied subjects.
4. Studies in mechatronic engineering are offered in all 2 study cycles: Bachelor and Master. This enables a clear and consistent perspective for all students wishing to pursue studies in this program.
5. Agreements and cooperation with public institutions as well as with private companies make possible not only the realization of professional internships but also the increase of employment opportunities for students at the end of their studies.



6. FIE has qualified human capacities covering a wide range of research in various fields of automation and robotics.
7. UPT and FIE have consolidated links with many European universities, for joint projects, diplomas and doctoral studies.
8. The Bachelor study program in Mechatronics Engineering continues to have a satisfactory number of student enrollments.
9. In recent years there has been increased interest in hiring mechatronic engineers.

Weaknesses:

1. The Faculty of Electrical Engineering and its study programs have insufficient funding as part of public higher education institutions. . **(Standard III.2, criterion 3)**
2. The employment of specialists, graduated at the Bachelor's level in Mechatronic Engineering, is very low and the majority of them prefer to continue their studies at the Master level. **(Standard I.3, criterion 2)**
3. The volume of professional practice of only 4 ECTS credits or 80 actual hours at the end of the third year is small, insufficient, especially for an engineering profile such as the Bachelor study program in Mechatronic Engineering. **(Standard I.5, criterion 4)**
4. Career counseling for students and ALUMNI is in its first steps and not yet consolidated. **(Standard I.3, criterion 2)**
5. Lack of incentives (not only financial) for excellent students as well as incomplete information on the level of employment of FIE graduates. **(Standard V.1, criterion 3)**

Recomandations:

1. To significantly increase the number of credits in the following academic years for the improvement of practical habits and skills for rapid integration into the labor market of the students of the Bachelor study program in Mechatronic Engineering.
2. In order to provide a more meaningful evaluation system, in addition to the evaluation of lecturers by students, to increase the self-evaluation by the lecturers themselves as well as the evaluation of lecturers by their direct superiors.
3. Continue efforts to enrich the laboratory base.
4. To hold a wide discussion with experienced specialists of FIE, UPT, Industry and the Ministry of Education and Sports on the possibility of reorganizing all study programs of the profile "Mechatronic Engineering", to have only an integrated degree "Mechatronic Engineer", after full 5 years of studies.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

